

BEDRI MYFTARI KRONIKAT E VDEKJES

BIBLIOTEKA

854-31

1489



ROMAN


854-31

1999

BEDRI MYFTARI

KRONIKAT
E
VDEKJES

Roman



Shtëpia Botuese "DARDANIA"

Tiranë, më 1994

Atëhere isha mjek në spitalin psikiatrik të Tiranës. Ishin vjeshtëra e frynin erërat e jugës, frynin erëra e rrëzonin gjethët e verdha të pemëve. Gjethet binin si shpresat tona të humbura. Pikëllimi varej mbi qytet e qiejt lotonin. Retë e zeza bridhnin qiejve pa drejtim ashtu si pacientet në oborrin e çmendinës. Në dhomën numër katër ishin dy të sëmurë; një ish oficer i sigurimit të shtetit dhe tjetri prift katolik. Oficeri ishte trupmadh e me një kokë të madhe asimetrike - me kafkë të deformuar nga krimet - siç thoshte një kolegu jonë. Prifti katolik ishte i shkurtër, i imët e dyllë i verdhë si një ikon i gdhendur në muret e manastirit të Ardenicës. Kur frynin erërat oficeri i sigurimit shqetësohej, çohet vinte vërdallë nëpër dhomë dhe i thoshte priftit; - Shet, sheet, dëgjo, dëgjo, a dëgjon gjë! Pastaj shkonte e hapte xhamin e dritares, erërat futeshin në dhomë duke fërshëllyer. Oficerit të sigurimit i bëhej se erërat nga thellësitë e errësirës i sillnin një zë fëmije.

- Babi! Ku është babi im?! Dua babiin.....!

Oficerit i ngriheshin flokët e kokës përpjetë dhe bërtiste me sa zë që kishte: - Jo, nuk e vrava unë! Jo, nuk e kam vrrarë unë. - Kjo ishte një britmë e lehmeritëshme në ato netë ankthi. Erërat e merrnin me vete dhe kjo britje dëgjohej në të gjitha katet e spitalit. Të sëmuret shqetësoheshin, bile edhe ne të personelit na pushtonte një ndjenjë ankthi dhe trishtimi. Prifti katolik puqte dy pëllëmbët e duarve dhe me kokën të ngritur lart lutej: - Mëshirona o Zot, ne mëkatarëve! Mëshirona o Zot ne mëkatarëve! Pastaj, në dhomë shkante mjeku i rojes me infermiueren, e mbyllnin dritaren dhe e vinin në krevat ish oficerin e sigurimit.

Ai u lutej, u puthte duart: - Amani, më besoni, unë e vrava me urdhër të ministrit. Ai më urdhëroi - Merre dhe zhduke andej nga pyjet e Divjakës, - më tha. Kur u nisëm na pa djali i tij i vogël. Babi, ktheu shpejt - i tha ai. Por, babi i tij nuk u kthye më. Atë e vrava unë. E vrava unë me revole pas kokës. Ju betohem që me urdhër të ministrit tonë e bëra. Tani fëmija i tij ma kërkon mua, ku është babai im?! - më thotë. Ju betohem që me urdhër e kam bërë. Thoni, ju luem, i thoni! Dhe pastaj shkruhej në vaj derisa e kapëllonte gjumi. Prifti katolik puqte dy pëllëmbët e duarve, ngrinte kokën lart dhe murmuriste me vete:

- Mëshirona o Zot ne mëkatarëve!! Mëshirona o Zot ne mëkatarëve!

Priftin katolik e kishin mbyllur në çmendinë atëhere kur gardianët e kuq i prishën kishën, ku ai një jetë të tërë kishte pagëzuar katolikët e qytetit të tij. Ai ishte njeri i Zotit dhe nuk i kishte bërë keq kujt. Ai u ishte ndodhur bashkëqytetarëve të tij në të mira e në të këqija, në gëzime dhe në hidhërime. Edhe kisha që e prishën, ishte tempulli i Zotit, ku njerëzit vinin e i luteshin Zotit

për t'jua falur mëkatet. Ai nuk kundërshtoi kur e nxorën me dhunë nga vendi i shenjtë, vetëm ju drejtua Zotit.

- Mëshiroi o i plotfuqishëm se janë të paditur e nuk dijnë se ç'bëjnë. Edhe kur i vunë kazmën, mureve të kishës ai vetëm ju lut Zotit që t'i falte mëkatarët se nuk dinin ç'bënin.

Vetëm kur filluan t'i thyenin ikonat dhe të prishnin gravunat, ai u tha:

- Mosni bijtë e mi, se ato nuk i përkasin vetëm kishës, por janë thesare të kombit.

Por, gardianët e kuq nuk i përfillnin fjalët e priftit, merrnin ikonat e i përplasnin në tokë duke brqhoritur:

- «Parti, nëna jonë! Fjala jote, vepra jonë!».

Prifti shkonte çdo ditë tek muret e ish Kishës dhe i lutej Zotit. Besimtarët i mblidheshin për rreth dhe qanin. Prifti puqte dy pëllëmbët e duarve, ngrinte kokën lart dhe i lutej Zotit: - Bekoi o Zot, besimtarët e tu. Falua dhe bekoj edhe mëkatarët se janë të paditur dhe nuk dijnë se ç'bëjnë. Satanaja u ka prishur mendjet, zemrat, u ka rrëmbyer shpirtërat, çliroi o Zot robt e tu nga kjo e keqe! Amen!

Kur e panë ata të partisë se çdo ditë rreth priftit shtoheshin turmat e morën dhe e futën në çmendinë. Ai ju tha në fillim:

- Bijtë e mij, unë nuk jam i sëmurë, pse më mbyllni këtu?! Por, ata nuk ja vunë veshin dhe prifti ju nënshtrua fatit duke ju lutur Zotit ditë e natë, me lutjen, që ishte bërë si refren në gojën e tij:

- Mëshirona o Zot ne mëkatarëve! Mëshirona o Zot ne mëkatarëve!

Një ditë, aty nga fundi i vjeshtërave, në dhomën-numër katër, ku ishte ish oficeri i sigurimit dhe prifti katolik sollën edhe një

gazetar. Ai ishte me flokë të qethur e sy të kaltër që i shkrepëtinin nga një zjarr i brendshëm. Gazetari sapo u fut në dhomë, filloi të hetojë: Ngriti kokën disa herë lart nga tavani, pa dyshe-menë, muret dhe kontrolloi poshtë krevatëve. Pasi u hodhi nga një vështrim dy të sëmurëve i pyeti: A dëgjoni zhurma natën lart ose anash nga muret, ose poshtë nga dyshe-meja? Ata e panë të habitur, pastaj shikuan njëri tjetrin dhe mbeten të dy si të ngrirë pa folur. S'keni faj ju o të mjerë, e shoh si ju kanë katandisur. Të gjitha nga rrezet lazër i keni! Ata shikonin si të hutuar njëri tjetrin dhe nuk nxorrën asnjë fjalë nga goja. Atë natë na thirrën urgjentisht tek zyra e Sekretarit të Partisë, të gjithë mjekët dhe infermieret e spitalit.

- Sot, ka ardhur një i sëmurë i ri. E kemi fjalën për atë që është vendosur në dhomën katër, e filloi bisedën sekretari i organizatës bazë të partisë së spitalit. Ai është një i burgosur politik dhe është element i rrezikshëm, prandaj e keni porosi nga partia që t'i bëni sytë katër. Këtu e kanë sjellë për ekzaminimin mjekësor. Secili që ka shërbimin, kur të dorëzojë punë do të lerë edhe një relacion për të gjithë veprimet, lëvizjet dhe fjalët që ka thënë i sëmuri. Këto të dhëna i kërkon drejtoria e punëve të brendshme. Tani shkoni dhe mos harroni. Bëni sytë katër!

Aty nga mesnata gazetari u çua dhe u bërtiti shokëve të dhomës:

- Çohuni se na dogjën me rreze lazër! Ata u çuan të lalhtaritur. Oficeri i sigurimit bërtiti. - Jo nuk e kam vrarë unë! Jo, nuk e vrava unë!

Prihti katolik puqi duart, ngriti kokën lart dhe filloi të mëmëriste lutjen e tij:

- Mëshirona o Zot, ne mëkatarëve! Mëshirona o Zot ne

mëkatarëve!

- Poshtë krevatit! - i urdhëroi gazetari. Ata të tre u futën menjëherë poshtë krevateve.

- Mos nxirrni zë fare! As frymë mos merrni - u tha gazetari. Në dhomë ra heshtja e vdekjes. Dëgjoheshin vetëm uluritjet e erërave nëpër dritare. Ne pasi linim shërbimin shkruanim edhe nga një raport për gazetarin ku përshkruanim çdo lëvizje të tij e çdo fjalë që ai nxirrte nga goja. Këto vinte e i merrte operativi i sigurimit mbas çdo turni.

Megjithëse mjekët psikiatër të komisionit epror po ashtu edhe mjekët e spitalit psikiatrik të Elbasanit, ku gazetari ishte shtruar, kishin thënë, se është i sëmurë psiqik me diagnozë të përcaktuar sipas epikrizave. Ata të sigurimit të shtetit dyshonin se gazetari nuk ishte i sëmurë psiqik, por luante pjesën, prandaj u formua një komision me një grup mjekësh, ku filluan përsëri analizat me të sëmurin. Nga këto ahaliza përsëri u rezultua se ai ishte i sëmurë psiqik me atë diagnozë që kishte përcaktuar grupi i mjekëve ekspertë dhe mjekët e spitalit të Elbasanit. Por, përsëri sigurimi i shtetit nuk e besonte këtë. Atëhere filloi të ushtrohej mbi të elektrohoku, por pa sukses. U thirr një mjek, oficer i lartë i ministrisë së punëve të brendëshme. Edhe ai konkludoi me diagnozën tonë, por ata të sigurimit nuk u bindën përsëri. Atëhere, eksperti i ministrisë ftoi mjekët, sigurimsat dhe bëri këtë provë për të vërtetuar se gazetari nuk stimulonte, por ishte i smurë psiqik ashtu siç e përcaktonin epikrizat e kryera.

- E zhveshi të sëmurin, mori një copë hekur, e nxehu derisa hekuri u skuq dhe ja vuri në kurriz. U ndie era e mishit të përcëlluar, por ai nuk nxorri zë.

- Ja, u tha profesori, shikoni sytë e tij, nuk reflektojnë asnjë shenjë dhembje. Ai është i sëmurë psiqik dhe pikë.

- Jo ai stimulon, është artist, u hodh dhe tha një oficer sigurimi.

- Bjere krahun këtu - i tha oficerit që kundërshtoi profesori. Ja mori krahun, i përveshi këmishën, mori hekurin e nxehtë dhe sa e preku pak, ai u hodh përjetë duke ulëritur më të madhe.

- Shiko këtu tani - i tha dhe pastaj mori hekurin dhe ja ngjeshi fort në kurriz gazetarit. Asnjë shenjë.

- E sheh që është i sëmurë dhe nuk është stimulant siç mendoni ju?

Ai mbeti në spitalin tonë si i sëmurë psiqik. Çdo natë ai i çonte oficerin e sigurimit dhe priftin katolik duke u thënë: - Poshtë krevateve se na dogjën me rreze lazër. Oficeri bërtiste: - Jo, nuk ë vrava unë, jo se kam vrarë unë! Kurse prifti katolik murmuriste me duart e kryqëzuara dhe kokën lart:

- Mëshirona o Zot ne mëkatarëve! Mëshirona o Zot ne mëkatarëve!

Ato vjeshta të atij viti s' më shqiten nga kujtesa. Edhe tani kur fryjnë erërat e jugut, më bëhet se dëgjoj:

- Çohuni se na dogjën me rreze lazër!

- Jo nuk e vrava unë! S'e kam vrarë unë!

- Mëshirona o Zot ne mëkatarëve! Mëshirona o Zot ne mëkatarëve! Dhe më parafytyrohen: fytyra si ikona e priftit katolik me dy pëllëmbët e puqura dhe gazetarin me sytë që ndizeshin zjarr.

Por, në një mëngjes të atyre vjeshtave u rrëqeth i gjithë spitali nga të bërtiturat e një infermiereje.

Ajo thërriste: - Hajdeni të shikoni çka ndodhur në dhomën numur katër! Hajdeni shpejt, hajdeni!...

Kur shkuam te dhoma numur katër, u llahtarisë dhe ngelëm si të ngrirë. Oficeri i sigurimit ishte i varur. Koka e madhe dhe asimetrike i kishte marrë anën dhe gjuha i kishte dalë përjashta. O Zo, sa të gjatë e kishte gjuhën?! A mund ta këtë njeriu gjuhën aq të madhe?!

Prifti katolik rrinte këmbëkryq mbi krevatin e tij dhe me duart e puquramurmuriste lutjen e tij drejtuar Zotit!

- Mëshirona o Zot ne mëkatarëve! Mëshirona o Zot ne mëkatarëve!

Kurse gazetari kishte mbështetur kokën tek dora e tij dhe po lexonte. Kur hymë ne në dhomë ai e la librin, u çua dhe me gjakftohësinë më të madhe na tha: - Mëri dënimin që meritonte. M' i tregoi mbrëmë tërë natën krimet që kishte kryer dhe unë me urdhër të Zotit e dënova me varje për ta lehtësuar që të lante mëkatet. Pyeteni uratën se jua tregon të gjitha se si u krye procesioni, me gjyq të rregullt. Dëshmitar kam Zotin dhe uratën. Por, pa mbaruar mirë fjalën gazetari, erdhën ata të sigurimit e i hodhën prangat gazetarit. Ai nuk foli, por sytë ndizeshin zjarr nga një vullkan i brendshëm. I hodhën prangat edhe priftit katolik!

- Mëshirona o Zot se nuk dijnë se ç' bëjnë! Mëshirona o Zot të gjithë ne mëkatarëve - murmuriti prifti katolik. I futën në një gaz. Pastaj nxorrën edhe kufomën e oficerit të sigurimit disa punonjës të komunales. Atë natë unë kisha shërbimin, pastruesja m' u lut të qëndroja tek dera e dhomës numër katër deri sa ajo ta pastronte se i rrëqetheje trupi kur futej brenda. Kur ajo shkoi të merrte kovën me ujë, mua më zuri syri një bllok të vogël me kapak të zi, te koka e krevatit ku flinte gazetari. E mora dhe me zemër të dridhur e tërë frikë e futa në xhepin e përparësës. Nga frika nuk e hapa fare atë

natë për të parë se ç'kishte. Të nesërmen e kisha pushim. U mbylla në dhomën time dhe nxora bllokun për ta parë. Ai ishte një bllok i vogël me kapak të zi.

E shfletova. Ishte shkruar me ca shkronja mikroskopike që mezi lexoheshin. Në atë bllok ishte jeta e tij. E kishte shkruar gjatë kohës që kishte qenë në psikiatrinë e Elbasanit, por tani që kanë kaluar më se pesëmbëdhjetë vjet po ja jap lexonjësit që të njihet me jetën e një të dënuari politik.

Spitali Psikiatrik Elbasan.

Më kanë sjellë nga Burreli. Nga Burgu famëkeq i Burrelit. Çmendinaja është një varrezë e madhe, me varre të hapura e me të vdekur të pakallur. Në varreza mbulohen kufomat e të vdekurve. Atje është qetësi e amshuar. Varrezat janë të pastërta, me qiparize e dafina, me trëndafila, zambakë e jargavanë. Në kokën e çdo varri është një pllakë mermeri ku shkruhet emri dhe mbiemri i të vdekurit. Kurse, në çmendinë janë kufoma të gjalla me ndjesi të vdekura. Po unë a jam i sëmurë psikik? Qelizat e trurit tim ndizen e fikën si drita e një fari të vendosur në një ishull të humbur të oqeanit Pacifik. Unë nga natyra jam tip romantiku dhe ëndërrimtari. Që kur isha i vogël çohesha herët për të parë se si çelnin trëndafilat e agimeve mbi malin e Dajtit, sodisja i mahnitur si ndizeshin në purpur perëndimet kur dielli humbiste përtej horizonteve. Mrekullohesha kur shikoja një ëndinëz buzë lumit me lule shqerza, kur shihja një pikë vese mbi petalet e lule zambakut. Netëve, dilja e dëgjoja zërat e mistershëm të natës. Më bëhej sikur çdo gjethe peme, petale luleje, fije bari tingëllonin e nxirrnin ca melodi të magjishme e të pakapëshme. E gjithë magjia më dukej se derdhej nga hëna. Më dehte e më bënte njeriun më të lumtur në botë aroma

e lule mimosave dhe e lule blirit, aroma e barit të porsakositur tutje çaireve.

Kur isha në vitet e para të shkollës së mesme ëndërroja të bëhesha detar. E përfytyroja vehten time në mes të tufaneve, kur fillonin e frynin tajfunet e musonet, përlëshesha me dallgët, stuhitë, piratët. Gjithmonë unë isha shpëtimtari i fatëkeqëve. Kur shkova në maturë i harrova detet, piratet, oqeanet, tajfunet, musonet. Tani ëndërroja të kisha një dashnore si Ruthi, Migeni, Izota ose Dora. Dhe të gjitha cilësitë e këtyre heroina romanesh sipas meje i kishte shoqja e klasës Leta. Ajo ishte me një trup nazik, e brishtë, e pastër, naive. Edhe profesori i historisë që atëhere ishte rreth të dyzet e pestave magjepsëj. E kapte nga mjekrra dhe i thoshte: Letushka! Çma ke vënë këtë shall të kuq me pika të bardha, sikur të ka përçafuar një gjarpër. Letushka! Unë bëhesha xheloz kur profesori e kapte Letën nga mjekrra dhe i fliste me përkëdheli. Prandaj fillova ta urreja profesorin e historisë. Megjithëse ai shpjegonte bukur dhe ne nxënësit luteshin ta kishim orët e fundit të mësimin se ai na çlodhte. Unë kisha rënë në dashuri me Letën dhe mendoja që dashurinë t'ja shfaqja nën një mollë të lulëzuar, ose netëve çaireve të porsakositura, nën dritën e hënës dhe të yjeve. Dhe kur të martoheshim ëndërroja të blenim një shtëpi lëvizëse dhe të niseshim drejt të panjohurës. Të ndalonim ku të na zinte nata, në pyll, buzë lumit e fushave. Mbase të hanim darkën të binim në krahët e njëri tjetrit. Në mëngjes të niseshim përsëri për udhëtim, deri sa të arrinim nën yjet e jugut. Atje të stabilizoheshim provizorisht. Netëve, nën dritën e yjeve të jugut të sodisnim kopetë e bizonëve, xhirafat, tigrat, panteren e zezë të Afrikës. Të dëgjonim këngën e palloit, papagallit. Të miqësoheshim me fiset e egra të

xhunglës. T'i mësonim si të gatuanin, t'ju mjekkonim plagët.. Ata do të na i shpërblenin me fildishte, perla, babane e arra kokosi. Kurse netëve do të dëgjonim se si buronin nga zemrat e tyre bjuzët e mornatës, tam tamet dhe do të shikonin vallet ritmike dhe eksituese., Pastaj do të dilnim një dyzinë me vajza e djem. Vajzat do t'i ngjanin Letës, ndërsa djemtë mua. Kur të ktheheshim në Evropë unë do të shkruaja kujumet, kurse Leta do të merrej me edukimin e fëmijëve. Nga të gjitha këto nuk u realizua asgjë, sepse unë i thosha Letës do të them një fjalë, por më prit në klasë. Ajo shkonte e më priste. Unë shkoja pranë saj. Ajo e mbante kokën ulur. Do ta them nesër i thosha.

-Mirë, - më thoshte ajo. E kështu mbaroi shkolla e mesme, megjithëse duheshim nuk ja shfaqnim dashurinë njëri tjetrit.

Edhe tani që unë kam kaluar nëpër rrathët e ferrit komunist, kam mbetur ai që kam qenë, romantik dhe ëndërrimtar. Ende u gëzohem si fëmijë mëngjeseve dhe mbrëmjeve, vesës mbi bar. Më ndezin fantazinë netët me hënë e më frymëzojnë erërat e vjeshtërave. Ende e përfytyroj femrën si Ruthi, Migeni, Izota dhe Dora, të shkruara të gjitha tek një e vetme, tek Leta. Endërroj ta filloj jetën përsëri nga e para si atëherë kur isha shumë i ri. Megjithëse jeta është sjellë si njerë me mua, ajo është e bukur dhe unë e dua. Unë jam një i burgosur politik, një i çmendur i mbyllur përjetë e i rrethuar me tela me gjemba.

Por, unë i jam mirënjohës fatit e destinacionit sido që ta këtë emrin për ato pak çaste të bukura që më ka falur.

Ishte një mbrëmje dehëse. Natyra kishte çelur gjoksin e saj të virgjër. Hëna që kishte dalë mbi malin e Dajtit kishte nderë hapësirave një vello transparente prej argjendi. Yjet dridheshin hapësirave pa fund të universit duke lëshuar mesazhe të pakapëshme. Xixëllonjat ndizeshin e fikeshin si dashuritë, shpresat, fatet, si vetë jeta. Një aromë dehëse përhapnin puhizat që zbrisnin nga Dajti. Në qytetin tim atë natë kishte lulëzuar bliri. Këto netë mund t'i shijosh: në shkurt, kur lulëzojnë mimozat, në maj kur çelin trëndafilat dhe në qershor kur lulëzon bliri e në vjeshtë kur fryjnë erërat e Jugut. Vetëm në qytetin tim, në Tiranë. Atë natë unë shkova në kinema për të parë filmin «Kasta Diva». Bileta më takoi në llozhë, në karrigen pranë murit. Në radhën time erdhën e zunë vend vajzat e maturës së gjimnazit «Sami Frashëri». Ngjitur me karrigen time u ul ajo. U pamë sy më sy e të dy u skuqëm e ulëm kokat. Unë e kisha parë për herë të parë atë nga fundi i muajit shkurt. Atë ditë kishin lulëzuar mimozat. Unë isha liruar nga ushtria dhe punoja si gazetar në «Zërin e Rinisë». Ishte delikate, me flokë të zezë e sy të shkruar. U pamë sy me dsy. Ai vështrim mua më trulloi. Ajo ishte si Ruthi, Migeni, Dora, Izota, si ëndrra ime e parë, Leta. Ajo ikte e kthente kokën. Unë kisha ngrirë në vend si një pikëçuditëse.

Çdo ditë, në atë orë unë dilja tek rrugica e mimozave dhe e prisja. Ajo sapo më shikonte mua, skuqej dhe ulte kokën. Dhe kur shkonte tek kthesa e kthente kokën gjithmonë prapa. Kishte katër muaj që unë kisha rënë në dashuri me të. Dhe ja, rasti e soli të jemi

pranë e pranë. U fikën dritat e filloi filmi. Unë nuk shikoja gjë. Isha i përqëndruar i gjithi drejt asaj krijese hyjnore për mua. Dëgjoja vetëm ritmin e frymëmarrjes së saj. Pa prituri dora ime preku dorën e saj. Gati sa nuk më pushoi zemra. Ajo e hoqi dorën për një çast, pastj e vuri prapë mbi dorën time. Duart tona për disa çaste i jepnin njëra tjetrës mesazhet e zemrës, shpirtit, trurit, trupit. Pastaj ajo ma mori dorën dhe ma vuri në gjoksin e saj. O Zot si i rrihte zemra nën përparsen e zezë prej akllasi. Pastaj gishtat e mi instiktivisht filluan të zbërthenin kopsat e përparësës. Dora ime i preku gjinjtë e saj. Ajo turfulloi e tëra e gjinjtë e saj sikur çelnin në pëllëmbën e dorës sime. Dora ime rrëshqiti poshtë në përparsen e akllasit dhe fillova t'i fërkoj kofshët. Ajo u ndez, u kthye skiç nga unë ma mori dorën dhe ma shtrëngoi fort në mes të kofshëve. Ne kishim humbur të dy në atë dalldi dashurie dhe për ne s'ekzistonte asnjëri, as filmi, as vetë universi. U përmendëm vetëm kur mbaroi filmi e u ndezën dritat. Ne binim në sy se ishim bërë lulëkuq në fytyrë. Kur dolëm jashtë filladi i freskët që vinte nga mali i Dajtit më solli në vehte.

Ato u nisën të gjitha drejt rrugës së Dibrës. Unë qëndrova si i ngrirë në vend. Ajo ktheu kokën dhe ma bëri me shenjë hajde pas meje. U nisa. I ndiqja nga larg për të mos rënë në sy të shoqeve të saja. Ajo u tha natiën e mirë shoqeve dhe u fut në një rrugicë. Kur dola unë në krye të rrugicës, ajo kishte ndaluar nën një bli të lulëzuar. I vajta pranë. U pamë për një çast sy më sy pa folur. Pastaj unë i vura të dy pëllëmbët e duarve të mia mbi faqet e saja. Ato digjeshin.

- Më do? - e pyeta.

- E, të du! - më tha.

E putha me vrull në faqe, në buzë, në gushë. I zbërtheva

gjoksin. Kishte ça gjinj të vegjël e të bardhë. I preka dhe i mora erë. Ato lëshonin një aromë dehëse që s'krahsohet me asnjë aromë në botë. Ajo ishte aroma joshëse e dashurisë. I putha të gjithë trupin dhe ja ndeza me frymën e shpirtit të gjitha qelizat e dashurisë. Ndalua për një çast dhe u pamë sy me sy.

- Unë rashë në dashuri që me shikimin e parë, atë ditë tek rrugica e mimosave, - i thashë.

- Edhe unë! - më tha.

Pastaj ramë përsëri në krahët e njëri-tjetrit. Sa do të kishim qëndruar ashtu? Ndoshta deri në agim, por na përmendi kënga e kumisë në kokat tona.

- Mjaft tani, më tha ajo. - U vonova dhe do të më bërtasin në shtëpi, - u shkëput dhe filloi të vrapojë nëpër atë rrugicë të lara nga rrezet e argjenda të hënës.

- Ndalo pak, - i fola.

- Hë, se më vajti vonë, - tha e shqetësuar.

- Si e ke emrin?

- Vjollca!

- Po ti?

- Saimir!

- Natën e mirë Saimir, - më tha. Nesër mbrëma, këtu tek bliri jonë, në këtë orë. Unë qëndrova atje tek bliri i lulëzuar, derisa hija e saj humbi pas pallateve. Këndoi kumria përsëri dhe unë u përmenda.

Mbi buzët e mia atë natë kishte rënë nektari i gjithë botës. Buzët i kisha mjaltë të lagura nga lëngu i mollës së ndalueme. Ende e ndiej aromën dehëse të atij trupi të virgjër femëror. Unë ato çaste jetoja të pakapshmen. Nuk isha tokësor, por një supermen. Ç'ishin

ato çaste?! Fani tje? Vegim? Ç' ishte ajo krijesë? Sirena, vajza e vogël e Jonit apo Karakaftja e Elbasanit?

Ecja si i dehur nga afshet e mbinatyrshe të pasioneve. Në krye të rrugicës më prenë rrugën tre veta. Ata ishin veshur me kostume të zinj dhe të tre kishin syza të zeza. M'u kujtua procesi i kafkës.

- Ju quheni Shandor Petef? - m'u drejtua njëri nga të tre.

Ne mblidheshim një herë në javë tek shtëpia e Kolombos. Ajo ishte një shtëpi përdhese në periferi të qytetit, në mes të një pemtoreje të fermës «Gjergj Dimitrov». Fiknim dritat, ndiznim qirinj, pinim verë e lexonim krijimet tona me dorë të lirë. Këtë shtëpi, ku mblidheshim një herë në javë e kishim pagëzuar me emrin «Klubi Petef» dhe mua më thërrisnin Shandar Petef.

- Unë jam Saimiri. Saimir Derveni! - iu përgjigja.

- E dijmë, e dijmë se kush je, të njohim me dhëmbë e dhëmballë. Të dijmë edhe se sa lugë ke në shtëpi. Por, pa bërë lëvizjen më të vogël dhe pa bërë as gëk as mëk, futu në atë makinën atje. Ishte një gaz 51 Sovjetik. Ai që më urdhëroi u ul përpara me shoferin, kurse dy të tjerët më vunë në mes.

- Ku i ke byzlykët, foli ai që ishte ulur me shoferin. Ai që ishte ulur në krahun tim të majtë, nxorri prangat dhe më tha:

- Në emër të popullit jeni i arrestuar!

Më lidhi duart prapa dhe gazi u nis. Unë kisha hipur në gazin e sigurimit të shtetit.

Atëhere në Tiranë kishte pak automjete. Më shumë në sy binin «zimata» e zinj të udhëheqjes që të çonin në parajsë. Kështu flitej atëhere për bllokun udhëheqës, është parajsë e vërtetë, por ne nuk e kishim parë asnjëherë se ruhej me policë e me ushtarë. Bile, kishim frikë të kthenim edhe kokën anej. Pastaj vinin me rradhë:

makina e vdekjes që të çonte në Tufinë e Sharrë nga ku nuk ktheheshe më, gazi i sigurimit që të çonte tek burgu i vjetër, burgu i ri ose në bodrumet e ministrisë së Punëve të Brendshme, që s'dihej kthimi, autoburgu që të çonte në Burrel, Spaç, Qafë Bar nga ku mund të ktheheshe pas tre ose njëzet e pesë vjetësh. Gazi u ndal para portës së burgut të ri. Burgu i ri ndodhej në fund të Brrakës. Ndërtesa e burgut është ngritur në kohën e okupacionit italian dhe është e rrethuar me një mur tre-katër metër të lartë. Mbi mur është vendosur një rrjetë me tela me gjemba, dy metër e lartë. Në çdo pesë gjashtë hapa ngrihen kupolat e rojeve. Poshtë në bahçen e burgut janë kupolet e qenve të kufirit dhe të instruktorëve të qenve. Ndërtesa është dykatëshe. Në katin e parë janë 22 qeli, ndërsa në katin e dytë kanë 27 qeli dhe dhomat e hetuesisë.

U hap porta e par prej hekuri, e dyta po prej hekuri. Më zbritën në oborrin e burgut. Më kapën nga krahët, kaluam në nëntë porta me nga dy dryna e dy lloza sejcila nga mbrapa, deri sa arritëm tek qelia numër dyzeteshtatë, tamam si tek Sibani detari i një mijë e një netëve. Kur më futën në qeli m'u duk sikur kisha rënë në fundin e një pusi të thellët, nga ku nuk dukej as hyrja dhe as dalja. Lart në mur, ishte një fërgji sa pëllëmba e dorës e kryqëzuar me hekura. Në tokë ishin dy batanije të grisura, pagurja e urinës dhe pagurja e ujit.

Era e amoniakut, lagështirës dhe mykut që kishte veshur muret e nxira të qelisë të zinin frymën. Tek dera e birucës ishin shkruar nga të izoluarit lloj lloj fjalësh. Në krye lexova: «Këtu është bota e heshtjes dhe e vdekjes», «Po hyre këtu je fshirë nga lista e të gjallëve», «Në këtë birucë janë pushkatuar 132 veta, janë varur 13 veta. Kanë vdekur nga torturat 87 veta, janë çmendur 6 veta. Pastaj më poshtë ishin shkruar emra artistësh filmash dhe emra e të

53680 17

izoluarve që kishin kaluar nëpër këtë qeli. U ula në një qoshe të birucës. Dëgjohej rrjedha e një çezme, tutje nga fundi i korridorit, dhe bashkë me rrjedhën dëgjoheshin edhe hapat e gardianit. Për birucat kisha dëgjuar tregime nga më makabret. Kur dëgjova rrjedhën e çesmes thashë me vete - Po sikur të ma lëshonin ujin në birucë? Në fillim uji do të më mbulojë deri në gju, pastaj deri në bel e së fundmi deri në fyt, pastaj do të më mbulojë komplet. Si do të jetë vdekja kur mbytesh në ujë? Një rreze hëne hyri nga katrorët e hekurave të fërgjisë dhe ra mbi murin e nxirë të qelisë. Vështrova rrezen e hënës dhe m'u kujtuan të gjitha ngjarjet e asaj nate. Në pak orë gjithë ato ngjarje, tamam si në përralla. Filmi «Kasta Diva» realizimi i të gjitha ëndrrave të mia rinore për dashurinë. Aroma e lule blirit, hëna si një nuse lozonjare mbi Dajt, puhizat e flladit pranveror, nektari mbi buzët e lagura nga lëngu i mollës së ndalueme. Aroma dehëse e atij trupi virgjëror me emrin Vjollca dhe pastaj një ëndërr e ligë, oficerët e sigurimit, prangat dhe qelia numër 47 e burgut të ri.

Koka m'u boshatis. Asnjë mendim në trurin tim, asnjë tingull. Bota vdiq. Shikoja si idiot rrezen e hënës mbi muret e nxira të qelisë. Më solli në jetë kërcitja e llozit tek dera e qelisë.

Para syve m'u fantaks një fytyrë pa jetë, pa ngjyrë, me dy gisht ballë, me ca sy të hurrët, të vegjël e të futur thellë në zgavrat e kafkës. Ai qëndronte para meje me pranga në dorë. E vështrova drejt në sy, asnjë damar nuk lëvizte në atë fytyrë, as një ngjyrë nuk shquhej, as qerpikët nuk i lëviznin. Ky do të jetë xhelati, - thashë me vehten time. Kisha lexuar diku se të gjithë ata me ballë të ngushtë e me sy si dy xixa të futur thellë zgavrave të kafkës kanë prirje sadisti.

- Çohu! - doli një thirrje nga gërmazi i fantazmës. Ai s'e çeli gojë fare, as buzët nuk i lëvizi. Nga doli ai zë që dukej se vinte nga thellësi humnerash të errëta. Vetëm në fyt lëvizi lart e u ul poshtë gongu i fytit.

U çova. Më lidhi duart mbrapa dhe më nxorri në korridor.

- Ka njeri! Ka njeri! Gongu tek fyti u çua lart dhe u ul poshtë dy herë. Korridori ishte i errët dhe i ngushtë. Nga të dy anët e korridorit ishin dyert e birucave si pllaka varri. Prapa çdo dërrëgjëj përpëlitej një shpirt njeriu, futur thellë skeletit të vdekur e të pakalbur. Unë prisja nga çasti në çast të më shfaqej dhoma e torturave e parafytyruar sipas meje.

- ka njeri! Ka njeri! - më zgjoi klithja e atij që më mbante nga krahu. U hap një derë. Dolëm në një si veradë dhe përpara na doli një korridor i gjerë e tërë drita. Nga të dy anët e korridorit ishin dyert e dhomave të hetuesisë. Ai u ndal e trokiti tek dera e dhomës numër katër.

- hyrë, - u përgjigj dikush nga brenda.

Në dhomën numër katër ishte një djalë me flokë të verdha, gati moshatar me mua. Dy tavolina karshi njëra tjetrës. Në mur përballë, fotografia e Enver Hoxhës dalë me uniformë ushtarake e me grada gjeneral-major. Dhoma ishte e gjerë dhe ajrorej nga dy dritare të mëdha, nga ku dukej baçja e arshivës së shtetit. Të gjitha këto unë i fotografova, sapo u futa në dhomë. Shoqëruesi im nderoi me grusht dhe u largua.

Në dhomë mbetëm ne të dy, unë dhe djali me flokë të verdha. Ai më hodhi një vështrim me vetulla të mbledhura nga koka tek këmbët. Pastaj më urdhëroi:

- Uluni! - duke më treguar karriken e tavolinën.

U ula. U ul dhe ai përballë meje. Karrigja dhe tavolina ku u ula unë ishin të betonuara në dysheme. Mbi tavolinën e tij ishte një dosje e trashë me kapak bojë hiri. Ai e hapi kapakun e dosjes dhe filloi të çfletojë. Çfletonte një fletë dhe më shikonte mua me bisht të syrit.

- Dosja ime, - thashë me vehte. Sa e tradhë qenka. Edhe Mataharri nuk besoj ta ketë pasur dosjen kaq të trashë...

Ai u çua në këmbë, bëri dy tre xhiro nëpër dhomë dhe pastaj m'u drejtua mua:

- Unë jam hetuesi ytë. Që nga ky çast jeta jote është në dorën time. Unë jam i arsyeshëm, por me armiqtë e Partisë, jam i pamëshirshëm. Atë ditë që mora tescerën e Partisë, u betova në idealet e Partisë, në gjakun e shokëve se kushdo që do të guxojë të ngrejë dorë kundër pushtetit popullor, do ta shtyp si insekt, pa pikën e mëshirës, sikur të jetë edhe njeriu im më i afërt. Mua më kanë folur për ty. Kemi kohë që të studiojmë edhe vetë. Ti je një dhel për që nuk e ke shokun. Por dije mirë se ajo karrige ku je ulur ti nuk e ka mundur kurrë karrigen ku jam ulur unë. Në atë karrige ku je ulur ti, janë ulur para teje kriminelë që nuk u bënte syri dritë, por ne i kemi bërë të ligjëronin si bilbila. Prandaj, po të këshilloj që të mos të të rrejë mendja. Bjeri drejt se do të kemi lehtësira, Partia e ka zemrën e gjerë. Ajo i fali jetën edhe kriminelit Hetem Çoka, vetëm se u tregua i shtruar edhe i penduar.

Pas kësaj ligjërata shkoi dhe u ul në karrigen e tij karshi meje. Filloi përsëri të çfletojë dosjen. E la dosjen dhe më nguli vështrimin mua. Edhe unë e vështroja drejt në sy. Sytë e tij u përpëlitën në fillim. Pastaj i humbën nuancat dhe u kthyen në një shkretërirë të akullt. Shkretëtira e syve të hetuesit qëndroi ashtu pa jetë vetëm ca

sekonda. Pastaj thellë qenies së tij nguluan mbi hapësirat e akullta të bebëzave të syve të tij një mori zvarranikësh. Në ato sy unë pashë të gjitha llojet e gjarpërinjve: kabra, nëpërka, bile edhe krokodila. Më shkuan të rrëqethura në të gjithë trupin dhe m'u ngritën flokët përpjetë. Në bebëzat e xhamëta pashë edhe portretin tim, lakuriq të shtrirë në atë shkretëtirë të akullit. Mbi trupin tim u vërsulën të gjithë zvarranikët dhe filluan të më thithnin gjakun. Pashë edhe buzët e trashura të hetuesit që u ngjitën në plagët e hapura të trupit tim.

- O Zot, ky qenka sadist, - thashë me vehte. Në këtë kohë m'u kujtua shoku i fëmijërisë Adi. Kur mbledheshim tek shtëpiza në periferi të qytetit për të lexuar krijimet tona me dorë të lirë, ai na fliste për prejardhjen e komunizmit.

- Komunizmi vjen nga kohërat prehistorike, - e niste tregimin ai. Nga koha e Dinozaurve. Nga këto kohëra vjen edhe kanceri. Komunizmi është pasardhës direkt i kanibalizmit. Në shoqëritë komuniste ata që kanë në gen të trashëguar brez pas brezi qeliza kanibale, kthehen në sadista dhe kur bëhen udhëheqës të Partive komuniste kthehen në vampirë. Po të marrim të gjitha periudhat historike të zhvillimit njerëzor, del se gjatë sundimit komunist ka patur diktatorë më shumë se në të gjitha kohërat e mbledhura së bashku.

- Më shiko mua drejt në sy - më përmendi zëri i hetuesit. Unë e shikova drejt në sy. Sytë e tij ishin kthjelluar dhe kishin marrë ngjyrat e zakonshme.

- A e di pse të kemi arrestuar? - më tha.

- Jo, nuk e di!

- Të kemi arrestuar për tradhëti të lartë ndaj atdheut, për

terrorizëm e agitacion e propagandë kundër vijës së partisë në art e letërsi. Partia të rriti dhe të edukoi dhe ti si bukëshkalë që ishe, ja shpërbleve Partisë me tradhëti! Ç'të bëri Partia?! Ku t'u prek interesi, Partia të dha dorën, por ti e urren partinë.

Tani më thuaj që kur e ke urryer Partinë?

- Partinë e kam urryer që në themelimin e saj. Ai e shënoi.

A e njeh një shkrimtar që është arratisur, ja harrova emrin se si ja thonë...

- Baudin!

- Hë de, Baudin. Tani më thuaj se çfarë di për të?

- Baudinin e kam pasur shok. Para një viti e gjysmë është arratisur.

- Si u arratis?

- Për këtë pyesni organet koopedente që e survejonin se ai ishte i internuar në Kullë të Sukthit.

- Pasi u arratis ai ti shkove në Konispol. Pse shkove?

- Më+ dërgoi redaksia e gazetës me shërbim.

- Gënjen, mor armik i degjeneruar, se ti ke ngulur këmbë vetë, - më tha.

Sytë ju mbushën me njolla gjaku. U çua në këmbë dhe erdhi tek unë.

- Ku e quan vehten se je këtu? Për ta marrë vesh po të gudulisim pak, - më tha dhe cigaren e ndezur ma vuri në ballë. U dëgjua përcëllima e mishit dhe era e djegur. Ai më vështronte në sy i lumtur dhe krenar. Edhe unë ja ngula vështrimin. Ai lexoi në sytë e mi urrejtje.

- Ti na urren nga thellësitë e shpirtit, më tha.

- Po është e vërtetë. - i thashë.

- Ou, na qenke edhe trim!

Po nuk e di ti se unë të bëj të pëllasish si lopë, pastaj të më kërkosh falje dhe të më puthësh këmbët. Më vuri gjurin në mes e filloi të më lëvizë prangat. Unë e kafshova fort gjuhën që të mos nxirrja zë.

- Hë, hë do të thuash më fal apo te t'i këpus duart.

Unë e shtrëngova edhe më fort gjuhen. Goja m'u mbush me gjak. Hekurat më hynë thellë e më thellë në mish dhe unë rënkoja nën zë.

- Eh, eh!...

Damarët e duarve m'u nxinë, m'u frynë, pastaj plasën. Gjaku që shpërtheu nga damarët e duarve të mia spërkati muret, dyshemënë, tavolinën, fotografinë e Enver Hoxhës dhe fytyrën e hetuesit. Ai më shtyu. Unë i lidhur me pranga u përplasa në dysheme. Nga korniza doli Enver Hoxha dhe erdhi vuri buzët mbi plagët e mia. Buza e poshtme ju var dhe nga dy dhëmbët e qenit filloi t'i pikojë gjak. Nga sytë e hetuesit dolën të gjithë gjarpërinjtë dhe u turrën drejt plagëve të mia. Pashë edhe buzët e hetuesit të ngjitura tek plagët e mia. Pastaj erdhi edhe konti Dragula.

O Zot! Sa ngjasonin të tre: Enveri, hetuesi dhe konti Dragula!

Kur u përmenda isha në qeli. Bëra të lëvizja duart, por nuk munda. Ishin plumb të rënda. Dëgjova rrjedhën e çezmes dhe hapat e gardianit në korridor. Rrezja e hënës po dilte nga qelia. Një zbrazë tirë mbushi qelinë dhe bashkë me të edhe qenien time. Klithi kukuvajka, ugur i zi për mua. Hetuesi më pyeti për Baudin. Ai tani ndodhet në Amerikë, kurse unë në qeli. «Bota u përket guximtarëve» - thotë një dijetar dhe kjo është e vërtetë.

Ai u arratis nga qafa e Likojanit. U arratis natën, vetë i dytë, i

veshur me këmishë të zezë. Prandaj më nisën urgjent mua me shërbim për në Konispol.

Ishte muaji gusht e ne i ramë nga bregdeti. Kur u propozova unë, fotoreporteti dhe shoferi i gazit të qëndronim disa ditë në Jonufër, ata nuk pranuan. U habita atëhere me ta. Në Jonufer ishte deti. Koha ishte e artë, kishte vullnetarë të bukura nga të gjitha rrethet e Shqipërisë. Ata më propozuan që të shkonim në Konispol, pa e nxjerrë lejen kufitare, por unë nuk pranova. Kur zbritëm nga garë në Konispol, na dolën përpara katër ushtarë e dy oficerë të armatosur.

- Pasaportat, lejet e kufirit, shokë qytetarë na u drejtuan ushtarët.

· O Zot, po sikur të ishim pa leje kufiri?!

Kur u kthycem në Tiranë e njerëzit më pyesnin në ishte arratisur Baudini, unë ju përgjigjesha i habitur se po e dëgjoja për herë të parë nga ata.

- Po ti ishte në Konispol, si ka mundësi - më thoshin ata duke më parë me dyshim.

O Zot! Sa të djallëzuar janë ata të sigurimit.

Po pse u arratis Baudini? Ai kishte shkëlqyer si një meteor në qiellin e realizmit socialist që kishte uzorpuar tërë artet tona. Krijimet e tij ishin si një rreze drite në një natë të errët dhjetori. Ai kishte përfunduar pjesën e parë të një romani historik. Sa vullnet që kishte ai njeri. Më kujtohet një natë, ishte duke hedhur një tregim. Nuk vuri gjumë në sy deri mbi të gdhirë derisa e mbaroi. Por, atëhere ishin vitet më të egra të komunizmit. Lufta e klasave kishte arritur kulmin. Kërkohej t'i këndohej vetëm partisë, socializmit dhe udhëheqësit legjendar Enver Hoxha. Atëhere

Kolumbua na lexonte mikrofabulat e tija:

Lakunia dhe Bilbilat:

Në pyll këndonin bilbilat. Vjen Lakunia e ujqëve dhe u thotë: Mjaft kënduat për dashurinë, tani na këndonin një këngë për lakunin.

Qeni dhe Gomari

Një qen takon në rrugë gomarin dhe i thotë: Po të shoh mirë. Qimja të shkëlqeka, paske vënë kapistër e samar të ri.

- Kam hyrë në polici, - i thotë gomari. Po, edhe ty të shkëlqeka qimja dhe ke vënë rrip të bukur në qafë, - i thotë gomari.

- Kam hyrë me sigurim, - i thotë qeni.

Milingona dhe Gjinkalla

Gjinkalla takon në rrugë milingonën dhe i thotë: - Ku po shkon kaq me nxitim? O Kumbarë?

- Po shkoj në grumbullim për të dorëzuar detyrimin e mishit, - i përgjigjet milingona.

* * *

Po Bandini pse u arratis?!

Si mundi?! Ku çdo metër katrore është e rrethuar me tela e me gjemba, ushtarë e qen kufiri. Ai tani ndodhet në Amerikë, kurse unë në qeli. Bota u përket guximtarëve.

Në derën e Birucës u dëgjuan llozi e vërgëllima e çelësave të gardianit. Më mori nga krahu se prangat nuk më futeshin nga duart

e enjtura."

- Ka njeri! Ka njeri! - bërtiste ai nëpër korridor. Më çoi tek dhoma numër katër. Nderoi me grusht dhe u largua. Hetuesi ishte si i përgjumur. Më vështroi drejt në sy. Bebëzat e syve i kishte të turbulluara.

- Më dëgjo me vëmendje, - më tha. - Këtu është bota e heshtjes dhe e vdekjes. Po ta them troç po u fute këtu për politikë je fshirë nga lista e të gjallëve. Pranove, fluk pranove për ne njësoj është. Po për ty është më mirë të pranosh se kështu shpëton nga biruca dhe nga unë. Mendohu sonte për këto që të thashë. Këtë e bëj për të ndihmuar ty. Ti gjykoje vetë. Nesër do të takohemi përsëri.

Kur u ktheva në qeli, tek hekurat e fërgjisë po cicëronin harabelat. Po gdhihej. Oh sa e gjatë m'u duk ajo natë, sa një jetë e tërë. Dëgjova ca zëra të mbytur njerëzish që mezi arrinin në birucën time.

- O ti i qelisë numër dyzeteshtatë!

- O ti që ke ardhur mbrëmë natën! Ti i qelisë dyzeteshtatë, vëre veshin tek dera e qelisë dhe na dëgjo. Vura veshin tek dera e qelisë dhe fola me zë të mekur:

- Po ju dëgjoj, po ju dëgjoj!

- Mos u tremb, mos prano asgjë. Rezisto! Po të sollën njeri në birucë mos i beso, se është spiun i sigurimit. Po dëgjove të trokitura në mur mos u shqetëso se edhe ata janë të izoluar si ti. Në fillim do të dëgjosh tak-tak-tak, tre të trokitura me kyçin e gishtit tregues. Të pyesin a na dëgjon. Ti do të trokasësh tre herë me kyçin e gishtit tregues, tak, tak, tak, dhe me këtë u thua se i dëgjon. Pastaj ata do të trokasin përsëri me kyçin e gishtit tregues ose me grusht. Ti do të numërosh sa herë trokasin, po që e trokitura me kyçin e gishtit

tregues tregon se aq herë sa trokiti aq ditë ke në qeli. Po qe e trokitura me grusht tregon se aq muaj ka në qeli. Mbase të mbarojë ai së trokituri ti do të trokasësh tre herë që e kuptove. Pastaj do të fillosh të trokasësh përsëri me kyçin e gishtit tregues aq ditë sa ke në qeli. Kur të mbarosh ti, ai do të trokasë tre herë që të thotë se e mori vesh mesazhin tënd. Pastaj ai me dorë do të bëjë një farë muzike me anë të trokiturave. Do të fillosh edhe ti të bësh si ai. Kjo është një farë bisede për të hequr mërzinë. Ky është mësimi fillestar i gjuhës së qelive, të tjerat do t'i mësosh me kohë. Tani largohu nga dera e birucës së po vjen gardiani të hapë sportelin. Po ndroheshin turnet.

Filloi dita: Na sollën çain pa sheqet e 50 gr bukë. Shkuam në banjë një nga një të shoqëruar nga gardiani për të larë pjatat e për nevoja personale.

- Ka njeri! Ka njeri! - ishte klithja rrëqethëse e gardianit që të çonte tek xhelati, hetuesi ishte xhelat. Ndoshta ndokujt që nuk e ka provuar qelinë komuniste do t'i duket absurde se si ka mundësi që hetuesi të jetë xhelati. Ndokush mund të ketë shokun e tij hetues, ose kushuririn, vëllanë, babanë, dashnorin dhe ai në jetën e përditëshme është i sjellshëm, i edukuar, gojëmjaltë, i njerëzishëm dhe i mëshirshëm. Mos u besoni njerëz! Mos u zini besë. Ata vënë maskë në shoqëri e familje. Ata janë xhelatët. Ata janë kriminelë e vampirë, sikur t'u jepej mundësia t'i shikonit gjatë proceseve hetimore nuk do t'u afroheshit. Dora e tyre është e akullt si zvarranik që s'ka gjak. Fryma e helmatisur se ata nuk kanë shpirt, por gjendrra helmi si kobrat.

Të gjitha qelizat e trurit tim ishin ndezur. Koka më zhurmonte si koshere blëtësh. Unë mendoja për pyetjen që do të më bënte

hetuesi dhe përgjigjet që do t'i jepja unë. Hetuesi do të më pyes - mendoja:

- Hë, u mendove?

- U mendova!

- Çfarë do të na thuash në lidhje me arratisjen e Baudinit?

- Nuk di gjë! .

Hetuesi: - Pse shkove në Konispol?!

- Më dërguan me shërbim, me urdhrin e sigurimit për të më fatur në kurth. Ai do të më pyes e unë do t'i përgjigjem.

Ai do të më thotë.....

Unë do t'i them.....

Këtë dalldisje të mendjes ma shoi zhurma tek dera e qelisë. Kishte ardhur gardiani për të më marrë. U përsërit e njëjta gjë: Lidhja e duarve mbrapa, kalimi nëpër korridorin e ngushtë e të errët të qelive. Refreni i gardianit: Ka njeri! Ka njeri! Por këtë herë nuk më çoi te dhoma numër katër; por te dhoma numër shtatë.

Ajo ishte një dhomë komode, e shtruar me sixhade e kolltuqe. Përballë ishte fotografia e Enver Hoxhës ulur në një karrike prej xunkthi, duke lexuar «Zërin e Popullit». Në dhomë përveç hetuesit ishin edhe pesë burra të tjerë. Ata më vështruan të gjithë mua, pa më folur. Hetuesi më bëri shenjë të ulesha, tek karrigia e vetme që ishte në dhomë, se ata ishin ulur në kolltuqe.

Hetuesi më prezantoi: Nëndrejtori i Drejtorisë së Punëve të Brendëshme, kryetari i hetuesisë i dërguari i ministrisë së Punëve të Brendshme dhe prokurori i Tiranës.

- Si e ndieni vehten? - më pyeti Prokurori i Rrethit, një burrë i shkurtër e barkalec.

- Mirë, - ju përgjigja.

- Doni ta dridhni një herë, më tha Nëndrejtori i Drejtorisë së Punëve të Brendëshme, një burrë me flokë të rëna përpara me trup të lidhur, prej atleti. Më zgjati një portofol meshini ku mbante duhanin dhe letrën.

- Nuk e pi, - i thashë.

- Ti e pi duhanin, por e refuzon, se na urren ne të sigurimit, - tha kryehetuesi. një burrë i gjatë, kokëmadh e me zë të trashë.

- Hetuesit do t'i tregosh me hollësi, se si u arratis Baudini dhe me ç' mision u nisi. Do ti tregosh edhe për grupin tuaj: kush ishin, çfarë shkruanit dhe çfarë diskutonit në ato mbërmmjet që organizonit tek shtëpia e Kalombos, atje tek rruga e famshme «Lord Bajron» - më tha i dërguari i Ministrisë së Brendshme, një burrë i pakët, me buzë të holla e të mbledhura si mi.

- Tani shko dhe mendohu mirë, - më tha kryehetuesi. Sekretari i Partisë së Drejtorisë së Punëve të Brendshme nuk foli fare, por sytë nuk m'i shqiti deri sa dola nga dera. Kur vajta në birucë gjeta pjatën me ujë, ku notonin dy. -tre kokrra fasule. Kisha njëzetekatër orë pa vënë gjë në gojë. E pashë atë latyrë të turbullt dhe m'u trazua, çdo shqisë po më venitej. Më solli në vehte era e leckës së djegur.

- Duhani, - u dëgjua një zë nga jashtë. Ishte gardiani që ndizte cigaret. Në derën e birucës ishte një vrimë që hapej nga jashtë e gardiani fuste një leckë të ndezur që i izoluarit të ndizte cigaren. Pastaj më nxorën në banjë. Kapteri të rrinte tek koka edhe në banjë. Erdhi imbasditja. Nga ora 16.⁰⁰ deri në orën 20.⁰⁰ në birucë ishte koha që të izoluarit binin shpirtërisht. Këto ishin orët më të trishtuara. Nëpërmend më kaloi e gjithë jeta ime. Lotët filluan të më rridhnin vetë, pa vetëdijen time, ashtu instiktivisht. Qante shpirti. Më përmendën të trokiturat në mur. U afrova dhe vura

veshin tek muri. Fillova të numëroj: Një, dy, tre... nëntë, trembëshjetë, njëzeteshtatë. Ai trokiste me grusht. O Zot!

Njëzeteshtatë muaj në qeli? U hutova dhe nuk i ktheva përgjigje. Ai trokiti tre herë me kyçin e gishtit tregues dhe filloi të trokasë përsëri me grusht. Përsëri trokiti njëzeteshtatë herë. I trokita tre herë rresht që e kuptova dhe pastaj me kyçin e gishtit tregues trokita dy herë. Ai trokiti tre herë rresht që e kuptoi dhe pastaj filloi të bëjë melodinë e një dajre në mur. Fillova edhe unë të bëj me të trokitura në mur si dajre. Kështu vazhduam deri sa erdhi darka. Mbasi u ndez cigarja e dolëm në banjë, filloi biseda me të trokitura deri sa u dha sinjali i pushimit në orën 21.⁰⁰. Atë natë s'më morën në hetuesi. Rashë për të fjetur në dysheme dhe u mbulova me batanijen e grisur.

- Tani Vjollca do të ketë shkuar tek bliri i lulëzuar dhe më pret. Ajo do të më presë sa do të më presë dhe pastaj do të largohet kokulur. Kush e di se çfarë do të mendojë për mua? Isha shumë i lodhur dhe gjumi më kapëlloi menjëherë. Sa ëndrra të bukura pashë atë natë! E çuditëshme, se në birucë të gjithë shohin ëndrra të bukura! Ndoshta vetë Zoti t'i dërgon ëndrrat që të të çlodhë apo i krijon vetë truri për të mbijetuar. Cicërima e harabelave mbi hekurat e fergjisë më zgjoi. E gjithë qenia ime ishte ripërtërirë. Filloi të zbatohet orari si çdo ditë mëngjesi, ndezja e cigares, dalja në banjë, zëri i gardian Aliut:

- Ka njeri! Ka njeri! Dreka. Ndezja e cigares, banja dhe orët e zbrazëta të mbasdites. Për pesë ditë rresht nuk më morën në hetuesi. Ditën e shtatë mora ushqime nga familja. O Zot sa u trishtova atë ditë. Ditën e nëntë rreth orës 18.⁰⁰ u hap dera e birucës. Më ngriu zemra. Filloi përsëri hetuesia, - thashë me vete. Kapter

Aliu, shtyu brenda një njeri, të veshur me rroba doku bojë ndryshku. Ai ishte i dobët, pak i kërrusur, ezmer dhe nga goja i rridhte gjak. Po e studioja me vëmendje.

- Ky do të jetë spiuni, - thashë me vehte.

- Vëlla, - ka ndonjë gjë për të ngrënë se kam tre ditë e tre netë pa ngrënë, në tortura. Ushqimet që më kishin sjellë nga shtëpia ja vura të gjitha përpara. Ai filloi të hante si i babëzitur. Ndoshta nuk është spiun, - thashë me vehte kur e pashë që hante ashtu. Mbasi i mbaroi ushqimet të gjitha filloi të mbante stomakun me dorë.

- Më zuri ushqimi, - më tha, nuk po e ndiej vehten mirë.

Kur ktheva kokën unë nga ana tjetër, ai i vuri gishtat në gojë dhe ja plasi të vjellit. Mënyra se si më shikoi kur futi gishtat në gojë më bëri të dyshoj.

- Bjeri derës se mbarova, - më tha.

- Bjeri vetë, - i thashë.

- Oh, rënkoi, nuk e sheh se po jap shpirt. Qenke kriminel. U zvarrit dhe filloi t'i bjerë derës.

- Çfarë ke?! - u dëgjua zëri i gardianit.

- Hape se mbarova!

U hap dera e birucës.

Gardiani i bërtiti, pastaj e çoi në banjë.

E di ç'ke ti, - më tha kur u kthye nga banja: - As mos më pyet pse kam rënë brenda dhe as mos të të pyes.

- Mirë, - i thashë. Ai mbështeste kokën tek pëllëmba e dorës dhe këndonte gjithmonë të njëjtën këngë: «Thotë babai je pëllumb i shkruar». Të nesërmen në mëngjes u hap dera e birucës dhe kapter Aliu, mori atë në fillim, pastaj erdhi dhe më mori mua. Kështu ndodhte gjithmonë. Merrej ai i pari, pastaj unë. Sapo dilte ai nga

biruca, më jepeshin mesazhet nga të izoluarit, me anën e murit - Ki mendjen, - Eshtë spluni më i rrezikshëm. Nuk është i burgosur, e sjellin nga jashtë vetëm në raste të veçanta.

Një ditë te dhoma e hetuesit ishin hetuesi dhe dy të tjerë. Ata më vështronin të tre të egërsuar.

- Si ke vendosur, do të tregosh apo do të lesh lëkurën këtu? - më tha hetuesi.

- Unë u kam thënë se e urrej komunizmin, por për ato që kërkonin ju nuk di gjë.

- Ashtu?! Atëhere ne do të bëjmë që të të kujtohen edhe sa herë ke pirë gjj tek jot ëmë, - më thanë. Pastaj më kapën të tre dhe më shtrinë në tavolinë, unë isha i lidhur me pranga këmbë e duar, më hoqën pantallonat, pastaj mbathjet. Më morën organet vegjetale dhe më vunë në bigë. Hetuesi mori dy thupra prej thane dhe filloi të më godasë mbi organet vegjetale sikur i binte xhezit. E shtrëngova gjuhën me dhëmbë derisa goja m'u mbush me gjak, por nuk durova dot. Nuk besoj që të ketë mashkull që ta durojë këtë torturë. Fillova të bërtas. Bërtita ose më mirë të them ulërita.

- Po tani si thua?! A do të pranosh ato që kërkojmë ne?

- Mjaft! - i tha njëri nga ata, se do të mbetet në dorë.

Nuk e gjen gjë se ka shtatë shpirtra si të maces, por dhe po ngordhi në të s..... të shkojë. E hedhim tek telat me gjemba. Një shkrehje e automatikut, një procesverbal që deshi të arratisë. Dëshmitar ushtari dhe oficeri operativ dhe selam në botën tjetër. Pastaj nuk ndjeva më gjë. Kur hapa sytë isha në qeli. Mbi kokë më rrinte shoku i dhomës. Ai kishte grisur këmbishën dhe po më fërkonte ballin dhe më vinte kompresa me ujë të ftohtë në organet vegjetale. Kur hapa sytë:

- Vëlla! - më thirri. - U përmende? Ke tre ditë e tre netë në kllapi. Çfarë të paskan bërë kriminelët? Këta janë sadista!

Unë e vështroja, por nuk e njihja, më dilte si nëpër mjergull dhe zërin nuk ja dalloja.

- Kush je ti? - e pyeta me një zë të fikur.

- Jam unë, shoku i dhomës, Luani, - më tha. E pashë përsëri.

- A më kujton tani? Unë tunda kokën se e njoha.

- Po çfarë ke bërë more lumëmadh që të torturuan në këtë farë feje?

Po e shikoja drejt në sy.

- Thuaja vëllait tënd, çfarë ke bërë dhe unë do të tregoj, çfarë të pranosh e çfarë të mos pranosh që të shpëtosh nga tortura se këta nuk kanë shpirt.

I hapa sytë dhe e pashë me urrejtje e neveri.

- Nuk je i kënaqur me kaq? Po deshe mos më mundo, më ler të më dalë shpirti rehat.

- Po unë të kam qëndruar tre ditë e tre netë mbi kokë më tha. Për të mirën tënde të them.

Vura buzën në gaz dhe i thashë:

- Unë të kam kuptuar që kur të sollën që je i vënë, prandaj mos u lodh kot. Kërko të të çojnë në një birucë tjetër.

- Ashtu! - më tha, po më akuzon. Kjo është një akuzë që vetëm me jetë paguhet.

E vështrova gjatë, pastaj i thashë:

- Ashtu është. Dy javë rresht nuk më morën më në hetuesi. Unë luftoja me vdekjen, ai nuk më fliste fare. Kur u përmirësova pak mbas njëzet ditësh më morën përsëri në hetuesi. Hetuesi sa hyri brenda, u afrua me një fytyrë të gëzuar sikur të mos kishte ndodhur

asgjë, më zgjati paketën dhe më tha: - Ndize!

Unë e vështroja pa folur.

- Isha nga shtëpia jote dhe të gjithë i kishe mirë, - më tha. Unë përsëri nuk fola.

- Bile biseduam edhe me kryehetuesin dhe vendosëm të të bëjmë një takim me nënën.

Kameleonët ndryshojnë ngjyra dhe i përshtaten ambientit për të mbijetuar. Kurse hetuesat e sigurimit shqiptar ndryshonin fytyrë, herë si engjëj e herë si vampirë për të më mashtruar.

- Ti mendohu mirë, na trego për shokët, se ne me ty nuk kemi asgjë, më tha. Do të lemë dhe ca ditë pushim që të mbledhësh veten. Po deshe të japim edhe letër e laps për të shkruar se çfarë të kujtohet nga veprimtaria e grupit tuaj.

Pastaj i foli kapter Aliut:

- Merre, - i tha. Kur dola tek dera, ktheva kokën mbrapa. Vështrimet tona u kryqëzuan. Ai po më vështronte sikur do më përpinte. Sytë e tij ishin bërë shkretëtirë prej akulli dhe në atë shkretëtirë lëvrinin gjarpërinjtë e urrejtjes.

Kur vajta në birucë, nuk e gjeta shokun e dhomës. E kishin hequr.

- Ma paskan hequr shokun, - i thashë gardianit.

Ai m'u afrua tek sporteli dhe më tha duke mërmëritur sa mezi dëgjohej: Ishte spiun, ishte spiun. Një ditë kur dola në banjë pashë fytyrën time të parruar te një pellgth i vogël uji. U tremba. Nuk e njoha veten time në fillim. Atje kishte dalë një fytyrë e përçudnuar. I mbylla sytë për një moment dhe i hapa përsëri. Fytyra e parruar në ujë më shikonte mua. Ishte një fytyrë e verdhë dhe e buhavitur, me ca sy të dalë nga zgavrat dhe me një kokë të madhe të qethur dhe

të bardhë borë.

O Zot, unë jam!? - mërmërita me vehte. Po unë isha me flokë të verdhë kur u futa në birucë. Pse brenda muajit u paskam thinjur?! Po koka pse më është rritur?! Po sytë pse më kanë dalë jashtë zgavre?!

Kur shkova në birucë u ula tek qoshja dhe pas kaq ditësh intensive hetuesie m'u kujtua ajo natë. M'u kujtua Vjollca. Po ajo çfarë bën tani? Ku ndodhet? A më kujton, a ka marrë vesh se unë jam arrestuar dhe pse jam arrestuar. Pastaj humba në krahët e fantazisë. Kur të dal do të shkoj ta kërkoj. Ajo nuk do të më njohë në fillim. Pastaj unë do t'i tregoj se kush jam. Ajo do të më hidhet në krahë duke u ngazëllyer. Të trokiturat në mur më sollën në vehte. Mbasi më dhanë lajmet e ditës, filluan të biseduarit për të kaluar kohën. Një natë, aty rreth orës 21, u dëgjua llozi tek dera e birucës. Filloi hetuesia, - thoshte me vehte dhe gjithë trupi m'u ngjeth. Por jo. Në dhomë u fut një djalë me trup të lidhur si atlet e me kokë të qethur. Unë rrija në këmbë, i mbështetur pas murit. Ai la plaçkat në tokë dhe erdhi e më dha dorën, duke më thënë:

- Mos u mërzit. Bashkë do të kalojmë mirë. Veshi më zuri një fërfërim tek dera e birucës. Kiheva kokën dhe tek syri magjik pashë syrin e hetuesit. Syri magjik u mbyll. Ai ishte tërë energji. Unë i hapa muhabet femrash. Ai dëgjonte si i babëzitur. I tregova histori dashurish reale dhe të fantazuara. Edhe ai më tregoi historinë e një dashurje të tijën. Pastaj më tregoi historinë pse e kishin arrestuar. Në qytetin e tyre provincial ishte një vajzë 16-17 vjeçe shumë e bukur, por ishte e prekur. Asaj ja kishin pushkatuar babain, xhaxhain dhe gjyshin. Jetonte me nënën dhe gjyshen plakë. Një ditë ky i kishte shkruar një letër dashurie, ku i thonte se e urrente

komunizmin. Vajza letrën ja kishte treguar nënës dhe gjyshes. Ato të frikësuar e kishin çuar letrën në degën e punëve të brendshme. Ata e kishin thirrur Hyrien, kështu e quanin gocën e bukur me biografi të keqe dhe i kishin thënë: Ti, dili e bëji numra, bëji me dorë dhe buzëqeshi. Ajo kishte vepruar ashtu siç e kishin porositur ata të sigurimit. Ky atëhere i kishte shkruar një letër tjetër, ku i thoshte se kishin organizuar një grup për rrezimin e pushtetit popullor. Përsëri nëna e vajzës letrën e çoi në degë. Ata i thanë vajzës: Lëri një takim, ditën e dielë, në orën nëntë, në Tiranë, përpara reklamave të kinemasë. Hyrija i doli dhe i tha: Takohemi në Tiranë. Atë nuk e zuri gjumi tërë natën. Në autobus për në Tiranë, goca ishte me një burrë të shëndoshë. Ai ju vardis, por goca fshehurazi i tha: - Mos më fol tani se jam me dajën. Në orën nëntë ky kishte shkuar për t'u takuar me vajzën, daja i vajzës dhe dy të tjerë e mbërthyen dhe e rrasën në një gaz. I hodhën hekurat dhe i thanë që në emër të popullit ishte i arrestuar. Pastaj tregoi torturat dhe pyetjet absurde që i bënte hetuesi. Ndenjëm duke biseduar deri vonë. Kur ramë për të fjetur unë i thashë: Nga muhabeti m'u duke flori nga zemra. Do të pyes për diçka, por dua të më tregosh të vërtetën.

- Do ta tregoj, - më tha.

- Dua të di se si je bërë spiun?

Ai u skuq, pastaj i iku fytyra fare. Nuke desh veten. Më pa drejt në sy dhe më tha: Më kanë bërë me zor, mor u q..... nënat dhe nga sytë i rrodhën lot.

- Mirë, - i thashë, - unë do të tregoj çfarë t'i thuash hetuesit kur të të pyesë. Mirë, më tha. Ne me Sherifin qëndruam një muaj bashkë. Ai ishte me të vërtetë djalë i mirë. Këtë ma transmetuan

edhe të izoluarit e tjerë. Ishte viktimë e torturave. Sigurimi Shqiptar, përveç burgjeve, internimeve dhe dëbimeve, përveç luftës së klasave që përçau kombin, përveç vrasjeve më gjyqë dhe pa gjyqë përdhosi dhe shpirtin e popullit. Ai i bënte njerëzit spiuna me dhunë. Komunistat e kishin detyrë spiunimin. Po të ishte komunist ishte spiun vullnetar. Komunistat kishin për detyrë të spiunonin nënën, babain, gruan, vëllain, motrën, fëmijën, shokun dhe mikun, kurse popullin e thjeshtë e detyronte të bëhej spiun me metoda nga më çnjerëzoret. Në lagjen tonë ishte një djalë, 26-27 vjeç. Ai ishte shumë i zgjuar, zotëronte disa gjuhë të huaja, kishte shoqëri të zgjedhur dhe reputacion në shoqëri. Ata të sigurimit ja vunë synë dhe deshën ta rekrutonin. E thirrën dhe i premtuan pozita, se do ta nxirrnin jashtë shtetit e plot privilegje të tjera, por ai nuk pranoi. Atëhere e kërcënuan me burgim, vdekje dhe kërcënime të tjera, por ai nuk u përkul. Urdhëri ishte që të rekrutohej me çdo kusht. Atëherë ata të sigurimit studiuuan rrethin e tij shoqëror dhe familjar. më në fund ata e gjetën grepin. Ai kishte një nuse vëllai shumë të bukur, por bibe siç thonë shkodranët. Një ditë e thirrën atë në Degën e Punëve të Brendshme. Atje ishin mbledhur gjithë peshkaqenët.

- Ç'sy të bukur që paska, - tha njëri nga peshkaqenët. Tamam si të Mataharri Ajo filloi të tundej se u miklua.

- Kjo mund të bëhet Mataharri shqiptar, - tha një tjetër.

- A të pëlqejnë librat me spiunazh? - e pyeti tjetri.

- Shumë, - u përgjigj bukuroshja. Ata i dhanë në fillim libra spiunazhi, pastaj i bënë dhurata derisa ajo firmosi deklaratën se pranonte të bashkëpunonte me organet e sigurimit. Në fund i thanë se tani ka ardhur koha të japësh provat. Për këtë vend, - i thanë, -

kemi disa femra të bukura e të zgjedhura si ti. Do t'i provojmë, kush të fitojë do të jetë Mataharri shqiptar dhe do ta nisim menjëherë jashtë me shërbim. Ato të tjerat provën do ta bëjnë me burra të panjohur, kurse ti do ta bësh me kunatin tënd. Ai fle në dhomën e tij vetëm me mbathje. Ti do t'i futesh në dhomë lakuriq, ashtu siç të ka lindur nëna dhe do t'i hidhesh në shtrat. Ai do të përpiqet të të shtyjë, kurse ti do ta përqafosh. Po munde ulja dhe mbathjet. Sa më mirë ta luash pjesën aq më shumë pikë do të fitosh.

- Mirë, - u tha ajo dhe një ditë e zhveshur i shkoi kunatit në dhomë. Ai kur e pa u tmerrua dhe ju lut të dilte përjashta, por ajo sipas porosisë ju hodh përsipër. Ai e shtynte, por ajo e përqafonte. Në dhomë ishin instaluar kamera spiune. Pas disa ditësh ata të sigurimit e thirrën në degë dhe i thanë:

- Hë, a t'u mbush mendja.

- Unë jua kam thënë njëherë, - u tha ai. Eshhtë e kotë çdo bisedë mbi këtë temë.

- Mirë, - i thanë ata. Hape njëherë këtë album, - dhe i vunë përparanjë album me kapak të kuq. Kur e çfletoi albumin ai ngriu. Atje ishin me dhjetëra poza ku kishte dalë ai me kunatën lakuriq. Kamerat e fshehta i kishin xhiruar sikur përqafoheshin. Atij nuk i mbeti pikë gjaku në fytyrë.

- Hë, ç' thua? - i thanë ata.

- E pamundur, ua ktheu ai.

- Tani dëgjo këtu, i thanë, - këto poza do t'u dërgohen jo vetëm vëllezërve, motrave, prindërve e miqve e shokëve të tu, por edhe atij që i ke thënë vetëm një herë mirëmëngjes.

- A do më lini dy orë të mendohem? - u tha ai.

- Mirë, - i thanë.

Ai iku dhe s' u kthye më. Kur vajtën për ta kërkuar e gjetën të varur. Ai kishte varur vehten. Pas dhjetë ditësh e filloi përsëri hetuesia. Hetuesi lexoi një listë me dyzet emra. Këto ishin të gjithë të afërm, shokë, miq e të njohur të mij. Për secilin më zhvilloi dy seanca hetimi. Pyetjet e tij ishin të përgjithshme:

- E njeh filanin.

- E njoh.

- Çfarë mendimi ka ai për regjimin?

- Ku ta di unë!

- Çfarë ke biseduar me të?

- Gjëra të përgjithshme për artin e letërsinë.

- Çfarë ka thënë ai për artin e realizmit socialist? A e keni diskutuar ndonjëherë? Na i riprodhoni të gjitha muhabetet e tyre edhe mirë të ketë folur. Po B.XH. çfarë thoshte? Unë për t'i shpëtuar pyetjeve për B. XH. i thashë një ditë:

- B. XH. nuk merrej fare me politikë. Për këtë po të tregoj një shembull, megjithëse rëndon mbi mua. Por, këtë e bëj për të vërtetuar se ai s' e kishte idenë e politikës. Një ditë në muhabet e sipër unë i thashë: Këta s' janë në vehte, gjithmonë bëjnë lidhje miqësore me vende që janë disa shekuj pas vendeve të zhvilluara. Ç' u duhet atyre miqësia me kinezët. Ata jetojnë nëpër barka dhe ushqehen me krimba. B.XH. më pa dhe më tha: Ti do të merresh me letërsi e art apo me politikë? A më sheh mua, po shkoj 30 vjeç dhe nuk e kam lexuar njëherë «Zërin e Popullit».

Por a e dini se ç' ndodhi. Ata të hetuesisë këtë e morën dhe e bënë bazë të akuzës. S.D.-në e futi në rrugë armiqësore, armiku i Partisë së Punës. B.XH. kur i tha që s' e kam lexuar asnjëherë «Zërin e Popullit».

- Po ti çfarë ke thënë për realizimin socialist?

- Kam thënë që është një rrymë skematike në shërbim të regjimit.

- Po për Gorkin dhe Majakovskin çfarë ke thënë? Kam thënë fjalët e një kritiku polak që Gorku vinte fjalët e Stalinit në prozë, kurse Majakovski vinte fjalët e Stalinit në poezi.

- A i ke lavdëruar: Esemin, Pasternakun, Kafkën Kamyn?

- Po, i kam lavdëruar.

Hetuesi këtë herë nuk vuri dorë mbi mua se ishte i kënaqur nga zhvillimi i hetimeve. Pas kësaj më bënë një lojë që ende më ka mbetur enigmë.

Një ditë kur po kthehesha nga hetuesi, tek dera që ndan korridorin e birucave me atë të hetuesisë u ndodha ballë për ballë me një vajzë të bukur rreth 18 vjeç. Atë po e shoqëronte për ne hetuesi gardiania Vasilika. Kapter Aliu i bërtiti Vasilikës: Pse nuk fole që a ka njeri? Por edhe Vasilika ja ktheu me inat: Po ti pse nuk fole? Ata bënin sikur ziheshin dhe na lanë ne të dyve gati një çerek ore. Ajo kishte ulur kokën, por herë pas here më hidhte vështrime plot dhimbshuri: O Zot, - thashë me vete, - ç'ka bërë ky engjëll që e kanë sjellë në ferr?

Një mbasdite gushti, kur temperatura në qeli arrinte rreth 40 gradë celsius, kapteri i shërbimit hap derën e qelisë dhe më thotë:

- Do të dalësh të freskohesh pak në banjë?

- Mirë, - i thashë dhe mora pantallonat për t'i veshur se isha me mbathje.

-S'ka gjë, - më tha kapteri, - shko kështu siç je se nuk ka njeri.

Ai më nxori nga qelia dhe më tha: Bjeri derës kur të mbarosh, dhe iku tutje korridorit. Unë u habita se kjo s'kishte ndodhur

ndonjëherë. Gardiani të qëndronte te koka deri sa të mbaroje të gjitha nevojat. DO të jetë ndonjë gjë, thashë me vehte, por nuk arrija ta kuptoja se çfarë ishte. Kur hapa derën e banjës, ngriva. Vajza, që para disa ditësh u takova si papritur ishte zhveshur dhe po lahej. Ajo instiktivisht lëshoi një thirrje ou! dhe të dy pëllëmbat e duarve i vuri përpara organit të saj për t'u mbuluar, u mblodh sa një grusht. Megjithëse e kuptova që kjo që loja e hetuesit dhe desha ta mbyllja derën menjëherë. Instiktet epshore prej mashkulli më gozhduan për disa çaste në vend. O Zot sa linja të përsosura femërore që kishte. Dukej si një ëngjëll në ferr. Unë e mbylla derën dhe u nisa drejt birucës.

- Pse nuk u fute brenda? - më pyeti gardiani.

- Kishte njerëz, i thashë.

- Kush ishte, - pyeti ai si i habitur.

- Ishte një femër.

- Femër?!

- Futu, - më tha.

- Unë e pashë drejt në sy dhe u futa në birucë.

Ai vuri llozin dhe nuk më tha asgjë. Një ditë tjetër kisha larë teshat dhe gardiani më futi tek dhoma e tharjes dhe e mbylli derën nga jashtë. Brenda ishte po ajo femër dhe po nderte teshat e saj. Ajo qëndroi si e ngrirë për një çast dhe më pa drejt në sy. Edhe unë e vështrova. Ajo mblodhi supet sikur donte të thoshte: Çfarë është kjo? Edhe unë i mblodha supet duke i thënë se nuk e marr vesh se ç' duan nga ne. Kur bëra t'i flas ajo ma vuri dorën në gojë duke ma bërë me shenjë që të mos flisja se çdo gjë inçizohej. Ne rrinim si statuja duke parë hjëri-tjetrin. Në sytë e saj unë lexova vuajtje, mall, brendë, urrejtje dhe shpresë. Ne qëndruam edhe pak çaste,

por me anën e syve shkëmbyem plot mesazhe. Ne u mallëngjyem se pas kaq muajsh tortura çnjerëzore, fizike e shpirtërore, na u ngroh shpirti nga mesazhe njerëzore. Unë i rashë derës dhe gardiani bërtiste:

- Prit! Prit! - nga fundi i korridorit.
- Pastaj erdhi dhe tha: Çfarë ke që nuk pret?
- Këtu ka njerëz komandant.
- Po pse nuk i re derës që në fillim?
- I rashë, por ju thatë që të prisja.
- S'ke faj ti, më tha, dhe më futi në qeli.

Gjithë atë natë s'më zuri gjumi. Në sy më mbeti fytyra e saj. Pastaj rrija e vrisja mendjen se kush ishte ajo? Kur kishte ardhur në qeli? Në cilën qeli ndodhej? Pse nuk e kishin transmetuar shokët, se çfarë kërkonin të bënin me këto koiçidenca takimesh?!

Kur shkova për të marrë teshat në dhomën e tharjes në vend të mbathjeve të mia ishin një palë mbathje femrash. Unë mblodha teshat e mia dhe atje lashë vetëm mbathjet e femrës.

Pas pak vjen gardiani, hap sportelin dhe më thotë: Po mbathjet pse nuk i more?

- Ato janë mbathje femrash, - i thashë, - të miat nuk i gjeta.
- Na merri këto, s'ka gjë, - më tha dhe m'i hodhi në birucë.

Unë kundërshtova dhe i thashë se nuk kam ç'i dua, por ai më tha që të rrija rehat se pastaj e dija vetë, se po na bën shumë naze. Mbathjet kishin të qenditura V.S. U përpoqa që me anën e siglës V, që ishte emri dhe S., mbiemri, të gjeja se si e quanin, dhe me mendjen time formova të gjitha emrat e femrave që fillonin me gërmën V: Veronika, Vangjeli, Vasilika, Violeta, Valentina, Viola, Vjollca, Virgjini, Valbona, Vana, Verdira, Vada, Vanesa, Virona,

Valdete, Vana, por më tepër mua më pëlqente ta kishte Vjollca. I ras, i murit dhe kërkova informacion për këtë femër enigëm. Ata më dhanë këtë njoftim: Ka ardhur para njëzet ditësh, është në birucat e katit të parë. Janë përpjekur të gjithë ata që ka përbri me anë të murit, të gjithë ata që ka karshi birucës së saj, por asnjë përgjigje. Ajo është shumë e trembur, ka frikë se e provokojnë. Pastaj në katin e parë janë të gjitha ordinere. Ky ishte informacioni. Unë atë natë fjeta me mbathjet e saj, dhe bëra një eksitim barbar. Që atë natë e fillova rregullisht eksitim barabar dhe të them të drejtën që Frojdi ka të drejtë kur thotë se eksitimi barabar është i domosdoshëm për organizmin.

Që atë ditë unë e ndiej veten më të qetë, më të sigurt dhe se jetën s'ka forcë njerëzore që e ndal. Ajo do të rrjedhë në shtratin e saj deri në pafundësi.

Pastaj hetuesja filloi të paraqesë provat. Gjatë kontrollit në shtëpi më kishin gjetur dy fabula: «Kopshti Zoologjik» dhe «Bilbili, bretkoca dhe gomari». Gjatë paraqitjes së provave, bashkë me hetuesin, vinin: Nëndrejtori i drejtorisë së Punëve të Brendshme, Prokurori i rrethit të Tiranës dhe kryehetuesi. Gjatë kontrollit që u bë në dhomën tuaj pas arrestimit u gjetën këto dy fabula - më tha Nëndrejtori i drejtorisë së Punëve të Brendshme. Pa shih njëherë, - më tha dhe më nxori dy fletore.

- Po, - i thashë, - të miat janë.

- Hetuesi do t'i lexojë me zë dhe ne do t'i dëgjojmë.

- Fillo! - i tha hetuesit.

Bilbili, bretkoca dhe gomari, - filloi të lexojë hetuesi.

Në pranverë bilbili hipi në një degë frashëri dhe nisi të këndonte. Pas pak, doji nga moçali një bretkocë dhe filloi edhe ajo

këngën e saj.

- Mjaft, - i tha bilbili bretkocës se më shurdhove!
- Pse, - i tha bretkoca, - se mos këndon më mirë ti?
- Kjo dihet, - i tha bilbili.
- Mirë, - i tha bretkoca, - pyesim se kush këndon më mirë.
- Cilin të pyesim, i tha bilbili.
- Atë që merr vesh nga muzika!
- Kush merr vesh nga muzika?
- Ai që i ka veshët më të mëdhenj.
- Kush i ka veshët më të mëdhenj?
- Gomari.

Matanë lumit, në një lëndinë, po kulloste një gomar. Bilbili fluturimthi e bretkoca me not e kaluan lumin dhe shkuan tek lëndina ku po kulloste gomari.

- Mirëmëngjes, - zoti gomar, i thanë ata.
- Mirëmëngjes, ua ktheu rëndë rëndë gomari.
- Ne kemi ardhur tek ti për të na zgjidhur një problem, - i thanë.
- Çfarë problemi keni, u tha gomari.
- Ne duam të dijmë kush nga ne këndon më bukur, - u kam dëgjuar shumë herë, tha gomari, - por dua që t'ju dëgjoj edhe një herë.

E para këndoi bretkoca.

- Shumë mirë! - i tha gomari duke përplasar veshët.

Pastaj këndoi bilbili.

- Shumë mirë! - i tha gomari dhe përplasi veshët përsëri.
- Po ti nuk na the se kush këndon më bukur, - i thanë ata.
- Ju këndonit të dy njësoj, prandaj s'di se kë të shaj dhe kë të lavdëroj, - u tha gomari.

Dhe që atëhere, megjithëse bretkocën askush nuk e dëgjon, ajo këngën e vazhdon se ka gomarin që e lavdëron.

- Ti e ke shkruar? - më pyetën.

- Po, - u thashë.

- Fillo e lexo të dytën, - i thanë hetuesit.

Kopshti Zoologjik, filloi të lexojë ai.

Një herë sollën në kopshtin Zoologjik një tigrë. Ai kur hyri brenda pa se nëpër kafaze kishte kanarina, papagallë, fazanë, palloj, majmunë, arinj e plot kafsha të tjera. I pikoi në zemër kur i pa ashtu të mbyllur nëpër kafazë hekuri. Por, kur filluan të këndonin kanarinat ai u befusua. S'ka mundësi, - tha ai, - të të mbyllin në kutvi dhe të këndosh për ta për t'i argëtuar. Po, kur pa se pallojtë fryheshin e demonstironin bukuritë e thesaret e trupit të tyre e arinjtë hapnin gojën si shpellë, kur u thoshin të hapnin gojën dhe u hidhnin karamеле, fruta, copa buke, gurë dhe shuka letrash, tigrë sa nuk u çmend.

Ai ulëriu sa u drodh tërë kopshti Zoologjik.

- Mjaft më!

- Në kopsht nuk pipëtiu më gjë. Ra një heshtje si prej varri.

- S'keni turp! - u tha tigrë.

- Pse? - e pyetën si të drojtur kafshët e kopshtit Zoologjik.

- Ç'po bëjmë ne?

- Si morë çfarë bëni?!

U kanë marrë lirinë dhe ju kanë mbyllur nëpër kafazë hekuri dhe ju këndonin për t'i argëtuar, u drejtua kanarinave, kurse ju u tha pallonjve u dëfteni bukuritë e trupit tuaj dhe ju u tha arinjve që ishit krenaria e pyjeve jeni bërë si lolo dhe për një kockë e hapni gojën si shpellë, si s'keni turp!

- Po çfarë të bëjmë sipas teje, - i thanë kafshët.

- Çfarë të bëni?! u tha tigri, - të vrisni të zotin e kopshtit zoologjik, t'i shpërtheni kafazët prej hekurash, ta shturni kopshtin e rrethuar me tela e me gjembë dhe të fluturoni të lirë në pyje e orgaja dhe të këndonni këngët e lirisë, të këndonni për jetën, natyrën, dashurinë.

Kafshët e kopshtit zoologjik ranë në mendime.

Pas ca ditësh, i zoti i kopshtit zoologjik u gjet i vrarë. Të gjitha kafazët ishin të shkallmuar, kopshti i rrethuar me gjemba ishte shthurur. Të gjitha kafshët kishin fituar lirinë. Tigri kishte mbetur tek dera e kopshtit zoologjik.

- Po këtë ti e ke shkruar? - më pyeti nëndrejtori.

- Po, - i thashë.

- Tani më trego se çfarë ke dashur të thuash me fabulën e parë dhe çfarë ke dashur të thuash me fabulën e dytë?

- Fabulat mund t'i interpretosh si të duash, - i thashë. Unë i kam shkruar thjeshtë për fëmijë.

- Po morali cili është?

- Morali tek e para është se bilbili këndon më mirë, por injorantët pëlqejnë këngën vullgare.

- Ashtu?!

- Po.

- Po morali i fabulës së dytë.

- Dihet që liria është e bukur.

- Që ta marrësh vesh ti këto dy fabula i kanë studiuar një grup ekspertësh kopetentë nga lidhja e shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë dhe ata kanë komentuar me hollësi domethënien e çdo fabule.

Ja seç thanë për fabulën e parë: Me bilbilin autori portretizon artistin e zgjedhur, kurse me bretkocën masën. Gomari, që i lavdëron të dy dhe fjalët e fundit e vërtetojnë më mirë, se bretkocën asnjë s'e dëgjon, por ajo këngën e vazhdon se ka gomarin që e lavdëron, kuptohet fare thjeshtë se bëhet fjalë për udhëheqësin tonë kryesor shokun Enver.

- E pranon këtë konkluzion?

- Jo, nuk e pranoj.

- Mirë, atëhere dëgjo konkluzionin për fabulën e dytë: Me kopshtin zoologjik autori simbolizon Shqipërinë, që është e izoluar dhe e rrethuar me tela e gjemba e klon. Kanearinat, sipas teje janë: shkrimtarët, poetët, kompozitorët dhe këngëtarët që i këndojnë partisë. Pallojtë janë balerinat e valltarët që argëtojnë pushtetarët dhe arinjtë janë heronjtë e luftës që gënjehen me pensione e dekorata. I zoti i kopshtit është pushteti popullor që udhëhiqet nga shoku Enver dhe tigri është kundërrevolucionari që bën thirrje për kryengritje dhe për përmbysjen e pushtetit popullor për terror dhe për vrasjen e shokut Enver.

- Po këtë e pranon kështu siç e thonë kritikët?

- Jo, nuk e pranoj.

- Dihet që nuk do të pranosh, megjithëse ti e di më mirë se ata, se çfarë ke dashur të thuash, por e di ç'të pret, prandaj nuk e pranon. Por, dije mirë mor armik i betuar se e pranove, nuk e pranove e njëjta gjë është për ty, litari të pret, - më tha kryehetuesi.

* * *

Kaluan më se dy javë dhe s'po më merrnin në hetuesi, bile nuk na nxirrnin as në ajrosje, nuk më çonin për të bërë banjë, as për të larë teshat, as për t'u ndërruar e as për t'u rruar e qethur sipas rregullores së qelisë. Pantallonat e dokur dhe këmisha m'u veshën si pazmore dylli nga zhuli. Një ditë, kur dola në banjë pashë fytyrën time të pasqyruar në pellgun e ujit, flokët më ishin rritur e më kishin mbuluar veshët, ishin të thinjura kryjesisht, fytyra e buhavitur me sy të dalë nga kokërdhokët. Edhe nëna ime po të m shikonte ashtu nuk do të më njihte. Unë të jepja përshtypjen e një eremiti plak rreth 70 vjeç që ka vite i mbyllur në shpellë, megjithëse unë ende nuk i kisha mbushur 27 vjeç. Nuk e mbaj mend se sa më mbajtën në atë gjendje, por një ditë prej ditësh u hap dera e qelisë, më mori gardiani dhe nuk më çoi si zakonisht tek dera e hetuesisë, por hapi dyert prej hekuri të shkallëve dhe më zbriti në katin e parë. Pastaj hapi edhe dy dyer të tjera prej hekuri dhe më nxorri në oborrin e burgut. Ku po më çon? - thashë me vehte. Truri filloi të më punojë intensivisht, por asnjë hamendje nuk më thoshte se ku po më çonin. U hapën dhe dy dyer të tjera prej hekuri. Veshi më kapi ca zëra. Fjalët u kapën copa copa:

-..... Jestudent..... S'ke..... Eshtë armik..... çfarë turp..... apo.....

Pastaj më futi në dhomën e postbllokut. Aty ishin dhjetëdhjetë burra. Unë njoha hetuesin, kryehetuesin, nëndrejtorin e drejtorisë së punëve të brendshme dhe o Zot, një nga ata shokët e mi Xh. M-ja. Ai ishte veshur me një kostum të zi. Ai nuk më njohu

në fillim.

- E njeh? - e pyeti hetuesi.

Ai hapi sytë dhe mblodhi supet. Jo, - tha.

- Eshhtë kryetari i grupit tuaj, Saimiri, sa shpejt e ke harruar.

Ai u zverdh. Vuri të dy duart në kokë dhe tha:

- O Zot! O Zot!

- Po ju e njihni?

- Po!

- Kush është?

- Xh.M.-ja.

- Tashti e njohe? - i thanë atij.

- Po, u përgjigj si i mekur.

- Kush është?

- Saimir Derveni!

- Si jeni njohur?

Pastaj Xh.M.-ja tregoi se si ishim njohur.

- Ti a ke shkruar ndonjë tregim për një vajzë se si bëhet prostitutë dhe pastaj internohet? - më pyeti mua kryehetuesi Koço. Unë u mendova pak dhe i thashë se nuk më kujtohej.

- Po ti ç' thua ka shkruar? - e pyeti Xh.M.-në. Ai uli kokën dhe nuk po fliste.

- Hë, e mos të vije hiç zor se ai armik i partisë është, e ka zgjedhur vetë atë rrugë. Ty, partia të ka dhënë bursën, je student. Thuaja edhe këtij ato që na the ne.

- Ka shkruar, - foli ai si i mekur.

- Më thuaj titullin e tregimit, - i thashë.

- Vjeshtërat qajnë, - më tha ai.

E kuptova. Ai ishte zbërthyer. Këtë tregim e kisha shkruar unë.

U mendova pakëz edhe i thashë se nuk më kujtohet, më thuaj pak fillimin e tregimit.

Ai ma tha.

- Më thuaj të gjithë tregimin, - i thashë.

Ai e riprodhoi të gjithë tregimin sikur në shiritat e trurit të tij ta kishte të inçizuar.

- Jo, - i thashë, këtë tregim nuk e kam shkruar unë, por shiko se mos ta ka lexuar ndonjë tjetër dhe ma vesh mua. Ai ngriti sytë dhe më tha: Këtë e dijnë edhe të tjerë. Ishim shtatë veta kur na i ke lexuar tek lulishtja e rrugës së «Elbasanit» dhe ai filloi të thotë emrat e atyre që e kishin dëgjuar nga unë.

- Ju, mund të keni shkruar vetë, - i thashë, - dhe të kurdisur nga këta doni të ma vishni mua. Unë nuk kam shkruar një tregim të tillë.

Ai kishte të drejtë, , të gjitha ato që thoshte ishin të vërteta, por unë s'doja ta pranoja, se tregimin nuk e kishin kapur, por edhe për çpshtje kapriçoze se unë e dija si ta pranoja si të mos e pranoja për mua ishte njësoj dënimi. Ata mbasi e panë se Xh.M. ishte shumë i tronditur dhe i trembur, filluan të loznin si macja me miun me të. Njëri thoshte ta lemë të ikë, kurse tjetri thoshte ta mbajmë ca ditë brenda. Një tjetër tha: Edhe ky armik është si i pandehuri. Ai i dëgjonte dhe gati sa nuk i pushonte zemra.

- E sheh si është katandisur ky, - i thanë për mua. Kështu do të përfundojnë të gjithë armiqtë e partisë si minj qelive dhe pastaj nga një plumb pas koke. Shikoje mirë dhe u thuaj dhe të tjerëve se kushdo që ngrihet kundër partisë dhe shokut Enver do të përfundojë si ky. Tani lëreni të thyej qafën, - tha nëndrejtori i drejtorisë së punëve të brendshme.

- Jepi laps dhe letër dhe le të mendohet në birucë dhe po ju

kujtua të shkruajë se shkrimtar është i tha kryehetuesi hetuesit dhe u largua duke më parë mua si triumfgator dhe me një buzëqeshje ironike.

Më çuan në birucë. Pas pak erdhi hetuesi dhe më hodhi brenda një laps dhe disa fletë të bardha. Atë natë nuk hëngra darkë. Gjumi nuk po më zintë. Mora lapsin dhe letrën dhe nisa të shkruaj. Mafia në regjimet komuniste është e ngritur në sistem, kurse në sistemin kapitalist mafioz janë grupe njerëzish. Cila është më e rrezikshme? Shteti i bazuar në ligje demokratike, i pakorruptuar e lufton dhe e çduk mafien. Kurse grupet mafioze sado të organizuara dhe të forta që të jenë nuk i bëjnë gjë shtetit. Mafiozët vrasin, grabisin shtetin kurse shteti mafioz grabit popullin e vet dhe vret e përdhunon, burgos e internon kundërshtarët e tij politikë që janë njerëzit më të ndershëm të kombit.

Ne shtetet komuniste kryetar i mafies shtetërore është sekretari i parë i komitetit qendror të Partisë, kurse në ministrinë e Punëve të Brendshme janë të gjithë mafiozë që nga operativi i thjeshtë i sigurimit e deri tek ministri i punëve të brendshme. Kubeja e mafies së kuqe është Byroja Politike e në krye të kubesë është sekretari i parë, pra mafia e ngritur në sistem është miliarda herë më e rrezikshme se mafia e grupeve të veçanta. Pastaj shkrova poezitë:

Xhelati

.....

.....

Thirrje

.....

.....

Vetëm ëndrrat

.....
.....
Kaluan pesë gjashtë ditë dhe s'po kujtoheshin që të vinin të më merrnin. Ditën e shtatë i rashë derës dhe i thashë të më thërrisnin gardian Aliun.

- Çfarë ke? - më pyeti nga sporteli.

- Hetuesi më dha këto pesë e gjashtë letra dhe më tha kur të mbarosh punë jepja kapter Aliut që të m'i japë mua. A ju ka thënë gjë?

- Bjeri, - më tha.

Unë ja mblodha dhe ja dhashë.

Në mesnatë u zgjova nga zhurma e llozit tek dera e birucës. Hyri kapter Aliu, shumë i inatosur. Më lidhi duart mbrapa dhe më shtrëngoi prangat deri në zero. Në kokë më hodhi një batanije të kuqe. Këtë nuk e kishte bërë asnjëherë gjatë gjithë atyre muajve të hetuesisë.

- Ka njeri! Ka njeri! - gërthiti gjatë gjithë korridorit. Më çoi tek dhoma numër shtatë. Kjo ishte dhoma e hetuesisë speciale. Dhoma ishte mbushur plot e përplot me sigurimsa. Ishin të egërsuar në fytyra. Vetëm Ministri ishte i qetë.

- Si je? - më pyeti.

- Mirë, - i thashë.

Përpara, mbi tavolinë, kishte fletët që kisha shkruar unë.

Këto, ti i ke shkruar? - më pyeti.

- Po, - ju përgjigja.

- Pse e bërë këtë?

Ë bëra për t'ju treguar hetuesve se unë jam armik i Partisë së Punës se e urrej komunizmin dhe për këtë jam koishent. Por, nuk

pranoj gjëra që nuk i kam si p.sh. agjent i huaj, terrorist, tradhëtar i atdheut, imoral dhe të tjera, ja pse i kam shkruar.

- Shkruaji të gjitha këto që i tha pandehuri, - i tha hetuesit. Ai i shkroi, pastaj unë i lexova dhe i firmosa.

- Çojeni në dhomë, - u tha.

* * *

Në birucën numër dyzetëshatë të burgut të ri në Tiranë kam qëndruar vetëm 122 ditë e 122 netë. Truri im u kthye në robot elektronik. Në mendjen time formuloja pyetjet që do të më bënte hetuesi dhe përgjigjet që do të jepja unë. Hetuesi do të më pyesë për këtë çështje. Unë dot t'i përgjigjem kështu. Ai do të më thotë..... Unë do t'i them..... Dhe ky dialog me veten zgjaste ditë e natë pa pushim. Por, pas ca muajsh të stërmundimshme truri im u sëmur. Fillova t'i pres xhirot nëpër birucë. Truri im nuk punonte më me shpejtësinë e robotit elektronik. Rirja me orë të tëra në një qoshe të qelisë me kafkën bosh. Instiktivisht, çohesha për të ardhur rrotull nëpër qeli, pa asnjë mendim në kokë, sa bëja një hap dëgjoja: Me avash se na shkele!

Fillova të ecja i frikësuar në majë të gishtërinjve, duke ruajtur ato që rrinin të shtrirë në dyshemenë e birucës.

- Eh, ç'më lëndove plagën, mu në gjoks ma vure këmbën, aty ku më kanë marrë plumbat.

I tmerruar ulesha te qoshja ime.

- Më falni vëllezër! Më falni, - u thosha. Nuk e kisha mendjen. Pastaj harrohesha pas muhabetit, me figurat që ishin në dërrasat e dyshemesë. Ata më tregonin për torturat, për plumbat që kishin

marrë, për plagët, për mallin e pashuar për fëmijët, nënën, babanë, motrën, vëllanë, të dashurën, shokët. Për diellin, hënë, yjet, zogjtë.

- Gjoksin na e dogjën plumbat. Jemi zhuritur për një pikë ujë. Pastaj me mblidheshin rreth e rrotull dhe më luteshin për një pikë ujë.

- S'kam ku t'jua gjej vëllezër! Dera e birucës është e mbyllur me lloza hekuri, me dryna.

- Bjeri derës, bjeri! U zhuritën për një pikë ujë, - më thoshin. Çohesha e i bija derës. Vinte gardiani hapte sportelin e më thoshte:

- Pse i ra derës?

- Të dal sa të mbush pak ujë komandant.

- Rri urtë dhe mos i bjer më derës se e di vetë pastaj... Ulesha tek qoshja. Por, ata dilnin nga dërrasat dhe më rrethonin duke ulëritur:

- Ujë, ujë, ujë!...

Zija veshët me duar, por zërat e tyre ishin aq të forta, sa mua më dukej se nga çasti në çast do të më plasnin tëmthat. Çohesha dhe i bija derës. Gardiani inatosej dhe më hidhte prangat dhe më qëllonte me shkelma deri sa rrëzohesha përdhe.

- Ndyrësirë, bjeri prapa derës po deshe! Kjo ishte fjala e fundit që dëgjoja se ç'ndodhte më vonë nuk e mbaj mend. Kur përmendesha shihja njerëz të përlyer me gjak. I mbyllja sytë dhe humbja në botën e ëndrrave. Endrrat më çonin gjithmonë ne teknikumin financiar në qytetin e nxënësve.

Oh, sa të bukura ishin ato çaste. Takohesha me Bexhetin, Danielin, Robertin, Rinushin, Çeçon, Stavrin, Faziletën me

kaçurrelat e arta, Hervehen me gërshetat si «Vasilika e bukur tek filmi «Lulja e Zambakut», Violetën tërë energji, Lumniën bardhoshe, parashqevinë delikate, Elpiniqinë pa fjalë, Elizabetën me kokën e Deas. Birucën më dukej se e kisha parë në një ëndërr të keqe. Gjumin ma nxirrmin harabelat tek frëngjia e birucës sime. Unë filloja t'i imitoja duke përplasur gjuhën pas qiellzës së gojës. Ata futeshin përmes fërgjisë me hekura dhe më flisnin me gjuhën e tyre.

Pastaj fillonin të trokiturat në murin e birucës. Më thërriste shoku i birucës përbri. Ne nuk e njihnim njëri-tjetrin, as fytyrën nuk ja kishim parë njëri tjetrit. Për çdo ditë bisedonin me të trokitura në murin e birucës. Ai më transmetoi lajmet e natës që kaloi. Sonte kanë ardhur tre të burgosur të rinj dhe janë vendosur në birucat 1, 16, 18. Ata të birucës 18 e morën dje në mëngjes dhe s'e kanë kthyer më.

Prifti katolik që është dënuar me vdekje mbetet me moral të lartë. Ajo vajza e re e birucës 26, që e akuzojnë për tradhëti ndaj atdheut ka marrë mendsh. Tërë natën thotë:

Unë jam Penelopa, nuk jam Helena. Ç'keni me mua? Unë s'ju bëj gjë. Pres të dashurin tim. Oh, ju lutem mos m'i prekni gjinjët, ato nuk i ka prekur kush, përveç atij që më shfaqet në ëndërr çdo natë.

Atij të birucës numër 9, që ka ardhur para pesë ditësh i futën një spiun, u lajmërua. Këto lajme qarkullojnë në të gjitha birucat, me gjuhën e koduar të burgut.

* * *

Hetimeve u erdhi fundi. Gjashtë muaj i mbyllur në qeli si në fundin e një pusi. Gjashtë muaj pa parë njeri me sy përveç gardianëve, hetuesit dhe herë pas here fytyra të vterosura kriminelësh e sigurimit të shtetit. Gjashtë muaj pa parë diell, yje, hënë. Edhe ajri më futej nëpër katrorët prej hekuri të qelisë. Gjashtë muaj pa ndier asnjë zë njeriu, përveç britmave të hetuesit dhe hunguritjeve të gardianëve. Gjashtë muaj nën torturat psikike e fizike. O Zot! Sa i fortë qenka njeriu. Çdo ditë e çdo natë kam jetuar në tension dhe ankth. A ka fantazi që të imagjinoja torturat e hetuesve të sigurimit shqiptar? Elektrohoku, organet vegjetale në bigë. Por, në çdo gjë del mbrojtje Zoti. Unë e kam provuar vetë: Kur hekurat më futeshin thellë damarëve të duarve e nga venat shpërthente gjaku, mua më binte të fikët. Edhe kur më vinin elektrohokun e kur rryma depërtonte nëpër trupin tim, në kufirin mes jetës e vdekjes mua më binte të fikët e nuk ndieja gjë më. Kjo ishte dora e Zotit. Ditët ishin intensive, më pyetje e përgjigje, me sharje e ofendime, i përbuzur e me tortura fizike e psikike. Por, vinin netët e Zoti na i dërgonte ëndrrat për mehlem. Pas çdo nate, në mëngjesin e çdo dite trupi gdhiehet i rigjeneruar dhe i përtërirë. Në ëndrra unë delja çdo natë nga qelia, kaloja nëpër lulishte, bridhja i lirë lëndinave, e ku nuk më çonin ëndrrat, në fëmijërinë e largët, takohesha me shokët e dëgjoja zërin që ëmbël të nënës bëja dashuri me shoqen e klasës, ashtu siç e kisha imagjinuar unë vetë. Në ëndërr më plotësohej çdo dëshirë. Por nga të gjitha torturat

fizike e psikike nuk më harrohet vetëm ajo natë. Do të ishte mesi i natës. Në mur filluan të trokiturat. U zgjova i lahtaritur.

- Po vjen skuadra e pushkatimit! Po vjen skuadra e pushkatimit! Po vjen skuadra e pushkatimit! - jepej mesazhi me anën e kodimit të burgut. Vura veshin: Grup! Grup! Grup! - u dëgjua që larg korridorit hapat e skuadrës së pushkatimit. Ato ndaluan tek biruca numër 13. U hap dera e birucës. Atje ishin gjashtë veta, të cilët ishin dënuar me vdekje dhe prisnin vendimin e formës së prerë. I nxorrën në korridor.

- Vëllezër lamtumirë! - u dëgjua një zë. Jam 22 vjeç dhe nuk jam as hajdut, as vrasës dhe as imoral. E urrej komunizmin nga thellësitë e shpirtit. Pastaj u dëgjua ca si rënkime. Ja mbyllën gojën. Dikush qau. Pastaj hapat e skuadrës së pushkatimit: Grup! Grup! Grup!, derisa u fashitën tutje nga fundi i korridorit. Nëpër mure filloi përsëri transmetimi me të trokitura. Mesazhi thoshte se i morën që të gjashtë. Por, pa kaluar shumë nga fundi i korridorit u dëgjua përsëri hapat e skuadrës së pushkatimit.

- Po vjen, po vjen përsëri skuadra e pushkatimit, - u dëgjua mesazhi. Nuk do t'i kenë marrë të gjitha ata të qelisë 13 dhe po vijnë të marrin të tjerët, - mendova për një çast dhe vura veshin në përgjim. Hapat e kaluan qelinë 13. Ku po shkonin? Në asnjë qeli s'kishte të dënuar me vdekje të tjerë. Po vinin drejt qelisë sime. Zemra filloi të më rrahë me forcë. Hapat u ndalën tek qelia numër 35. U hap dera. Çne ai nuk ishte i dënuar me vdekje, kishte pak ditë që kishte ardhur. I kishte bërë a s'i kishte bërë pesë seanca hetimi.

- Ku do të më çoni? - u dëgjua zëri i tij. Pastaj skuadra e mori me vehte. Nëpër mur filloi përsëri transmetimi.

- Nuk po kuptojmë se ç'po ndodh, - thuhej në transmetim.

Skuadra e pushkatimit po merr edhe të padënuar. Të gjithë të izoluarit ishin të shqetësuar. U dëgjuan përsëri hapat e skuadrës së pushkatimit. Qelive kishte rënë një heshtje varri. U hap dera e qelisë 42. Edhe ai nuk ishte i dënuar me vdekje. Ishte astrologu që çdo ditë transmetonte me anë të murit fatin e ditës së secilit të izoluar simbas shenjës së horoskopit. Vetëm një ditë ai nuk na kishte dhënë asnjë informacion për fatin. E morën edhe atë. Hapat u fashitën tutje korridorit, por erdhën përsëri e morën atë të qelisë 27, 44, 45, pastaj ndaluan përpara derës së qelisë sime. U hap dera. Brenda hyri një ushtarak me maskë të zeze në kokë. Vetëm sytë i dukeshin. Më ziuqi nga krahu dhe më tërhoqi me forcë. Pastaj më vunë edhe mua një maskë në kokë. Çdo gjë m' u errësua. Më morën nga krahu nëpër korridor, më zbritën nga shkallët dhe më nxorën në oborrin e burgut. Nuk shihja asgjë, por e kuptova nga ajri i freskët. Më hipën në makinë. Më zgjidhën prangat dhe më lidhën me një dorë tjetër.

- I kujt biruce je ti? - më pyeti ai me të cilin më lidhën dorë më dorë.

- I 47-shtatë.

- Po ti?

- I 45-ës.

- Ku po na çojnë?

- Nuk e di.

- A ka mundësi të na pushkatojnë pa gjyq?

- Çdo gjë mund të ndodhë.

- Po ku mund të na pushkatojnë?

- Nuk e di.

- Po na pushkatuan në bregun e lumit mendo ndonjë gjë se si

mund të shpëtojmë. Është fundi. E di që këto që po të them të duken absurde, por njeriu duhet të luftojë për të jetuar.

- Më duket se pushkatimet i bëjnë nëpër tunele.

- Ou! - më tha dhe heshti.

- Po sikur të hidhemi nga makina, - më tha pas pak.

- A nuk e sheh që makina është e mbuluar me mushama.

Heshti për një çast.

- Po sikur t'u japim sinjal të gjithëve dhe t'u hidhemi rojeve përsipër e t'i mbysim me hekura në fyt?

- Po ne na kanë zënë dhe sytë e nuk shohim asgjë, - thashë.

Heshti.

- Por, s'ndodhë duhet të bëjmë diçka, - më tha.

Truri i tij ishte në intensitet. Nuk ju përgjigja, por m'u kujtua tregimi «Dashuri për jetën» i Xhek Londonit. Te ky tregim janë mbështetur Shollohovi tek «Fati i njeriut» edhe Heminguei tek «Plaku e Deti», edhe Xhejms Alldirxh tek «Djumi i fundit».

Makina ndaloi. Na zbritën. Fillova të numëroj simbas hapave të zbritjes. Ishim gjithsej, bashkë me mua 15 veta. Nga ndryshimi i ajrit e kuptova se na futën në një tunel. Na ndaluan dhe na mbështetën pas një muri. Këtu do të na pushkatojnë, - thashë me vete, ky do të jetë poligoni i pushkatimeve. Po pastaj ku do të na çojnë? - pyeta veten time. Çfarë mendoj edhe unë! - e ç'rëndësi ka pastaj.

- Ju gjashtë të qelisë 13 e dini që jeni të dënuar me vdekje. Sot erdhi vendimi i formës së prerë që për të gjashtë ju e le vendimin në vend Kuvendi Popullor. Kurse ju të tjerët që nuk keni dalë në gjyq.

Kurse ju të tjerët që nuk keni dalë në gjyq, është bërë gjyqi në

mungesë dhe për rrezikshmëri shoqërore jeni dënuar nga gjykatat e rrethit me pushkatim. Vendimi është i formës së prerë. Kush dëshiron të thotë fjalën e fundit do t'i pyesim me radhë:

- Ti!

- Komunizmi nuk njeh Zot, fe, nuk ka besë, nder, nuk njeh nënë e babë, motër e vëlla, komunizmi është imoralitet, - ishte studenti.

- Ti!

- Më vjen keq se s'kam lënë fëmijë! - ishte pianisti.

- Ti!

- Kisha dëshirë të shikoja për herë të fundit hënën se Hëna e quajnë edhe të dashurën time.

- Ti!

Heshtje.

- Ti!

U dëgjuan të qara dhe ngashërime.

- Ti!, më prekën me shkop në gjoks.

- A keni menduar ndonjëherë se çdo gjë ka një fund, - u thashë.

- Ti!

- Po deshët mos na pushkatoni pa na nxjerrë në gjyq. Do të pranohet e do të firmos çfarë të më thotë hetuesi.

- Ti!

- Nuk të shoh, por nga zëri e kuptoj se lepuri të ka hyrë në bark.

- Ti!

- I thoni shokut Enver amanet fëmijët. Ai me siguri nuk di gjë. Kemi qenë shokë. Në shtëpinë time është strehuar sa herë gjatë luftës. Vdes Komunist. Të rrojë partia, - ishte anëtar i KQ të PPSH-së.

- Eh, rracë komunisti, rracë e degjeneruar, - shau njëri nga ne.

I drejtohej anëtarit të KQ.

- Ti!

- E di që do të na varrosni në një gropë të përbashkët. Po deshët mos na varrosni me komunistat tuaj së s'ka për të na tretur dheu. Mbasi mbaruan së pyeturi të gjithë.

- Skuadra gati për zjarr, - u dëgjua një urdhër.

U dëgjua zhurma e mbushjes së armëve.

- Gati! Zjarr!

Unë kisha humbur në kujtime. Me mendje kisha fluturuar larg. ndoshta me nënën, ndoshta me shokët, Vjollca më ishte hedhur në qafë e s'më lëshonte. Batarea e armëve më solli në vehte.

- Ou! Ou! Oh! Oh!

- E, Eh, - regëtinin shpirtërat. Për çudi unë edhe pas shkrepjes së batares së tretë qëndroja në këmbë. Gjithashtu ndjëva se edhe ai që ishte lidhur dorë më dorë me mua ishte në këmbë. Pastaj u dëgjua e shtëna e një revoleje. Ajo kërciti gjashtë herë. Ishte prokurori që qëllonte të vrarët në kokë, edhe të vdekur për të zbatuar urdhërin deri në fund.

- «Merrini! u dëgjua urdhëri. Na tërhoqën nga prangat dhe na shtynë. Ku po na çonin? Çfarë po ndodhte. U dëgjua një e qeshur frenetike.

A ha ha ha... ha. E qeshura nuk kishte të mbaruar. Qeshte ai që përpara pushkatimit kishte qarë. I mjeri kishte shkarë. E ç'është truri? Enigëm. Miliarda fijeza të holla që nuk u dihet funksioni dhe lidhjet. U dëgjua ajri i freskët. Kishim dalë nga tuneli. U dëgjua zhurma e-makinave. Na shtynë dhe na hipën në makinë. Ku po na çonin? Ç'po ndodhte me ne?

Mendja ë lodhur dhe e tronditur nuk ishte në gjendje të punonte

normalisht. Makina u ndal! U hap një portë! U hap dhe e dyta. Ishte burgu. Na kthyen përsëri. U rrëqetha kur e kuptova se hymë përsëri në burg. Do të fillonin përsëri pyetjet e hetuesit, torturat, netët pa fund në qeli. Më çuan përsëri tek qelia ime numër 47. Mbasi u largua skuadra e pushkatimit filluan të trokiturat në mur. Ishin pushkatuar vetëm ata të qelisë numër 13 që ishin të dënuar me vdekje. Përse na i bënë këtë? Tani truri ishte qetësuar dhe punonte normalisht, kjo ishte një torturë psikike. Dy veta nga ne të nëntë që u kthyem atë natë ishin shkalluar. Njëri ishte lagur nga frika. Të tre këta që e kishin pësuar kishin qenë komunistë. Ai që ishte lagur, kishte qenë anëtari i KQ të PPSH-së.

E çuditëshme kjo rracë komuniste. Kur të kanë nën vete bëhen sadista dhe s'kanë të ngopur me gjak. Por, kur janë përpara pushkatimit vetë bëhen lepuj dhe lagin brekët. O Zot! Nga e ka prejardhjen kjo rracë që do të kthejë botën mbrapa në egërsinë kanibale?

Tre ditë mbas mbarimit të hetimeve më thirrën në hetuesi dhe më dorëzuan aktakuzën.

Aktakuza ime ishte përpiluar nga hetuesi dhe kishte 18 faqe. Akuzohesha me tre nene:

Tradhëti e lartë ndaj atdheut, për terrorizëm dhe për agjitacion e propagandë kundër vijës së Partisë në art e lartësi.

Ishte një akuzë me trillime nga më fantastiket, ashtu siç dijnë t'i përpilojnë aktakuzat hetuesat shqiptare.

Mbas një jave që më ishte dorëzuar aktakuza më thirrën përsëri në hetuesi. Më çuan te dhoma numër shtatë, që ishte e shtruar me tapet e kolltuqe. Aty ishin: Nëndrejtori i Drejtorisë së Punëve të Brendëshme, kryhetuesi dhe hetuesi i çështjes sime.

- E morët aktakuzën? - më pyeti nëndrejtori.

- E mora, - i thashë.

- E lexove?

- Po.

- Si t'u duk?

- Absurde.

- Dëgjo këtu! - më tha, - por, më dëgjo me vëmendje, se nga qëndrimi që do të mbush në gjyq varet jeta jote. Ne e dijmë që ti ke elokuencë dhe kulturë sa për dy fakultete. Me apologjinë tënde mund të bësh edhe sallën të përletet, mund të prekësh edhe trupin gjykues, por duhet të dish një gjë mirë, se në sallën e gjyqit dy orë do të jesh. Pastaj do të vish përsëri këtu tek ne. E kupton vetë se ç'dua të them, prandaj s'ka nevojë për koment. Mos të të rrejë mendja se duke u mbrojtur mirë dhe duke e hedhur poshtë akuzën me argumente bindëse, të lirohesh nga salla. Kostumin ta kemi prerë ne. Gjykata sa do ta veshi e do të thotë e mbajç me shëndet? Ne ndoshta s'ta mbushim syrin ty, por ne jemi nga ata që nxjerrim para gjyqit 1000 Gjergj Dimitrova me nga një mijë kokë sejcili, ua presim kokat, ua vëmë prap dhe prapë ua presim sa herë të duam dhe si të duam. Këto kij parasysh po deshe, po s' deshe. Paç vehten në qafë. Tani merre! - i tha gardianit.

Truri im rifilloi përsëri të riaktivizohej. Përgatita përgjigjet që dot'ju japë pyetjeve që do të më drejtonin prokurori dhe gjykatësit. Përgatita mbrojtjen dhe apologjinë. Të gjitha mundohesha t'i regjistroja në shiritat e megjulluar të kujtesës, sepse në gjyqet tona nuk lejohet avokati, nuk lejohet që i pandehuri të ketë laps e letër për t'u mbrojtur. Truri im punonte si sonambël dhe në gjumë.

Atë ditë që më nxorrën në gjyq ishte fundi i vjeshtërave. Kur

dola në oborin e burgut frynin erërat e jugut. Më mbytën kujtimet. Shiritat e kujtesës, ku kisha regjistruar përgjigjet e pyetjeve, mbrojtjen dhe apologjinë për një çast m'u fshinë nga kujtesa. Gjyqi im u zhvillua me ftesa. Ishin ftuar: gazetarë, shkrimtarë, studentë të gazetarisë, letërsisë e drejtësisë partiake dhe njerëz të familjes sime. Brenda gjashtë muajve unë isha ndryshuar sikur të kishin kaluar gjashtë shekuj. Isha fryrë nga biruca dhe isha i verdhë si një meit. Koka më ishte thinjur krejt. Edhe nëna mezi më njohe.

Procesi filloi me leximin e aktakuzës nga prokurori. Pastaj unë i mora leje trupit gjykues për ta pyetur palën akuzuese rreth akuzës.

- Në akuzë thuhet se organet e sigurimit të shtetit kanë pasur material të bollshëm për veprimtarinë time armiqësore dhe me kohë dua të pyes palën akuzuese se kur kanë pasur material të bollshëm për veprimtarinë time armiqësore dhe me kohë pse më kanë arrestuar me një akuzë të rreme sikur unë kam përvetësuar dietat e shërbimit. E dyta në akuzë thuhet se unë e kam urryer partinë që në krijimin e saj. Dua të pyes palën gjykuese se sa vjeç kam qenë unë kur është themeluar partia. Prokurori u skuq dhe mbasi nuk ishte në gjendje t'ju përgjigjej pyetjeve filloi të më sulmojë mua me slloganët komunistë.

- Ky, shokë gjyqtarë është armik i betuar i sistemit, siç e ka deklaruar edhe vetë. Ky është një armik dinak që kërkon të bëjë agjitacion e propagandë dhe në sallën e gjykatës popullore. Por, e di unë se ç'kërkon ky. Ky do litarin në fyt e plumbin në lule të ballit. Por, të mos merakoset se edhe ato do t'ja japim. Pas kësaj replike filluan pyetjet e prokurorit dhe të gjykatësit. Mua më ishte kthjelluar truri dhe u përgjigjesha shpejt pyetjeve dhe me kundërpjetje e zija prokurorin, por ai i binte tavolinës duke më

sharë me fjalorin dogmatik të komunizmit; armik i d. gjeneruar, tradhëtar i shitur etj. Salla e kuptoi skenarin që ishte i montuar por heshtëre. Në sistemet komuniste askush s'ka të drejtë të shajë sistemin, organet e tij legjitative dhe ekzekutuese.

Dëshmia e dëshmitarëve të akuzës, u kthye në akuzë kundër palës akuzonjëse. Prokurori kërkoi nga gjykata që dëshmitarët të dënoheshin në bazë të ligjit në fuqi për dëshmi të rreme. Kryetari i gjyqit i pyeti një e nga një dëshmitarët: - A janë të vërteta këto që thoni?

- Po, të vërteta, u përgjigjën të gjithë njëzëri.

- Po ju në hetuesi keni dëshmuar të tjera gjëra, si shpjegohet?

- Shumë e thjeshtë, - tha njëri nga dëshmitarët. Në hetuesi kur na kanë pyetur në fillim ne kemi thënë këto që po u themi edhe juve, por hetuesat na kanë kërcënuar se do të na futnin në burg, do të na internonin familjet, bile na kanë thënë se po nuk thamë ashtu siç do të na mësonin ata do të na zhduknin fare nga faqja e dheut, duke na shtypur me makinë. Mbas këtyre i erdhi radha apologjisë sime.

- Zotërinj gjyqtarë! Më lejoni që apologjinë time ta mbështes tek fabula «Qengji dhe ujku».

Unë jam qengji. Shteti është ujku. Unë pi ujë në lumë. Pak më lart po pi edhe shteti.

- Ej, më turbullove ujin, - më thotë shteti.

- Si ta turbullova, unë jam më poshtë, ti je më lart, - i them. Ma turbullove vjet më thotë.

- Vjet s'kisha lindur, - i them.

- E po ma ke turbulluar sot, më thotë dhe ka hapur gojën të më gllabërojë. Pra, arrestohem me një akuzë fallsio dhe në akuzë thuhet se e kam urreyer partinë që në themelimin e saj, kur unë kam lindur

dy vjet pas themelimit të partisë komuniste shqiptare. Unë e di që juve sot do të më jepni dënimin kapital por di dhe këtë se unë jo se jam fajtor e dënohem për krime, por se ujku e ka vendosur që do të më hajë. U bëftë ashtu siç dëshiron ujku i kuq. Por, vetëm një gjë duhet të ketë parasysh ujku i kuq se një ditë do të plakët dhe do t'i vijë ngordhja. Do të fillojë të pendohet plaku zullumqar, do të lutet me lot në sy, por atëhere do të jetë vonë dhe o Zot se ç'kanë për t'i parë sytë atij, hetuesve, spiunëve dhe juve.

Pas fjalës sime u ngrit menjëherë prokurori dhe i kuqur deri te majat e veshëve deklaroi pretencën, duke më sharë e ofenduar me një fjalor komunisto-rrugaç. Dhe pastaj kërkoi dënimin tim me varje. Në sallë kishte rënë një heshtje si në xhenaze. I vdekuri isha unë.

- Çohu i pandehur, - e prishi heshtjen gjykatësi.

U çova.

Ç'kërkon në fjalën e fundit nga gjykata para se të merret vendimi.

- A ka mundësi që t'i them një fjalë nënës?

- Po, - më tha.

- Nënë! Çohu në këmbë dhe më shiko në sy. Ajo u çua. Për një moment u pamë sy më sy. Sytë e saj shprehnin mall, dhimbje. I therte shpirti, por nuk e jepte vehten. Ku do të më lësh, më thoshte vështrimi i saj lutës. Nuk mendove për mua. Unë vetëm ty të kisha. Unë vura buzën në gaz dhe i thashë:

Mbaje veten! Amanet po qave. Edhe një pikë loti po derdhe nuk do të më tresë dheu. Edhe varrin nuk do të ma gjesh se kanibalët s'të lënë varr. Por, sa herë të lulëzojë mimoza e bliri dil e këput lulet e tyre, vuri në vazo e merru erë, se në aromën e lulë mimosave dhe

lule blirit do të jem unë. Mëngjezeve çohu herët e shiko yllin e mëngjesit, bashkë me të do të udhëtojë edhe shpirti im, derisa të përëndojë ylli i kuq. Në sallë filluan ngashërimet. Bile edhe një ndihmësgjyqtare fshinte sytë fshehurazi. Vendimi u dha me vdekje. Që atëhere nuk e kam parë nënën time. Ajo u nis në atë botë me shpresë se do të më takonte mua. Se ajo nuk rronte dot pa mua se më kishte djalë të vetëm.

* * *

Mbasi më dënuan më çuan përsëri tek biruca numër dyzeteshtatë. Më lidhën këmbë e duar me pranga. Në kokë më vunë një helmetë dhe kur më çonin në banjë më lidhnin me litar dhe më tërhiqnin sikur të isha dem i tërbuar.

Isha dënuar me vdekje. Kështu i mbajnë të gjithë ata që dënohen me pushkatim. Kështu do të qëndroja 42 ditë e 42 netë deri sa të vinte dënimi i formës së prerë.

Natën e parë dolën nga dërrasat e dyshemesë ata që më kërkonin ujë dhe më thanë: Pas dyzetedy ditësh e dyzetedy netësh do të shpëtosh nga kjo botë, do të vish në botën e amshuar, s' do të mendosh më për asgjë, do të shpëtosh nga hekurat e sigurimit. Por, kur të pyesin para pushkatimit se çfarë dëshiron, kërkoju ujë. Dhe po ta plotësuan dëshirën pi sa të mundësh se do të zhuritësh për ujë si ne se këtu s' ka ujë. Natën e parë pas dënimit me pushkatim pashë në ëndërr të dashurën time të parë. Ajo më puthte në sy, në buzë. Buzët e saj ishin zjarr.

- Pse i ke buzët kaq të ftohta? - më pyeste. Nuk më do më?! Më ke harruar?!

- Jo, jo, - i thashë, të dua dhe mundohesha ta përqafoja, por nuk i lëvizja dot duart, më ishin mpirë.

- Pse je kaq i ngathët? - më pyeste.

Harabelat më prishën ëndrrën. Ishte gdhirë. Cicërimat e tyre ishin të pikëlluara. Ndoshta e kishin kuptuar edhe ata që isha dënuar me vdekje dhe nuk largoheshin nga dritarja si ditët e tjera. Pastaj filluan të trokiturat në mur. Më dërgonin përshëndetje të gjitha birucat. Prifti më jepte bekimin e Zotit dhe uratën. Mesazhi i tij ishte optimist. Ne do të shkonim pranë Zotit. Vajza e çmendur më transmetonte dashurinë e saj. Ai djali që i shfaqej çdo ditë në ëndërr isha unë. Ditën tjetër, në birucën time sollën tre veta. Ata ishin me helmata në kokë, të lidhur këmbë e duar me pranga dhe gardiani i tërhiqte me litar. Më i vogli ishte 18 vjeç dhe quhej Sandri, i dyti ishte 39 vjeç dhe quhej Adem dhe i treti ishte 49 vjeç dhe quhej Aladin. Unë isha 28 vjeç.

Ne, të katër do të prisnim vdekjen, çdo ditë, çdo natë, çdo orë, çdo çast dhe ky ankth do të zgjaste plot 42 ditë e 42 netë.

Alaudini ishte i heshtur. Rrinte tërë ditën i menduar me një vështrim të përqëndruar. Ademi fliste me vetveten pa e kuptuar. Unë dhe Sandri i tregonim njëri-tjetrit histori dashurish.

Kush do të më kishte denoncuar mua?

I sillja nëpër mend të gjithë shokët me radhë. Fytyrat e tyre të bukura më dilnin para sysh dhe më thoshin:

- Dyshon tek unë? Tek unë, tek unë?.....

Ne mblihdeshim një herë në javë te shtëpia e Kolombos, atje në periferi të qytetit, në rrugën «Lord Bajron», tek baçja e fermës. Netët ishin të errëta e frynin erëra. Ne fiknim dritat, ndiznim qirinjtë, i vishnim xhamat e dritareve me punëdore, pinim verë e

lexonim krijimet tona me dorë të lirë. Krijimet më të bukura u cilësuan poezia: «Qyteti im kubik» dhe tregimi «Vjeshtërat qajnë».

Po studentja e drejtësisë? Ndoshta ajo do të ketë qenë e vënë nga sigurimi. Papritur Ademi e ndërpriste monologun dhe na pyete:

- Çuna sa do të ketë shkuar ora?

- Ja dhe pak vjen dreka, - i thoshim ne.

Ushqimin na e sillnin në tasa alumini. Na ushqente me lugë gardiani. Një ditë na ushqente gardian Aliu dhe një ditë gardian Kosta. Kur e kishte rradhën gardian Aliu, na pritej oreksi fare. Ai kishte një fytyrë të vrerosur dhe një hundë të madhe me kurriz. Zërin e kishte të ngjirur sikur dilte nga thellësitë e ferrit.

- Hë, ha shpejt se nuk mbytesh, - na thoshte dhe na i raste lugët njëra pas tjetrës. Ne në vështirosej ushqimi kur shikonim atë fytyrë. Na dukej se në tasin me supë pikonte gjak nga duart e tija. Sa shpirtëra të pafajshëm e të brishtë ishin përpëlitur e fikur në ato duar. Aladini nuk fuste asgjë në gojë, kur e kishte rradhën kapter Aliu. Pasditet ishin depressive. Ne binim shpirtërisht. Rrinim orë të tëra pa folur. Kujtonin jetën që vazhdonte përtej mureve me kupola, roje, tela me gjemba e qen kufiri.

- Gugu gu! - këndonte kumria në barçen e arshivës së shtetit që ishte ngjitur me burgun. Ademi sa herë dëgjonte kumrinë përlolej. Një ditë e pyeta:

- Pse prekesh kur dëgjon këngën e kumrisë?

- Edhe unë kam pasur një të dashur, - m'u përgjigj. Quhej Ferjale. Ishte imcake, me flokë të zeza. Ajo fliste dhe unë i thoja që ta vazhdonte gjatë bisedën. E dëgjoja me orë të tëra dhe nuk e shuaja dot mallin.

- Tani u kënaqe? - më pyeste.

- Jo, folë, folë, - i thosha. Dua të dëgjoj zërin tënd ditë e natë, pa pushim, deri në amshim. Ajo fliste e unë e shikoja në sy. Kishte sy me nuancat e të gjitha ngjyrave të ylberit.

- Erdhi sybukura, - thonin kur vinte ajo.

Unë atëhere shkruaja poezi. Për Ferjalën kam shkruar me mijëra vargje. Ajo pëlqente më shumë nga të gjitha poezitë e mia atë që quhej «Eja në takim».

- A e mban mend? - e pyesnim ne.

- Unë i mbaj mend përmendësh të gjitha poezitë e mia.

- A do të na recitosh ndonjë varg?

- Një herë tjetër, - na tha. Fjalën e kishim te kumria. Ishte fillimi i muajit maj. Ferjalja më vinte për herë të parë në takim. Dolëm nga periferia e qytetit. Ishte një natë që vetëm në ëndërra e kisha parë. Natë pranvere që përsëritet në njëmijë vjet një herë. Ndoshta ajo natë mund të ketë qenë nata e kumtimit të gjithësisë, ndoshta nata e vetë dashurisë. Ne u ulëm nën një mollë të lulëzuar. E gjithë hapësira ishte parfumuar me aromën e lule mollës. Edhe flokët e dallgëzuara të Ferjalës vinin era lule mollë. Ne u përqaftuam rrëmbimthi. Buzët tona u prekën shpejt e shpejt.

- Gugu gu! Gugu gu! - këndoi kumria mbi kokat tona.

- Mjaft se po na shohin, - më tha Ferjalja.

- Kush? - e pyeta.

- Yjet, hëna, lulet e mollës, kumria, - më tha.

Ne mbetëm si të mahnitur për disa çaste përpara magjisë së asaj nate. Ai heshti, pastaj filloi monologun me vetveten. Mbi kokat tona varej llampa elektrike që nuk fikej as natë e as ditë. Nga dërrasat e dyshemesë dolën figurat. Ato m'u afruan e më pyetën:

- A të dhembin duart, këmbët?
- Jam mpirë fare vëllezër, - ju thashë.
- Ne u dogjëm për një pikë ujë, - më thanë.
- Si t'ja bëjmë?
- Ç't'ju bëj unë vëllezër a nuk e shihni si jam?!

- Mua ma quajnë emrin Viktor. Erdhi hetuesi dhe më mbyti në gjumë. Hapa sytë për një moment. Fytyra e tij u fiksua në bebëzat e save të mij. Më kishte vënë gjurin në gjoks dhe të dy duart në fyt. Në cepat e buzëve kishte pështymë. Unë nuk mund të rezistojta. Isha i lidhur këmbë e duar, ja kështu siç je ti tashti. Quhet Dhimitraqis. Fiksoje mirë në mendje, Dhimitraqis Ikonomis. S'dihet mund të dalësh ndonjëherë i gjallë.

- Po unë jam i dënuar me vdekje.

- S'ka gjë. Jetës nuk i dihet. Zoti është i madh. Po dole ta lë amanet dhe amanetin s'e tret dheu. Shko në shtëpinë time, po ta jap edhe adresën: Rruga «Hoxha Tahsim», Nr. 34. Është një portë e vjetër prej dërrase. Në oborr është një manjollë. E ka mbjellur Dashja, kështu quhej gruaja ime. E mbolli atë ditë që erdhi në shtëpinë time si nuse. Ne jetuam bashkë dhjetë vjet e lindëm tre vajza. Kur u arrestova vajza e vogël ishte një muajshe, e dyta 2 vjeçe dhe e madhja 5 vjeçe. Manjola çelte lule të bardha. Ja kështu si këto lule të bardha është dashuria jonë, më thoshte Dashja. Atë ditë ajo u çua herët për në punë. Para se të nisej më puthi në buzë. Pastaj nuk u pamë më se pas tre orësh mua erdhën e më arrestuan për politikë.

Që atëherë kanë kaluar vite, manjola do ta ketë trashur trupin delikat. Vajzat do të jenë rritur. Dy të voglat s'më mbajnë mend fare, kurse e madhja ndoshta më përfytyron si në mjegull. Nëna do

të jetë bërë qyqe. Dashja do të jetë martuar. U thuaj se unë kam dhënë shpirt, me fytyrat e tyre në sy.

- Po unë që vdiqa nga torturat. Më torturonte vetë kryehetuesi, Koçua. Kurse unë kam ngrirë nga të ftohit. E ftohta m'u ngjit avash, avash, deri sa m'u ftoh zemra. pastaj humba në një baçe me trëndafila, shatërvane e vajza të bukura që laheshin nudo.

- Po troket muri, po troket muri. Unë e dëgjoja zërin e Sandrit që po më fliste, por njëkohësisht dëgjoja edhe zërat e atyre në dyshemenë e birucës. Pastaj zërat e tyre u fashitën, figurat e zhdukën dhe dëgjoja zërin e Sandrit që më thoshte se po trokiste muri.

- Ku e kishe mendjen që nuk po më dëgjoje? Me cilin po bisedoje?

- Hiç, hiç, - i thashë duke luajtur kokën.

Unë i dëgjoja të gjitha bisedat e tua. Të kam dëgjuar edhe herë të tjera që flet me vehte si Ademi. Më duket se dhe ti nuk je në rregull. Je mehaluçinacione. Mos të shfaqet murgu i zi i Çehovit?

Unë buzëqesha pa i kthyer përgjigje. Na lajmëronin me anë të trokitjeve se edhe ai i qelisë numër 16 ishte i dënuar me vdekje dhe donte të dinte emrat tanë. Unë i transmetova emrat dhe i thashë të mbahej fort, të mos ligështohet se u bënte qejfin kriminelëve të kuq. Në orën 24 të çdo nate prifti katolik na transmetonte mesazhin e Zotit. Mos ta humbisnim shpërsën dhe besimin tek Zoti. Shpirtin ta ruanim të pastër dhe të mos e rëndomim me asnjë mëkat, që kur të paraqiteshim përpara Zotit të ishim ashtu siç kishim lërë nga nëna. Gjumi në birucë është melhem nga Zoti për të qetësuar shpirtërat e munduar. Mua çdo natë në ëndërr më plotësohej çdo dëshirë si në përrallat e një mijë e një netëve. Unë në ëndërr kisha

bërë dashuri me Evën e Adamit, me Penelopën, me Sherizaden dhe me Parashqevinë. Gjumin ma nxirrmin harabeltar tek fregjia e birucës. Unë flisja në gjuhën e tyre duke përplasur gjuhën pas qiellzës. Fillonte jeta e përditshme e birucës. Dëgjoheshin dyert e birucave që hapeshin e mbylleshin si dhe gardiani që thërriste:

- Çai, çai, çohuni!

Pas çait, dalja në banjë për të larë tosat e për të mbushur paguret me ujë. Ndezja e cigares. Pastaj fillonte hetuesi. Hapeshin dyert e birucave dhe pastaj zëri i kapter Aliut:

-Ka njeri! Ka njeri! Kjo vazhdonte deri në orën 14. Dreka, dalja në banjë, ndezja e cigares dhe pastaj mbi biruca binte heshtja dhe vdekja. Këto ishin orët më të tmerrshme. Ne në këto orë binim shpirtërisht. Alaudini rrinte i heshtur si çdo ditë. Ademi atë ditë nuk e pushoi asnjë çast monologun e tij. Unë i tregova për dy shokët e mi boksierë: për Danielin e për Metin. Danieli ishte trim e kishte grusht të fortë, kurse Meti ishte teknik. Ai sikur luante balet në rring.

Në orën 24 prifti na dha bekimin si çdo natë. Mua më zuri gjumi menjëherë. Në ëndërr atë natë m'u shfaq një femër e shëmtuar. Ajo kishte një hundë të hollë e të gjatë. Më përqafohte me krahët e hollë si skelet dhe kur hapte gojën për të më puthur i zbuloheshin ca dhëmbë të verdhë të rallë. Buzët i kishte akull. Unë largohesha, por ajo më binte përsipër dhe më merrte frymën. Zgjohesha i llahtaritur dhe përsëri më zinte gjumi. Ajo më shfaqej përsëri. Oh, ç'natë e sikleishme, - mendova. Nëpër gjumë dëgjova të trokitura të forta në mur. U çova. U zgjuan të gjithë. Çfarë do të kishte ndodhur?!

Në mur nuk trokitej në këtë orë.

-Po vjen skuadra e pushkatimit! Po vjen skuadra e pushkatimit!

- jepej mesazhi me të trokitura në mur. Ne rrinim me veshë të ngritur në përgjim. U dëgjuan që larg hapat e skuadrës së pushkatimit:

- Grup! Grup! Grup!

Ne prisnim me zemër të ngrirë. Ku do të ndaleshin?

Ata u ndalën përpara birucës së priftit.

- Bijtë e mi, ju bekoftë Zoti, - foli prifti.

- Të poshtër, kriminelë, a vritet njeriu i Zotit? - bërtiti vajza e çmendur. Të gjithë të izoluarit filluan t'u bien mureve e dyerve të birucave në shenjë proteste. Të trokiturat e protestës s'pushuan tërë natën. Erdhën hetuesat, drejtori i burgut, kryehetuesi, erdhën edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, por të trokiturat nuk pushuan.

- Kjo është revoltë, tha zëvendësministri i Punëve të Brendshme. Të lidhen të gjithë këmbë e duar. Kërcitën prangat. U lidhën të gjithë. Birucat u zhytën në botën e heshtjes e vdekjes. Të izoluarit nuk pranuan ushqimin. Filloi greva e urisë.

Greva e urisë vazhdoi një javë. Pas pushkatimit të priftit zemrat tona sikur i mbuloi një cipë prej bryme. Çdo natë tek frëgjia e birucës këndonte kukuvajka. Sandrin e tmerronte kjo këngë vajtuese. Ademi trishtohet e binte moralisht. Mua më bezdiste monotonia. Aludini ishte si gjithmonë i heshtur e menefrego. Vajza e çmendur shqetësohej dhe thërriste me sa zë që kishte:

- Hëngësh kokën tënde, këmbët e tua, zogjtë e tu, kokën e hetuesve, kokën e gardian Aliut e gardian Garipit. Në birucën tonë ndihej hija e ftohtë e vdekjes. Nga muret na trokasim për të sjellë lajmet e ditës dhe të gjithë na japin kurajo. Aludini kur e pa se ne e kishim humbur pusullën fare ndërroi në mënyrën e të sjellurit.

Nga i heshtur u bë më llafazani. Na mbante tërë ditën me muhabet dhe na tregonte plot histori me aventura e humor. Na tregonte për fuqinë e hipnozës për jogizmin e spiritizmin. Ai e kishte studiuar me rrënjë spiritizmin. Spiritizmi është një shkencë që i ka rrënjët në lashtësi, - na thoshte. Sandri harrohej fare në tregimet e Alaudinit dhe duke dëgjuar mbi spirizmin humbiste nga realiteti. Kur Alaudinin e rrëmbente vorbulla e mendimeve ai heshte dhe futej në botën e tij mistike.

- Të jenë të gjitha këto të vërteta? - më pyeste Sandri.

- Janë aq të vërteta saç është e vërtetë edhe drita e diellit, - i thosha. Ademi vazhdonte monologun pa fund e krye.

Në orët e mbasdites dilnin si hije pastaj merrnin formën e njerëzve, por gjithmonë të shtrirë në dyshtemenë e birucës, ata që ishin varur, mbytur e vdekur nga torturat.

- 13 muaj kam qëndruar me frymë në këtë birucë. Shpresoja që të dilja një ditë i gjallë, por... Heshti pak, pastaj filloi të rrëfente.

Ishte muaji janar i vitit 1954. A të kujtohet sa ftohtë ka bërë atë vit? Nga hekurat e fregjisë vareshin stilagritet e akullit si qirinj. Unë isha në një këmishë të tretur. Vija vërdallë nëpër birucë, por e ftohta më depërtonte thellë nëpër damarët e kapilarët dhe më pikste gjakun. Zemra s'kishte furnizim e unë debul mbyllja sytë e humbja në botën e ëndrrave. Dhe në një natë të akullit të atij janari unë nuk i çela dot më sytë. Atëhere isha 22 vjeç. Po ti sa vjeç ke qenë atëhere?

- Unë? - i thosha i habitur. Kam qenë në klasë të parë të shkollës së mesme 15 vjeç.

- A ke pasur ndonjë të dashur atëhere?

- Po, kam simpatizuar një shoqe të shkollës.

- Fol! - i tha babai, - ku ishe?

- Më humbën triskat e bukës, filloi të fliste ajo. Kisha frikë të kthehesha në shtëpi. Rrija nën strehën e dyqanit duke qarë. Kalonin njerëzit e më pyesnin se çfarë kisha. Kam humbur triskat e bukës, - u thoja. E shkreta gjynah, ja bënin dhe largoheshin. Kur ra mbrëmja para meje ndaloi një veturë e kuqe. Që andej zbriti shoku Kristo, sekretari i KP të rrethit.

- Çfarë ke, pse qan? - më pyeti.

- Më kanë humbur triskat e bukës, - i thashë.

- Mirë, mirë, mos qaj se do t'i gjejmë, - më tha.

Hyp në veturë. Unë hypa dhe ai më çoi në Komitetin e Partisë. Më futi në një aneks pas zyrës së tij. Atje ishte ngrohtë, ishte një krevat dopio dhe në mur një pasqyrë. Pas pak një grua e re më solli për të ngrënë por unë nuk vura gjë në gojë, se e kisha mendjen tek ju që ishin pa bukë. Nga ngrohtësia më zuri gjumi. Po dremisja në kolltuk, kur dikush më mori hopa dhe më shtriu në krevat. Hapa sytë. Isha nëpër gjumë dhe nuk orientohesha dot. Pashë shokun kristo që po më puthte e po më zhveshte. Bërtita me të madhe, por ai ma vuri pëllëmbën e tij në buzë dhe ma mbylli gojën, pastaj... Ajo ja plasi vajit. Edhe nëna filloi të qajë. Ne shikonim si të habitur, kurse babai u bë dyllë i verdhë dhe nuk tha asnjë fjalë atë natë. Por, pa kaluar as një javë nga kjo ngjarje, në mesnatë na vjen policia në shtëpi. Ata ishin bërë si bisha.

- Ku e ke burrin? - i thanë nënës.

- Në punë shkoi, ishte turni i dytë, por s'është kthyer ende, nuk e di pse!

- Nuk e di he?! - shfrynë ata dhe filluan ta bëjnë shtëpinë rrëmujë. Ne ishim mbledhur në një qoshe të dhomës dhe po

dridheshim nga frika.

- Çfarë ka ngjarë, - u tha nëna.

- Edhe pyet moj shtrigë e ndyrë, - i thanë nënës, pastaj e shtynë dhe e morën me vehte. Ne mbetëm vetëm. Oh, ç' natë e llahtarshme që ishte. Në mëngjes nëna erdhi. Nuk i kishte mbetur pikë gjaku në fytyrë. Babai jonë atë natë kishte vrarë shokun Kristo. E kishte vrarë kur po shkonte për në shtëpi. E vrau dhe u zhduk pa nam e pa nishan. Ende s' dijmë gjë për të. Pas ca ditësh ne na internuan në Seman të Fierit. Ai heshti.

Muret e birucës pikonin nga lagështia. Zemrat tona pikonin helmin e jetës. O Zot, kush e solli komunizmin në vendin tonë? Ali Kelmendi? Sejfulla Malëshova? Apo... Oh, jo fara e tij kishte ardhur në vendin tonë që në vitet njëzet. A nuk e detyroi parlamentin në vitin 1924 Avni Rustemi që të çohet e të mbante zi për vdekjen e Leninit. Oh, Zot, që kur ka ardhur kjo farë e poshtër në vendin tonë dhe kushdo që e ka sjellë u shoftë me rracë nga faqja e dheut.

- Për ta mbajtur vetvehten dhe për të mos rënë moralisht, secili të përjetojë jetën e vet, - na tha Alaudini. Sa vinin orët e mbasdites ne harroheshim në vitet e kaluara të jetës sonë.

Unë fëmijërinë e kam kaluar në qytetin e Fierit. Shtëpinë e kam pasur buzë Gjanicës. Dimrat në fëmijërinë time kanë qenë shumë të ashpër. Ne ishim të varfër, mbaheshim vetëm me rrogën e babait që punonte punëtor në shtrimin e rrugëve. Në mes të dimrit unë shkoja në shkollë zbatut. Këmbët më plasnin nga të ftohtit dhe në darkë nëna m'i lyente me vaj. Më kujtohet mësuesja e klasës së parë. Hervehe e quanin. Ajo vinte në klasë e veshur e tëra në të zeza, megjithëse ishte vajzë e re. Ishte viti 1947 dhe ne dilnim në rresht rrugëve të qytetit duke thirrur:

- Tito fitimtari, Tito shpëtimtari!

Unë kisha sy të kaltër e flokë të verdhë. Djemtë më të mëdhenj të lagjes më vinin në sherr me qerozat e bishankes. Fiqua bënte një vizë në tokë dhe thoshte se kush e shkel i pari e ka sharë shokun. Në një anë rrinin qerosat dhe në anën tjetër unë.

I pari e shkelja gjithmonë vizën. Kështu fillonte sherri dhe unë shkoja në shtëpi çdo ditë me hundër ose kokën tërë gjak. Megjithëse isha shumë i prapë në klasën e shtatë më zgjidhën komandant çete për shkollën, se isha nxënës i mirë në mësim. Por frikën qerozat ma morën kur rraha Sikon, komandantin e tyre. Ne po loznim me top lecke tek mulliri i Xhemil Muços, kur vijnë qerozat dhe na prishin lojën. Unë u kapa me Sikon fyt për fyt. E shtriva për tokë dhe ja theva hundët. Kur fillova të përfytyroja fëmijërinë time, gjatë orëve të trishtuara të mbasditeve të qelisë, netëve ëndrrat më çonin në qytetin e Fierit. Por nga fëmijëra m'u kujtua dhe një eidil i bukur. Kishim mbaruar klasën e shtatë dhe kishim shkuar për të marrë dëftesat e lirimt. Shojja e klasës, Luli kishte mbushur me ujë një lepurush dhe më lagte. Unë e ndiqja nëpër korridoret e shkollës për ta kapur, ajo vraponte duke qeshur. Në fund u fut në një klasë, hyra dhe unë. Ajo hipi në penxhere dhe u hodh, u hodha edhe unë. E kapa. Ajo qeshte dhe përpiqej të më lagte. Faqet i ishin bërë si lulëkuqe. E putha në faqe shpejt e shpejt. Ajo nuk më tha gjë, vetëm qeshte. Unë që atë ditë që putha Lulin në faqe u bëra më serioz dhe më dukej vetja burrë. Pastaj mua më doli bursa për në teknikumin financiar. Nga qyteti ynë për në teknikum i doli bursa 16 vajzave dhe djem ishim vetëm unë dhe Berti.

Teknikumi Financiar ishte në të dalë të Tiranës, tek kazermat e Ali Rizait. Këtu kishin qenë repartet e artilerisë. Ne ishim të parat

që çelëm qytetin e nxënësve. Periudha më e bukur e jetës sime ka qenë ajo e shkollës së mesme. Këtu mua më deshën dhe i desha shumë vajza. Në fillim rashë në dashuri me Faziletin. Ajo një natë kur po ktheheshim nga kënvikti më pyeti: A dashuron ndonjë vajzë? - Ta them nesër mbrëma, - i thashë se është histori e gjatë. Atë natë kishim peshk të fërguar. Ne ishim tetë veta që hanim në të njëjtën tavolinë. Kur kishte mish të pjekur ose peshk të fërguar njëri mbyllte sytë dhe tjetri pyeste e kujt është kjo. Atë natë Berti më tha po i mbyll unë sytë, kur të jetë copë e madhe më shkel këmbën. Për herë të parë do të them që është e jotja, pastaj do të them për vehte. - Mirë, i thashë.

Berti mbylli sytë dhe Tefta e pyeste:

- E kujt është kjo?

- E Aliqij!

- Po kjo?

- E Vekes.

- Po kjo?

- E Kiqos.

- Po kjo?

Ishte një copë e madhe peshku. Unë i shkela këmbën.

- E Sajmirit.

- Po kjo?

Ishte një bisht peshku. Unë i shkela përsëri këmbën.

- Imja. Kur hapi sytë dhe pa në pjtatën time një copë të madhe peshku dhe në pjtatën e tij një bisht të vogël u vrejti në fytyrë dhe më tha:

- Ma punove. Unë ja plasa gazit. Qeshën të gjithë kur e morën vesh. Ajo po më priste tek dera e menciës.

- Pse po qeshnit, - më pyeti. Unë ja tregova dhe ajo u shkri së qeshuri. Sapo dolëm nga menca filloi bora.

- Po bije borë! Po bije borë! - u dëgjuan zërat e nxënësve. Po bije borë, - thirrëm ne dhe mundoheshim të kapnim fluturzat e borës. Ato ishin delikate dhe sapo binin në pëllëmbët tona shkruinin menjëherë. Lulit ju qëndisën kaçurrelat me petalet e bardha të borës. Ishte një natë që s'kthehet më. Unë isha i gëzuar që s'po më pyeste Luli kush është ajo vajzë që dashuron ti. Por, ajo u kujtua si papritur dhe më tha:

- Hajt më thuaj tani se cila është ajo vajzë që dashuron ti.

- Do ta them larg e larg, i thashë, ti kuptoje vetë.

- Mirë, - më tha. A dashuron ndonjë vajzë?

- Po!

- Ku është?

- Në Tiranë.

- Në cilën shkollë?

- Në shkollën tonë.

- Në cilën klasë?

- Në klasën tënde.

- Mos është Olimbia?

- Jo!

- Aliqi?

- Jo.

- Elisabeta?

- Jo.

Ajo i përmendi të gjitha vajzat e klasës së saj emër për emër dhe unë i thoja jo.

Po sikur të iki unë nga klasa, a është ajo në klasë?

- Jo!

Ajo nuk foli më. As unë nuk fola. Bora po zbardhte majat e pemëve, trotuaret, gjithçka.

Në klasë të dytë Luli nuk erdhi më në shkollë. E kishte martuar familja. Në degën e Bankës kishte më shumë vajza. Djem ishin pak: Unë Bexheui, Fatmiri, Panajoti, Jorgua dhe Zisua. Ne ishim konviktorë, por në klasën tonë kishte edhe vajza të jashtme. Ato ishin: Lumnia, Elca, Violeta, Qefserja, Drita, Veronika dhe Leta. Sa vinin në klasë, linin çantat dhe Lumnia, Elca, Violeta dhe Leta më shpallnin luftë. Unë vetëm dhe ato të katra. Fillonte përleshja me grushta, me pëllëmba, me të kapura nga flokët. Ato turreshin të gjitha njëherësh, por unë kapja dhe sulmoja më shumë Letën. Ajo ishte e brishtë, delikate dhe e bukur si një lule zambaku.

- Ej, çfarë bën ti, më thoshin shoqet e saj. Pse i vërsulesh më shumë Letës: pse është delikate apo pse është e bukur. Sapo i turresha unë, ajo ulte kokën. Unë bëja sikur i shkulja flokët, por i përkëdhelja faqet, gushën, e kapja nga gjinjët. Ajo tulatej si shqerrë në duart e mija. Gjithmonë ajo më deklaronte duelin e para. I pëlqenin përkëdheljet. O Zot, sa shpejt fluturuan ato vite. Mbasi mbarova shkollën e mesme mua nuk më doli bursa për në shkollën e lartë. Unë e kisha urryer komunizmin që kur isha i vogël. Ato ditë, në kinematë e qytetit shfaqej filmi: «Zëri në shtrëngata». Nga filmat me dashuri ky është filmi që më ka pëlqyer më shumë. Ky film ishte pa përkthim, por unë shkoja e shikoja me Dianën. Ajo ishte me origjinë italiane dhe ma përkthente fjalë për fjalë. Ne e pamë filmin 12 herë dhe unë e mësova për mendësh sa fillova ta tregoja sikurse e përktheja.

Pse e pamë kaq herë filmin?

Na pëlqen apo se duart topa nuk e lëshonin njëra tjetrën gjatë gjithë shfaqjes. Apo se mua e Djanës na puqeshin mendimet? Ato ditë në Hungari u bë revolucioni kundërkomunizmit. Unë e Diana ishim shumë të gëzuar, kur dëgjonim se të gjithë oficerët e sigurimit po i varnin nëpër shtyllat elektrike. Por, unë e kuptova se kush ishte komunizmi, kur shkova ushtar. Më çuan tek shkolla e instruksionit te rrapi i Trishtit. Komandanti i shkollës vinte çdo mëngjes dhe shikonte se si ishin rrgulluar krevatet. I donte të ishin si kuti shkrepsje. Një ditë erdhi dhe pa krevatin tim. Më pa në sy dhe më tha: - Prishe!

- E prisha!

- Rregulloje!

- E rregullova!

- Prishe, - më tha përsëri.

E prisha dhe e pashë në sy.

Prishe, më tha me inat.

E prisha duke e vështruar edhe unë me inat.

- Rregulloje!

Unë ja futë dyshekut dhe jastëkut me shkelm.

- Kapeni, arrestojeni, urdhëroi ai. M'u vërsulën dy-tre kapterë e oficerë dhe më kapën nga krahët.

- Preji fletë arrestin më dhjetë ditë burg.

Më prenë fletë arrestin me dhjetë ditë burg dhe më çuan në garnizonin e qytetit. Jeta në shkollën e instruksionit ka qenë e padurueshme. Sidomos për mua që vija nga shkolla e mesme. Në darkë, kur binim për të fjetur, kapteri vinte dhe shikonte çizmet, a ishin të gjithë në një vijë të drejtë, e po mos të ishte vetëm njëra çizme nga i gjithë kapanonin na çonte disa herë nga gjumi. Një

mesnatë kapteri dhe një oficer operativ na bënë alarm. Na nxorrën jashtë dhe na bënë vrap nëpër kodra. Pastaj na sollën përpara shkollës dhe filluan nga fjalimet e tyre dogmatike, e tërë slogane për atdheun, partinë dhe shokun Enver. Për Bashkimin e madh sovjetik e për imperializmin Anglo-Amerikan.

- Kur të thonë futuni brenda, asnjë të mos lëvizë, - u thashë shokëve të togës sime.

Mbasi mbaruan fjalimet naurdhëruan të futeshim brenda një nga një. U futën togat me radhë. Kur na erdhi radha ne, nuk lëvizi askush nga vendi.

- Toga radiste për një me vrap drejt kapanonit, - urdhëroi kapteri, por asnjë nuk lëvizi. Pastaj e mori komandën oficeri operativ, por dhe komanda e tij nuk u zbatua.

Toga mbrapa ktheu! - urdhëroi ai. As një lëvizje.

- Toga shpërndau! Përsëri askush nuk lëvizi.

E di unë kush i bën të gjitha këto, Saimir Derveni, - tha ai. Më erdhi afër dhe më tha: S'ke turp, ke dhe yllin e kuq në ballë. Unë pa folur hoqa kapelen nga koka dhe e flaka me shkelm tutje.

- E patë shokë, e patë, - fliste si i llahtaritur, I ra yllit të kuq me shkelm. Kapeni vetë lidheni. Por, askush nuk lëvizi.

- Kjo është revoltë, - tha ai. Do ta paguash Saimir Derveni. Do ta paguani të gjithë.

Të nesërmen mua më nxorrën para shkollës dhe komandanti i shkollës propozoi që t'i dërgohesha gjyqit ushtarak. Atëherë nga rreshti dolën dy veta dhe thanë:

- Po u dënua Saimiri, na dënoni edhe ne dhe hoqën kapelet dhe rripat e mesit. Një nga një filluan të dalin ushtarët me rradhë. Komandanti i shkollës u nxi në fytyrë dhe kishte mbetur si i ngrirë.

Atëhere del komisari dhe duke buzëqeshur thotë:

- Ja, kështu i duam ushtarët ne, që të jenë të gjithë grusht të bashkuar. Kështu na mëson edhe partia e shoku Enver. Kështu shpëtova nga gjyqi ushtarak se do të isha dënuar që atëhere. Kur shkonim në menci na çonin deri tek dera dhe thoshin:

- Mbrapa ktheu! Këtë e bënin diçka herë. Unë dilja nga rreshti dhe nuk shkoja për bukë fare. Kur futeshim në menci, pasi kishim shijuar një lugë gjellë na thoshin:

- Çou!

Çoheshim.

- Ulu!

Uleshim.

- Çou!

- Ulu!

- Çou!

- Ulu!

Unë e derdhja pjatën e grosheve dhe dilja pa ngrënë. Mbrapa më ndiqnin britmat e oficerit të rojes.

- I padisiplinuar! Ta rregulloj unë ty!

Por, kulmi arriti atë ditë. Na ngarkuan me çantat e shpinës, batanijet, me kundragaz në fytyrë e me pushkë në krahë e na nisën drejt Dajtit. Ishte Korrik dhe temperatura kishte kaluar të dyzetat. I morëm të gjitha kodrat me vrap. Qesja e kundragazit mbushej me djersë. Ecëm barkas pas marrjes së urdhërit: Barkas, armiku djathtas, armiku majtas, armiku përpara, armiku mbrapa. Na bënë të ecnim në gjunjë. Çdo gjë ka një kufi. Fija e durimit ishte holluar dhe ishte gati për t' u këputur. Të gjithëve u kishte ardhur shpirti në majë të hundës. Aty nga ora katër e mbasdites u kthym në shkollë.

Lart, si në presidium rrinin të kapërdisur: komandanti i shkollës së instruksionit, komisari, shefi i shtabit të batalionit, komandantët e togave dhe këshilltari sovjetik. Poshtë rrinim ne në rresht.

-Para se të lini armatimin e pajisjet në kapanon tre e nga tre do të parakaloni para komandës së shkollës me hap të shtrirë. Po e bëtë mirë do të shkoni të hani bukë, po nuk e bërë mirë do ta gdhini këtu deri sa ta bëni mirë. Filloi parakalimi tre e nga tre. Komandën e mori vetë komandanti i shkollës:

- Shtrije hapin, shtrije, shtrije Një-dy, Një-dy!

Unë u thashë dy shokëve të mij që ishin në rradhë që kur të na vinte radha ne të mos e shtrinin hapin fare, por të ecim më ngadalë!

- Mirë, - më thanë ata.

Erdhi radha jonë. Ne u nisëm sikur po dilnim xhiro.

- Shtrije hapin, shtrije hapin! - bërtiti komandanti.

Zbriti nga shkallët dhe na erdhi pranë.

- Shokë kursantë shtrijeni hapin. Ne ecnim si miza.

- Mirë tha mos ecni, po nuk e shtritë hapin këta dhe ju do të rriin këtu gjithë natën, ju drejtua togës. Asnjë nuk foli. Zbriti vetë komandanti i shtabit.

- Shtrijeni hapin se do të dënoheni, do t'ju çojmë në gjyq. Ai s'la kërcënim pa na bërë. U thye i pari Kristaqi. Pastaj edhe Injaci. Mbeta vetëm unë. Më kërcënoi përsëri, por unë vendosa që ta çoja deri në fund.

- Do ta shtrish hapin a po të të marrim shpirtin, - tha komandanti i shkollës dhe filloi të zbriste shkallët. Unë hoqa kundragazin nga koka dhe i thashë:

- Të pëllcasësh nuk e shtrij hapin.

- Kapeni, arrestojeni! - klithi ai. Unë e humba logjikën i shava

dhe mora një gur dhe u rashë me sa fuqi që kisha. Ata ulën kokat, guri ra në xhamin karshi dhe copat e xhamave ranë mbi kokat e djemve të shkollës dhe mbi kokën e këshilltarit sovjetik. Pastaj mora dy gurë dhe i rashë vetes sime. Rashë pa ndjenja një kanal. Kur u përmenda isha i shtruar në spital. Ndërhëri mjeku psikiatër duke thënë se ka tronditje nervore dhe unë shpëtova nga gjyqi ushtarak.

* * *

Kur mbaruam shkollën e instruksionit më çuan në postën e Lezhës. Posta ishte ngritur në një lëndinë në mes të pyllit. Ishin tre godina një katëshe. Vendkomanda, ku ishin zyrat e komandantit të postës, komisarit dhe oficerëve të tjerë, dhoma e kulturës dhe dhoma e ndërlihdjes. Godina e fjetores dhe menca, ishin tre makina ku ishin instaluar radilokatorët e zbulimit, gjithashtu dhe qendra e dhënies.

Kjo postë ishte dy orë në këmbë nga qyteti i Lezhës. Posta ishte e rrethuar. Nga perëndimi kishte detin Adriatik, në veri e lindje lumin Drin dhe në jug kënetën ku ishte dhe rruga që e lidhte me Lezhën. Në dimër kur frynin erërat e jugës, rruga mbulohej nga ujërat e kënetës, kurse kur frynin erërat e veriut rruga lirohej.

Në këtë postë ishin tetëmbëdhjetë ushtarë dhe katër oficerë.

«Këtu nuk kishte rreshtore si në shkollë. Kishte shërbim tre turnesh. Ky ishte një vend magjepës. Në pranverë çelnin lulet e egra që nga luleshqerëza, zambaku i gjolit e deri tek trëndafilat e egër. Në verë ishte: deti, rëra, shalqijtë, rrushi çeleg, ftonjtë deri te kulumbrijtë. Në këtë vend mblidheshin gjith llojet e shpendëve të

egra që nga bilbilat, harabelët, mëllenjat, rosat e patat e egra e deri tek lejlekët e pelikanët. Mëngjezeve ose mbrëmjeve mund të sodisje edhe lodrat e pafundme të delfinave. Netëve në verë shtrihesha në krevat e gjumi s'më zinte deri vonë, dëgjoja këngën e bilbilave dhe trokun e hingëllimat e kuajve. Posta jonë kishte shumë kuaj që bënin një jetë të lirë, gjysëm të egër. Pranë postës sonë në verë ngrinin çadrat romët. Ata prisnin thupra shelgu e thurnin shporta e kanistra. Romët bridhnin tërë ditën fshatrave të Zadrimes, shisnin shportat e kanistrat e u hidhnin fallin fshatarëve. Në mbrëmje ndiznin zjarre dhe këndonin këngët e tyre. Këngët ishin prekëse. Ata i këndonin fatit të tyre. Meloditë dukej sikur i sillnin erërat e lindjes tutje nga Azija. Pastaj kur shuheshin zjarret e rrekeshin këngët fushave të Zadrimes ndiheshin hingëllimat e kuajve. Romët atë vit kishin sjellë një meze. Mezja ishte e kuqe me një qime të shndritshme. Ajo ishte në periudhën e afsheve.. Ajo vraponte si e dehur fushave të Zadrimes dhe kuajt e ndiqnin pas. Kerri i postës sonë nuk kishte ndonjë trup të madh, por ai e vinte përpara turmën e kuajve dhe mezen embante për vehte. E dashuronte siç thoshin ushtarët. Kur vinin vjeshtërat nishin e vinin rosat e patat e egra nga viset veriore. Ato uleshin në kënetën tonë për të dimëruar. Netëve kur nishin e frynin erërat e Jugës, dëgjohej oshëtima e pyllit, gumëzhima e detit dhe kori i rosave e patate të egra. Në këtë postë unë kalova dy vjet.

Kur isha në shkollë të mesme unë kisha lexuar shumë libra të verdha. Ne mbledheshim dhe unë u tregoja lloj lloj romanesh. Ishim në moshë dhe mendjen e kishim vetëm tek femrat.. Të gjithë sanjonim me fantazinë tonë të ndezur nga pasionet lloj lloj aventurash dashurie sikur na kishin ndodhur neve. Megjithëse e

dinim që të gjitha ishin trillime i dëgjonim me vëmendje se kjo është tema e moshës.

Por atë verë në qytetin e Lezhës erdhi një vajzë e bukur me gërsheta. Të gjithë ushtarët e postës sonë ranë në dashuri me të dhe bashkë me ta dhe unë. Merrim liridalje dhe bënim katër orë rrugë në kmbë, vajtje-ardhje vetëm për të parë Naxhijen. Kështu quhej vajza me gërsheta. Ajo herë delte në ballkon, herë në dritare dhe herë dilte rrugëve të qyteti. Na buzëqeshte të gjithëve dhe na i bënte me dorë. Ça thonin që ishte shkodrancë, ca të tjera thonin që kishte ardhur nga skajet veriore.

Në shtator mua më lejoi komanda që të vazhdoja gjimnazin e Lezhës ditën. Në klasë gjeta edhe Naxhijen. Ajo m'u afrua sikur të ishim njohur prej vitesh. Unë mezi e prisja mëngjesin për t'u takuar me Naxhin. Ajo dilte e më priste. Edhe kur dilnim nga shkolla ajo më përcillte dhe qëndronte në vend derisa silueta më humbiste tej fushave të Zadrimës. Erdhën vjeshtërat e nisën të frynin erërat e jugës. Rruga mbulohej nga ujërat e kënetës, por unë nuk mungoja asnjë ditë në shkollë. Ecja gati një orë nëpër ujë që më vinte deri në bel e herë herë deri në sqetull. E të gjithë këtë e bëja se nuk më rrihej pa e parë Naxhijen. Kur dilnin nxënësit në pushim ne rrinim në klasë e putheshim fshehurazi, shpejt e shpejt e tërë frika, se po të diktonin të përjashtonin nga shkolla. Dashuria ishte e ndaluar në shkollë të mesme. Ishte mbrëmja e maturës. Mbrëmja e fundit që u takova me Naxhijen. Ajo më zuri nga krahu dhe më tërhoqi jashtë. U ngjitëm tek kalaja e Lezhës. Poshtë në këmbët stona htrihej qyteti e sa të hante syri fusha e Zadrimës. Mbrëmja e maturës vazhdonte. Ne filluam të puthemi pa frikë se nuk na shikonte njëri përveç yjeve, hënës dhe mureve mijravjeçare të

kalasë. Ajo filloi të zhvishej. Unë e puthja pa pushim, por kisha pirë shumë dhe nuk mbaj mend deri kur shkuan lodrat e dashurisë. Edhe tani si nëpër një napë mjegulle më shfaqet ajo natë. Që atë natë nuk e pashë me Naxhin. Atë e mörën prindërit atje larg në veri. Ne u liruam në Nëntor.

Unë kisha filluar të botoja tregimet e para dhe më morën si gazetar në «Zërin e Rinisë». Aty nga muaji shtator, mora një letër nga Naxhija. Kishin kaluar gati 15 muaj pa marrë vesh gjë për të. E hapja letrën. Ajo më shkruante:

E mora vesh që punon në «Zërin e Rinisë» dhe u gëzova. U gëzova për ty e për djalin tonë se fati im u vulos. Nuk u besova syve kur lexova këtë fjalë.

I lexova përsëri. O Zot! A është në vehte kjo?!

Djali jonë?!

Sigurisht që do të këtë shkarë thashë me vehte dhe vazhdova leximin e letrës.

Ti do të habitesh dhe do të më quash të marrë ose mashtruese, më quaj si të duash por dije se këto që po të shkruaj janë të vërteta.

A të kujtohet ajo natë tek kalaja? Ti ishe i pirë dhe ndoshta nuk të kujtohen të gjitha. Ne bëmë dashuri. Unë t'u dorëzova atë natë. O Zot, nuk të bëj fajtor ty. Unë isha nistarja. Ti ishe i virgjër. Edhe unë isha e virgjër. Edhe unë isha e virgjër. Për këtë s'të gënjej se s'kam asnjë interes. Atë natë unë ngela shtatzënë me ty. Kjo do të duket absurde, por s'ka rëndësi. Kij durim dhe lexoje letrën deri në fund. Pastaj mua më morën prindërit dhe nuk u takuam më. Më fejuan me një oficer marine. Por unë isha shtatzënë. Fati im që ai iku me shërbim për një kohë të gjatë jashtë shtetit dhe unë u shtrova në maternitetin e Elbasanit dhe linda djalin. Emrin ja kam vënë

Ergys. Të kujtohet kur më thoshe se do të martoheshim bashkë dhe po të lindnim djalë do t'ja venim emrin Ergys dhe po lindëm vajzë do t'ja vemë Akereona?

Ai mban mbiemrin tënd dhe për atesi ka emrin tënd. Nododhet në shtëpi e fëmijës në qytetin e Elbasanit. Po deshe kujdesu për të se unë nuk mundem. Nuk i kam thënë gjë burrit. Mos më mbaj inat për të gjitha këto sa janë të vërteta. Unë të kujtoj dhe s' do të harroj sa të jem gjallë. Ti s' më ke asnjë faj.

Mbeta si i ngrirë për disa çaste. Gënjen, - thosha me vehte dhe e urreva nga thellësitë e shpirtit. Kush e di me kë do ta ketë dhe përpiqet të ma veshi mua?

Unë e ndërpreva rrjedhën e jetës dhe përpiqesha të ndizja të gjitha qelizat e kujtesës për të ndriçuar këtë ngjarje të jetës sime. Por Alaudini e pa se Sandri ishte i shqetësuar. Jeta e tij ishte shumë e shkurtër. Ai ishte 18 vjeç. E çfarë do të kujtonte ai, lodrat fëmijërore dhe adoleshencën?

Kaluam dhe ca ditë. Bëmë një udhëtim nëpër vitet e jetës sonë, - na tha Alaudini, - ju jeni më të rinj dhe rruga e jetës suaj është më e shkurtër nga ajo e jetës sime. Dhe ai çdo natë filloi të na tregonte frygimente nga jeta e tij.

Nga internimi u kthëm kur mbarova unë ushtrinë. Në një kurs nëntëmujor tregtie në Shkodër unë u dashurova me një vajzë. Ajo atëhere ishte 16 vjeçe, ndërsa unë 22. Me të u martova dhe më lindën tre vajza. Ajo ishte e bukur, naive dhe e pafjalë.

Në moshën 27 vjeç me arrestuan për agjitacion e propagandë dhe më dënuan me 13 vjet heqje lirie. Kur u lirova nga burgu motrat ishin martuar. Edhe gruaja ishte martuar me një tjetër. Vajza e madhe ishte bërë 20 vjeçe, e mesmja 18 vjeçe dhe e vogla 13 vjeçe

se një muajshe e lashë kur e arrestova. Nëna mezi i ka rritur. Dilte fushave me vajzat e vogla e mblidhnin kamomil e shkonin e shisnin në grumbullim e merrnin lekë sa për të blerë një gjysëm buke e një shishe kos. O Zot ku e kanë mbajtur atë shpirt. Ne atëhere jetonim në ca stalla kuajsh. E gjithë ajo mëhallë ishte e varfër. «Mëhalla e zengjinëve», - thoshte një plak nga Shkodra për mëhallën tonë.

Xhumja, Hyrija dhe të gjithë romët e tjerë të mëhallës sonë mblidheshin e grumbullonin letra e shkonin e shisnin në grumbullim për të mbijetuar.

Xha Hasabi ishte 120 vjeç. Ai nuk kishte pension, por rrinte gjithë ditën kafeneve e pinte kafe e konjak. E qirasnin myshterinjë të që u shinte fallin me filxhan. Thoshin se ai i gjente të gjitha, por unë nuk e kisha shtënë fallin tek ai asnjëherë. Ai mbante mace. Kur vinte ai në mbrëmje ato i dilnin që në krye të rrugicës dhe e prisnin duke mjaullitur: Hajdeni ke baba! Hajdeni ke baba! - u thoshte dhe u hidhte peshk që e blente enkas për to. Maceve të xha Hasanit u shkëlqente qimja se ai i mbante me peshk e qumësht. Ai vinte gjithmonë i pirë, por mendjen e kishte top. Çdo natë kthehej nga ne dhe na pyeste se a kishim bukë për atë natë. Sa që xha Hasani gjallë macet e tij nuk linin mi të pipëtinte, por kur ai vdiq, macet u arratisën dhe minjtë e kanaleve të zeza na i bënë muret vryma vryma.

Unë u futa në punë në një ndërmarrje pranë shtëpisë. Megjithëse qeveria më kishte cilësuar armik njerëzit më donin.

Mua më kanë dashur gjithmonë vajzat naive, kafshët, fëmijët dhe të çmendurit.

Mos u çudisni do t'jua a tregoj me fakte. Edhe me gruan që u martova dhe linda tre fëmijë ishte naive.

Unë siç ju thashë isha dyzet e ca vjeç kur u lirova nga burgu. Por a e dini ç'ndodhi, me mua ra në dashuri një vajzë njëzet vjeç, sa gjysma e moshës sime. Ajo ishte femra më e bukur e ndërmarrjes sonë. Unë në moshën dyzet vjeç i njoha të gjitha rrugët dhe rrugicat e Tiranës.

- Hajde më përcill, - më thoshte. Më prit tek treni ose tek selvija, dhe unë e prisja dhe e përcillja deri pranë shtëpisë së saj, në periferi të qytetit.

Ne flisnim gjëra të përgjithshme, por ndienim kënaqësi pranë njëri-tjetrit.

Mirë unë, po ajo çfarë pëlqente tek unë?! Unë isha një i burgosur politik, armik siç më quanin ata të Partisë, dyzet e ca vjeç; i thinjur dhe i varfër, i martuar dhe i divorcuar me tre vajza.

Pastaj fillova edhe ta prisja kur të vinte puna. Çohesha herët, rruhesha dhe shkoja për ta pritur. Binin e shira e unë nuk kisha çadër, këpucët më futnin ujë, por asnjëherë nuk e lija pa dalë për ta pritur e ta përcjellë. Javën që ajo ishte turni i dytë, unë isha njeriu me i lumtur në botë. Ato ishin pesë vajza në turn. E kishin kuptuar që ne duheshim, por s' thoshin gjë. Ishin vajza të mrekullueshme. Ato na linin vetëm të dyve e ne bisedonim me orë të tëra e na dukej sikur koha fluturonte. Ajo nxirrte tek supi pak rrypin e kanatierës. Unë i thosha se sa të bardhë e ka e ajo më shikonte me bisht të syrit. Unë i kapja rrypin e kanatieres e bëja sikur e shikoja, por në fakt i shikoja gjinjtë e vegjël e të bardhë. Ajo mbulonte gjinjtë dhe më thoshte:

- Ah ç'je një ti!

Një ditë ajo po fshinte sallën. Unë po e sodisja nga dritarja.

- Pse më sheh ashtu? - më tha.

- Qenke bërë shumë e bukur. Seç të paska rënë një nur.

- Tashti sa dola nga banja, - më tha. Ajo nxori gjuhën dhe lëpiu buzët.

- Oh ç'gjuhë të bukur që paske, - i thashë. Ajo u përkëdhel dhe i lëpiu përsëri buzët.

- Oh, të marrsha të keqen e asaj gjuhe, - i thashë.

- Jam lisho, - më tha, - vetëm me përparësen e bardhë.

- Me gjithë mend, - i thashë.

- Ja, - më tha dhe zbërtheu përparësen e bardhë.

O Zot ç'trup të derdhur që kishte. Nuk kisha parë në jetën time një lëkurë aq të lëmuar e të shkëlqyer. U futa me vrull brenda dhe e rrëmbeva në krah.

- Mos se do të na shohin, - më thoshte dhe nuk më shqiste duart nga qafa. S'kam për t'i harruar kurrë ato çaste. Pastaj ai heshti.

- Po pastaj si shkoi puna, - pyeti Sandri. Pastaj mua më arrestuan përsëri dhe më dënuan me dhjetë vjet heqje lirie. Më çuan në kampin e Pish-Porros, matanë Vjosës. Punonim në kripore. Puna ishte një orë e gjysëm larg nga kampi. Shirat atë vit filluan aty nga fundi i muajit shtator e vazhduan pa ndërprerje gjatë gjithë vjeshtrave. Ne çoheshim që në orën gjashtë e niseshim për në punë. Ne ecnim në kollonë për tre. Përpara, mbrapa dhe anash na shoqëronte ushtri e policë me automatik e qen kufiri. Binte shi dhe na rrihte pa mëskirë kokat e qethura dhe na futej thellë deri në kockë. Me natë niseshim e me natë ktheheshim në kamp. Më dukej vetja sikur isha personazh i ndonjë filmi. Shiu binte dhe unë zhytesha në botën time.

* * *

Ishte fundi i Nëntorit. Kur u nisëm për në kamp u nxi fare. Pastaj ja nisi një shi me erë. Vetëtimat të qërronin. Qentë e kufirit filluan të lehin. Kapterat filluan t'ju bien bilbilave e ushtarët bërtisnin herë pas here alt! alt!. Ne ecnim në baltë e shi, kur një thirrje çau errësirën:

- Pas meje vëllezër! Mjaft më!

U bë një rrëmujë e zallahi. U dëgjuan breshëri automatiku e mitraloza. Hapa që vraponin në errësirë. Goditja e shkopinje të gomës mbi trupat e kokat tona. Unë vrapoja pa vetëdije. Diku larg, shumë larg feksnin ca dritëza. Këmbët instiktivisht më tërhiqnin drejt atyre dritëzave. Por, m'u duk se dikush më kafshoi në pulpe. Qeni i kufirit, - mendova. Ktheva kokën. S'kishte gjë. Vetëm errësirë dhe kaçube zhukash. Eca dhe disa hapa dhe rashë. U zvarrita barkas deri tek një kaçube me zhuka dhe u mbështeta atje. Isha plagosur. Pastaj në qiell u bë dritë nga fishekzjarret.

- Dëgjova një hukatje. Drejt meje po vinte një qen kufiri. Nuk lëvizja dot. Ai m'u afrua, më mori erë, hungëlliu dhe u ul pranë. Hungëllinte dhe më lëpinte duart.

- Ja ku është një, u dëgjua një zë. E ka kapur qeni i kufirit.

- Çou! - më thanë.

Unë desha të çohesha, por rashë përsëri.

- Luaj qelbësirë, - më tha njëri dhe ma veshi me shkelm turinjve.

Qeni Hungëriu.

- Kape, hiqe zvarrë, - e urdhëruan qenin.

Qeni më vështronte mua dhe nuk lëvizti. Njëri më zuri nga krahu

dhe filloi të më tërhiqte zvarrë nëpër baltë.

Qeni hungëriu dhe ju hodh kapterit. Ai tjetri ja shkroi të gjithë plumbat mbi kokë qenit.

Qenka bërë me armiqtë, mirë ja bërë, - i tha ai tjetri. Atë natë u vranë 15 të burgosur dhe u plagosën 130 të tjerë. Për disa ditë kampi nuk doli në punë. Pastaj mua dhe disa të tjerëve na transferuan në kampin e Ballshit.

* * *

Në kampin e shfarosjes së Ballshit më çuan më 14 Mars ditën e verës. Kur zbrita nga autoburgu, pashë bajamet e lulëzuara. Vështrimi im fluturoi i lirë dhe zemra m'u drodh si e një zogu. Dëgjova këngën e një zogu, gurgullimën e një ujvare, blegërimën e një qengji. Jeta vazhdonte. E unë kisha kohë që isha ndarë nga ajo. Sa më kishte marrë malli. Për të fjetur më vendosën në kapononin Nr. 5. Dhe qelia ime mbantë numrin 5.

Kapononi ishte i gjatë si stallë kuajsh, me krevate dërrase tre katësh. Mua më ra të flinja në katin e tretë. Pranë kokës kisha dritaren. Netëve nuk më zinte gjumi dhe nga xhami i dritares sodisja yjet, hënën. Isha i përmalluar për çdo gjë. Edhe kënga e kukuvajkës, që këndonte çdo natë mbi kapononin tonë, më dukej e bukur. Sodisja yjet, hënën, dëgjvoja këngën e kukuvajkës dhe rrjedha e mendimeve më merrte me vete, jashtë telave me gjëmba. Udhëtonim tërë natën unë dhe mendimet e mia. Iknim shumë larg, në vende e kohë.

Binte çanga e unë kthehesha nga udhëtimet e largëta. Dilja nga bota ireale dhe kthehesha në botën reale. Isha në kapononin Nr. 5

i rrethuar me tela me gjemba. Yjet atje lart që ende s'kishin perënduar më dukeshin të ftohët, pa jetë. Të rrëqethura më përshkonin tërë trupin. - Çohuni! Çohuni - ndiheshin thirrjet e gardianëve. Nga krevatet e akullt si sarkofag çoheshin skeletet me koka të qethura. Rreshtoheshim. Bëhej apeli. Pastaj, në rradhë, shkonim para kazanëve. Rrufisnim si të babëzitur atë trubullirë të quajtur supë e niseshim për punë. Niseshim pa zbardhur e ktheheshim në të perënduar të diellit. Kur futeshim në kamp na bënëin përsëri apelin, duke na kontrolluar. Kontrolli bëhej duke na zhveshur fare ashtu siç kishim lerë nga nëna. Kur shkonim para kazanëve nata pushtonte gjithësinë. Ky lajtmotiv ishte refreni i çdo ditë. Nata ishte mbretëria jonë. Shtriheshim në krevat për të shlodhur eshtrat. Mendimet tona kalonin telat me gjëmbe e shkonin për t'u takuar me jetën. Një natë u çova i llahtaritur nga krismat e pushkëve. kapanoni ishte i zhytur i tëri në errësirë. Vështrova nga dritarja. Edhe prozhektorët ishin fikur.

- Alt! Alt! - dëgjoheshin thirrjet e rojeve nga kullat e vrojtimit. Sa herë shkrepeshin bataret, gjithë kampi ndizej nga mijra gojzë dritash.

- Ç'është? - pyeta shokun që kisha pranë.

- Janë fikur dritat, kur fiken dritat, komanda e kampit e ndriçon territorin duke hedhur fishekzjarre.

Kur u ndezën dritat pushuan të shtënat, kapanoni ra në qetësi. Dëgjohej vetëm kënga e kukuvajkës mbi çatinë e kapanonit tonë. Të gjithë ishim shtrirë për të fjetur. Vetëm dy koka të qethura rrinin zgjuar. Ata më panë që i vështroja dhe më buzëqeshën. Njëri prej tyre, mori një kanoçe alumini dhe ca krodhe dhe erdhi tek unë.

- Na, merre, - më tha. - Haji se je i uritur.

Unë e falenderova.

- Juve të dyve ju kam parë dhe netë të tjera që rrini deri vonë zgjuar, - i thashë.

- Shkruajmë, - më tha.

- Çfarë? - e pyeta.

- Poezi. Eshtë koha më e përshtatshme për të shkruar.

Që atë natë lidha miqësi me ta dhe u bëmë shokë të ngushtë. Rrinim bashkë punonim bashkë, e netëve shkruanim poezi deri vonë. Atë ditë ne të treve na takoi të punonim pranë rrugës kryesore. Matanë telave me gjëmba kalonin makina, karroca e njerëz të lirë. Por çdo ditë atje kalonin edhe vajzat e gjimnazit, me përparëse të zeza e jaka të bardha. Ato kalonin dy herë në ditë. Një herë në orën shtatë e gjysëm dhe një herë në orën dy. Këto ishin çastet më të bukura për ne të tre. I ndiqnim me vështrimet tona të dëshiruara deri sa humbisnin tek kthesa e rrugës. pastaj gjithë ditën muhabeti sillej rreth tyre. Kush ishte më e bukura, kush ishte më çapkëne, kush ishte më llastica, kush ishte më seriozja. Edhe ato kur kalonin na hidhnin ndonjë vështrim vjedhurazi. Ishte fillim pranvere. Ata të dy ishin të rinj. Ladi 21 vjeç e Niku 22. Të dy kishin qenë studenta në fakultetin gjuhë-letërsi. Ladi në vitin e dytë, kurse Niku në vitin e tretë. U kishin kapur ca poezi kundër pushtetit popullor dhe i kishin dënuar me nga dhjetë vjet heqje lirie për agjitacion propagandë. Një ditë me gjimnazistët kaloi dhe një vajzë tjetër që ne s'e kishim parë asnjëherë. Ajo kishte flokë të zeza e buzë të fryra seksuale. Ishte më e bukura, veç nga të tjerat ajo ndalonte dhe fshehurazi, na e bënte me dorë. Ata të dy ranë në dashuri. Por për këtë nuk tregoi asnjëri. Një ditë ajo, na dëftu një lule vjollce dhe mërmëriti: «Më quajnë Vjollca».

Që atë ditë ato të dy thurën me dhjetra vjersha për Vjollcën. Një ditë Ladi na propozoi për t'u arratisur. Ne ishim gati. Po si? Kampi ishte i rrethuar me tela me gjëmba në tre baza. Në çdo tre katër metra, ngriheshin kupolat e rojeve me automatik e mitraloza. Pastaj ishin edhe qentë e kufirit.

Ishte e djelë, 22 Prill. Pranvera kishte triumfuar plotësisht. Ishte ditë pushimi. Ditët e bukura të pranverës na trullosnin ne të burgosurve. Në këto ditë ne ishim shumë të shqetësuar.

Ladi atë ditë kishte që në mëngjes që bënte xhiro vetëm nëpër oborritin e kampit. I folëm nja dy herë unë dhe Niku, por ai vetëm sa na e bëri me dorë. Aty nga fundi 12 ne u futëm në kaponon, por pa kaluar as një çerek ore dëgjuam të thirrurat e rojeve:
- Alt! Alt!

Pastaj krisën bataret e automatikëve dhe të mitralozave. U çuam për të parë se ç'kishte ndodhur. Por dera e kapononit ishte bllokuar me policë e ushtarë.

Thirri tellalli i kampit për rreshtim. Ne u rreshtuam. Në mes të oborrit të kampit vendosën të vrrarin. Ishte Ladi shoku jonë. Të burgosurit përshpërisnin me njëri tjetrin». Qëlluan se shkeli vijën e verdhë», dikush tha se kishte parë operativin që u kishte bërë rojeve me shenjë për të qëlluar.

Komandanti i kampit doli përpara dhe tha:

- Ky ishte armik i betuar. Deshi të arratisej dhe atë që kërkoi e gjeti. Kushdo që do të veprojë si ky kështu ka për ta pësuar. Tani do të kaloni për një dhe do ta pështyni në fytyrë.

Komandanti ishte njeri i neveritshëm, me ca sy e flokë; të shpëllarë. Qëndronte me revole në dorë tek koka e të vrrarit. Kapelja i kishte shkuar shtrembër dhe në dy cepat e buzëve kishte pështymë.

Në krye të rreshtit ishte komisari i kampit, operaivi dhe pastaj vinin gardjanët, ushtarët, policët. Pas policëve ata të prapavijës dhe me radhë të gjithë të burgosurit. Unë e Niku dolëm përpara atyre të prapavijës dhe u rreshtuam pas policëve. Kishim vendosur ta pështynim komandantin në fytyrë. Në këtë kohë na vjen një i burgosur, rreth të pesëdhjetave dhe na thotë:

- Më lini mua përpara.

- Rri mbas nesh, - i thamë.

- Më lini mua përpara, se atë që kini ju në mendje unë do ta bëj më mirë. Ne nuk pranuan.

- Mos ja prishni Eremitit, se keni për ta parë se do ta bëjë më mirë se ju.

Ne nuk ja prishëm, se Eremiti ishte burrë trim dhe i respektuar nga të gjithë të burgosurit. Kaloi i pari komisari dhe e pështyu në fytyrë. O Zot! Të gjithëve na shkuan të rrënqethura në trup. Shqiptari nuk e ka pasur zakon ta poshtërojë të vdekurin. Kaloi operativi dhe e pështyu. Kaluan policët dhe gardianët dhe e pështynë.

- Këta nuk janë shqiptarë! - foli dikush nga rreshti.

- Rracë e poshtë! - ç'fryu një tjetër.

- Rracë e ndyrë komuniste! - kërciti një tjetër dhëmbët.

I erdhi rradha Eremitit. I gjithë kampi ngriu. Komandanti me revole në dorë tek koka e të vrarit i hodhi një vështrim Eremitit. Eremiti u nis duke e parë komandantin e kampit drejt e në sy. Kur vajti pranë të vrarit u ndal. Hoqi kapelen, u ul në gjunjë. Nxori shaminë nga xhepi i xhaketës. Komandantit të kampit filloi t'i dridhej dora. Eremiti i fshiu Ladit fytyrën dhe e hodhi shaminë poshtë. U përkul dhe e puthi në ballë, i puthi sytë, e puthi në buzë.

hakërrua dhe më tha: «Do të diskretitosh edhe oficerin e Ministrisë së Punëve të Brendëshme, mor armik i betuar? Por ti me shokët e tu, tu merrni të keqen atyre, se ata janë heronj të heshtur.

Dhe në fund më dënuan me 9 vjet heqje lirie për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor.

Ja ky është armik Bajrami. Ai nuk kishte fuqi të ecte deri tek vendi i punës, pale pastaj të shtynte dyzet vagona me krom. Ai nuk realizonte dot normën asnjëherë. Bajrami kalonte të tre turnet në galeri.

Ishte një natë e ftohtë nga fundi i dhjetorit. Nga grykat e maleve zbriste një erë e ftohtë e ngarkuar me borë. Atë natë Bajramin e lidhën tek një shtyllë në mes të oborrit. Ai kishte vetëm një këmishë të hollë.

- Opo Lushnja qytet i bukur o shokë more! - këndonte Bajrami.

Ky refren u dëgjua deri natën vonë. Kur u çuam në mëngjes, Bajramit i kishte pushuar zemra nga të ftohtët. Edhe në mes të buzëve kishfe copa akulli;

Ai heshti për një çast. Mua sikur më vinte në vesh zëri i Bajramit. Gardiani na ndezi cigarenë. E pimë duhanin pa folur, secili i zhytur në botën e vet.

- Kur vajta unë në Spaç, kampi kishte gjallëri. Ishte një grup që kompozonin e i binin kitarës. Ishte dhe shoqata e Khajamistëve. Kryetari i Khajamistëve ishte pirati, një detar i vjetër, i cili i dinte përmendësh të gjitha vargjet e rubairave të Omar Khajamit. Ata, çdo gjë që u vinte nga shtëpia e ndanin ndërmjet tyre. Pinin edhe verë, ashtu siç rekomandonte idhulli i tyre, Omar Khajami. Verën e bënë nga marmalata. E mblidhnin marmalatën dhe e fushnin nëpër bidona kauçuku dhe e fermentonin. Në kamp kishte dhe

katër të luajtur mendsh. Nga shoqata e Khajamistëve, u caktova unë të kujdesesha për ta.

Novruzi, fliste natë e ditë me vete. Islami, përplaste kokën mbas murit dhe po ta pyesje çfarë bënte të përgjigjej: «Dua të thyej televizorin që më kanë vendosur në kokë. Unë i urrej këta, por nuk flas. Po ç'ë do, televizioni më ekspozon gjithçka që kam në mendje dhe prandaj unë do ta thyej». - thoshte dhe i binte kokës mbas murit.

Koço Katili qëndronte gjithë ditën në shi, gati lakuriq. Kur merrte pjatën me gjellë, merrte me grushta baltë dhe e fuste në pjatë, e trazontë dhe fillonte e hante me duar. E thërrisnin Koço Katili, se dikur kishte qenë operativ i sigurimit dhe kishte bërë tmerre në njerëz, në rrethin e tij në Korçë.

Kurse Sofua, rrinte ulur në një vend, i shikonte të gjitha dhe herë pas here deklamonte sentencën e tij: - «Tek ai guri me vërrë, një nga një do shkojmë të tërë.»

Unë i merrja të katër në rresht dhe i çoja para kazanit. Novruzi, mbasi merrte gjellën, fillonte nga lëksionet.

- Ha bukë, tani! Lëri muhabetet - i thosha unë.
- Ha bukë, na thotë vëllai - e fillonte të fliste përsëri pa pushim.
- Ore do të hash ti, apo ta fus turinjve.
- Tà fut turinjve, thotë vëllai. Ta fut ai, aq ia pret. Prandaj duhet

të hamë - dhe fillonte të hante.

Kështu bëja edhe me të tjerët. Ata më bindeshin vetëm mua, se siç e dini mua më duan kafshët, vajzat naive, fëmijët dhe të çmendurit.

Por si papritur, jeta në burgun e Spaçit ndryshoi. Kjo ndodhi më 21 maj të vitit 1973. Turni i parë po nisej për në punë. Ende s'kishim dalë nga telat me gjemba, kur shohim se drejt nesh po

vinte Pali. Atij iu vërsulën gardianët dhe operativi. Ai rrëmbeu një dërrasë dhe u mbështet mbas murit.

- Vëllezër, pse bëni sehir - na tha.

Ne i vajtëm në ndihmë. I pari u hodh mbi gardianët Tartarini, geni i të burgosurve. Tartarinin e kishte gjetur Pirati në përrua, e kishte marrë dhe e kishte rritur. Tati, siçe thërrisnin të burgosurit me përkëdhelje, na shoqëronte nga kampi në punë dhe na priste sa delnim nga galera, e na shoqëronte përsëri për në kamp. Gardianët dhe oficerët, dolën jashtë telave me gjemba.

- Vëllezër, tani që e nisëm, ta shpiem deri në fund - foli njëri nga të burgosurit.

- Poshtë komunizmi, poshtë diktatura! - ushtuan grykat e maleve. Atë mëngjes pranvere. I grisën të gjithë parrullat. E grisëm dhe flamurin me yllin e kuq mbi kokën e shqipes. Bëmë një flamur kombëtar të ri, pa yll të kuq dhe e ngritëm nga kati i tretë. Kampi në fillim u rrethua nga ushtarë, pastaj erdhën nga Tirana togat e sampistëve. Më vonë, kampi u rrethua me tanke e autoblinda.

Copilin e kishin ngritur në duar të burgosurit dhe ai u drejtohej ushtarëve:

- Vëllezër, ne jemi baballarët tuaj, vëllezërit tuaj, të afërmit tuaj, shokët tuaj, moshatarët tuaj. Armët mos na i drejtoni ne, por Qeverisë së Tiranës.

Sampistët, sa zbritën nga «Ifat» qëlluan me breshëri automatiku mbi kokat tona.

- Djema, mbahuni? Ata kanë armët, ne kemi zemrat. Zemrat janë më të forta se armët-thoshte një malësor i moshuar.

Ne kërkuaam përfaqësi nga fuqitë e mëdha dhe OKB-ja.

Ra nata. Ishte një natë pranverore me yje të mëdhenj. Një natë

magjiplote. Ashtu, siç janë netët pranverore në bjeshkët tona. Po kjo natë ndryshonte nga netët e tjera. Urrejti, e mbledhur në vitë, kishte shpërthyer në revoltë. Megjithëse ndodheshim të rrethuar në tela me gjemba, me ushtarë, me policë, sampistë, qenë kufiri, automoblinda, tanke, vetja na dukej e lirë. Në ato pak metra katrorë, ku shtrihëj kampi, ishim ne zot. Në oborrin e kampit u ndezën zjarre. Jashtë telave me gjemba ishin Ata, kurse brenda telave ishim Ne.

Tutje korinjve, këndonte bilbili. Nga tarraca e fjetores, vinin tingujt e kitarrës. I binte Astriti. Unë isha ulur tek shkallët dhe sodisja yjet, hënën, zjarret, të burgosurit. Fytyrat e tyre shkëlqenin. O zot, sa i zbukuron burrat revolta! Të gjithë të burgosurve, atë natë, u kishte rënë një nur i bukur. Ndenjëm tre ditë pa ngrënë, por askush nuk u ankua. Dashuria për lirinë ësh:ë më e madhe dhe më e bukur nga të gjitha dashuritë. Këtë e kupton vetëm ai që ka jetuar nën diktaturë. Por më mirë akoma e kupton ai që ka jetuar në komunizëm.

Nga mbasditja e ditës së tretë të revoltës, nga Tirana-erdhi një veturë e kuqe. Kishte ardhur zëvendësministri i Punëve të Brendëshme. Ai me skotën e tij, u afruan tek telat me gjemba. U afruan edhe ne pranë gardhit me tela me gjemba. Ai qëndroi disa caste pa folur, duke na kundruar të gjithëve me rradhë.

- Ju i kini ngritur sytë nga qielli, por mos shpresoni. Se dhe sikur të ndodhë një gjë e tillë, ju nuk do ta gëzoni, se ne do t'iu zhdukim juve përpara - na tha.

- Edhe juve të mos ju rrejë mendja, se po ndodhi ajo, ju nuk do të keni kohë të lidhni brekët - i tha një i burgosur.

- Shënoje këtë - i tha komandantit të burgut. Ai e futi në rreth

të kuq.

- Ne po të duam, brenda pak sekondave, u zhdukim pa nam e pa nishan. U bombardojmë nga lart me lëndë kimike dhe filmi merr fund.

- Jemi trimat e Selfo Qorrit, ju, edhe në luftë kështu e bënit:
«Para partizanë se mbrapa ka gjermanë!»

- Nga je ti, mo, që na qenke kaq trim?

- Unë jam nga fshati juaj.

- Nga fshati im?! Po i kujt je ti?

- Unë jam djali i Ahmetit.

- Oouu! Djali i atij je ti? Ai ka qenë oficer në regjimin e kaluar. Ai ka qenë armik.

- Për ju, të gjithë armiq janë. Po kur ishte i gjallë babai im, ti i lagje brekët kur e shikoje.

- Shënoje dhe këtë - i tha komandantit të burgut.

Ai e futi në rreth të kuq.

Në mesin e natës së tretë, na sulmuan: ushtarët, policët, sampistët dhe qentë e kufirit. Përleshja që e ashpër dhe dhëmbë për dhëmbë. Ata ishin të armatosur. Ne kishim vetëm duart dhe shpirtin.

Mbi të gdhirë, kampi ra. Mbi tarracë, ishin 16 djem të vendosur kurriz më kurriz e me bishta belash ndër duar, tamam si tek spartanët.

Ra nata, dhe ata ende nuk kishin zbritur poshtë. Erdhën zjarrfikset dhe filluan ti qëllonin me presionin e ujit. Ata vendosën të vdisnin dhe të mos dorëzoheshin. U hodhën me kokë nga tarraca e katit të tretë, por ata të sigurimit kishin hapur fletët e çadrave dhe i prisnin. Vetëm njëri, u përplas me kokë në bordurën e trotuarit dhe

iu ça kafka. Të tjerët i kapën të gjallë dhe në një gjyq urgjent, i dënuan me vdekje dhe i pushkatuan po atë natë. Këmishët e tyre, të lara në gjak, i varën në oborrin e burgut për terror. Tartarini, atë natë, ka ulëritur pa pushuar, jashtë telave me gjemba. Edhe Tatin e kishin dënuar me vdekje. Tre herë e rrethuan dhe se kapën dot. E vranë nga larg dhe trupin e tij e zvarritën në oborrin e burgut, pastaj e varrosën në një gropë të përbashkët me të tjerët.

Nëntëdhjetëveta na hypën nëpër makina dhe na sollën në burgun e Tiranës. Këtu filluan torurat. Njëri nga ne kishte në gjoks një shqiponjë të bërë me tatuazh, pa yll të kuq. Hetuesi, i hoqi këmishën, nxorri thikën dhe i pikturoi yllin e kuq në gjoks, mbi kokën e shqipes. Shqiponja u përgjak. Mua më dënuan me vdekje.

U dëgjuan të trokitura në mur. E premë muhabetin dhe ndenjëm në përgjim. Mesazhi që na vinte nga qelitë ishte i dhimbshëm. Vajza enigmatike, që ishte në katin e parë, kishte zgjuar të gjithë birucat me të lebetitura.

Ishte ora një mbas mesnate. Në dhomë i kishte hyrë hetuesi im dhe e kishte përdhunuar. Britmat e saj erdhën duke u fashitur derisa nuk u dëgjua gjë më. Ai pasi e përdhunoi e kishte mbytur. Atë natë, asnjë nuk vuri gjumë në sy. Të gjithë ishim të revoltuar. Filluan të kërcasin muret e dyert e birucave. Të izoluarit shprehnin indinjatën dhe revoltën e tyre. Zemrat tona u mbushën me urrejtje. Urrejti - thotë Zola - është e shenjtë. Ajo të jep forcë dhe vret frikën. Ato çaste, mua mu kujtua Harku i Triumfit.

Unë nuk vrisja dot një mizë. Nuk shikoja dot kur therej një pulë. po ç'ishin ato:ndenja të panjohura deri atëhere? Atë që përdhunoi dhe vrau një të pambrojtur, ta kisha ato momente do ta linçoja. Do ti nxirrja sytë, do t'i prisja veshët, buzët. O zot, ç'ishteky pasion për

gjak? Në shpirtin tim triumfuan instiktet. Dëgjova kushtrimin e të parëve. Mos kam dhe unë në gjak gene sadisti? Pyesja veten kur arsyeja e mundi pasionin. «Jo, jo» - më përgjigjej ndërgjegjia. Urrejtja është e shenjtë. Cila urrejtje? «Urrejtja kundër vampirëve, kundër farës së kuqe. A do shpëtojë njerëzimi ndonjëherë nga kjo e keqe? Komunizmi është si kancer. Lëshon metestraza. Ajo pjesë e rruzullit që është prekur nga kjo sëmundje, do të lëngojë në shtratin e vdekjes. Tek ne kjo sëmundje është më e rëndë. Shqipëria është e vogël dhe i ka mushkëritë e njoma si të një zogu.

Kur e pa Alaudini gjendjen tonë, filloi të na tregojë përsëri gjëra për të qeshur.

- Ti, - më tha mua, - ke qenë gazetar, i njeh qyfyret e komunistëve. Na trego ndonjë gjë për të qeshur.

- Kur vajta në «Zërin e Rinisë», bëheshin shumë thashetheme në lidhje me femrat. Një ditë u lajmëruam, se vetë shoku Enver do të bënte një mbledhje për thashethemet.

Salla ishte e mbushur plot e përplot. Pas një çerek ore ai u shfaq tek dera e sallës. Unë gjithmonë e kisha parë të qeshur, duke tundur dorën. Por atë çast mu bë sikur ishte tjetër njeri. Fytyra i ishte nxirë. Buza e poshtme i ishte varur. Dy dhëmbët e qenit i kishin dalë mbi buzën e poshtme. Salla kishte ngrirë. Kryeministri ishte çuar në këmbë dhe mermeriste me vet:

- Erdhi. Erdhi.

- Çfarë ka ky - pyeta njerin që kisha pranë.

- Shëjë - ma bëri ai duke mbuluar fytyrën.

Pyeta tjetrin por dhe ai bëri të njëjtën gjë. O zot - thashë me vete - ky është trimi i Ebros?! Komandanti legjendar i Brigadës së Parë Sulmuese? S'është çudi që heroi atë ditë i ka lagur brekët.

Ata qeshën.

- Si? Si? - ia bënte Alaudini dhe përsëriste fjalët e mia duke mbajtur ijet me duar.

- Aman na trego dhe ndonjë gjë tjetër.

- Për të argëtuar udhëheqjen, kishin ardhur humoristët e Estradës së Tiranës. Në qendër të llozhës ishte ulur Enver Hoxha. Përreth ishin anëtarët e byros, ministrat dhe gjeneralët me gjokset plot dekorata. Ata të gjithë shikonin në sy Enverin. Humoristët rrinin si në gjemba. Kur Enveri vinte pak buzën në gaz, byroistët, ministrat e gjeneralët, gajaseshin së qeshuri. Kur Enveri hiqte buzën nga gazi, ata merrnin qëndrim gatitu, mbyllnin gojën, bile dhe frymë nuk merrnin. Atë natë vetëm Enveri pa estradë. Ata panë Enverin dhe unë pashë ata.

- Aman na trego edhe ndonjë gjë tjetër.

- Në Shtëpinë Qëndrore të ushtrisë, një natë një gjeneral, u tregonte vartësve për heroizmat e tija gjatë luftës. Në këtë kohë futet një i ri me flokë të gjata, me mjekër dhe me pantallona kauboj që zvarriteshin. Gjenerali kur e pa, u vrenjt dhe bërtiti:

- Kapeni qafeleshin, lidheni.

- Shëjëët, shoku gjeneral, se është i biri shokut Mehmet.

- Marshalla, marshalla, sa qenka rritur! Si bëka syri tërt. Qënka trim si i ati. Marshalla, marshalla - ia bënte gjenerali, heroi i luftës partizane.

I shtymë dhe ca ditë me qyfyre.

U dëgjuan kërcitjet e llozit tek dera e birucës. Ne e ndërpremë bisedën. Pastaj pamë njëri-tjetrin të habitur. Ç' do të thoshte kjo? Ishin orët e vdekura të mbasdites. Në këtë orë s'kishte asnjë aktivitet. Në s'kishim hetuesi. Na e kishin prerë biletën për në

botën tjetër. Skuadra e pushkatimit vinte gjithmonë mbas mesnate. Dera u hap dhe në birucë hyri gardian Aliu. Ai vajti drejt e tek Ademi. E zuri nga krahu, e çoi në këmbë dhe e mori me vete. Dera e birucës u mbyll përsëri. Asnjë nga ne nuk foli. Nëpër koridor u dëgjuan hapat e gardianit, zhurma e zinxhirëve në këmbët e Ademit dhe pastaj klithja e lemerishme e gardianit:

- Ka njeri! Ka njeri!

Filluan të trokiturat në muret e birucës. Të izoluarit e birucave të tjera, donin të dinin çfarë ndodhi në birucën tonë. Unë u transmetovase morën Ademin. Se nuk dinim asgjë tjetër.

Ne pyetëm Alaudinin:

- Çështë kjo?! - Por ai nuk na dha përgjigje. Bëri sikur nuk na dëgjoi. Pas një ore e sollën Ademin. Ai rrinte kokulur.

- Pse të morën - e pyeti Sandri. Ai e pa drejt në sy dhe nuk foli. Filluan të trokitura përsëri në mur. Donin të dinin çfarë ngjau me Ademin. Unë e pashë në sy, por ai i uli sytë. Ne s'po u kthenim përgjigje. Të trokiturat në mur nuk rreshtën. Kërkonin të dinin çfarë ndodhi. Na pyesinin pse s'po kthenim përgjigje. Alaudini sikur u përmend nga kllapia. Iu drejtua Ademit.

- E di pse të thirrën.

- Po a e firmose.

- Po! - u përgjigj Ademi.

Alaudini seç mërmëriti nëpër dhëmbë.

- Vëllezër, më falni e bëra. As unë nuk e di si e bëra - tha Ademi duke u mbytur në ngashërime. Unë e sandri ishim hutuar fare. Nuk kuptonim asgjë.

- Më çuan në dhomën Nr.7. Tek hetuesia speciale. Atje ishin tre veta. Dy të panjohur dhe hetuesi im. ishim nga shtëpia jote më tha

njëri nga ata të dy. Nëna ishte duke vdekur dhe ty s'të hiqte nga goja.

Fëmijët lypnin rrugëve. Gruaja jote.....

Mua më shkuan lot nga sytë.

- U preke ë? I do?

- Si nuk i dashkam?! i thashë.

- Ashtu?! Po pse nuk mendove për ta. Po Atdheun e do?

- E dua si nuk e dua!

- Ashtu ë? Po Partia ç'të bëri?

- Asgjë.

- Ashtu ë? Atëhere firmos këtu më tha. Dhe unë e firmosa. Ai shkreu përsëri në vaj. Atëhere ndërhyri Alaudini dhe e qetësoi.

- S'ke faj ti. Faj është i imi. Unë e dija këtë. Kjo ndodh me të gjithë ata që dënohen me vdekje ja prite kur të na marrin edhe ne të tjerëve. Dhe do të na bëjnë të njëjtën lojë. Këtë ata e bëjnë jo se na e kanë nevojën neve për informacion, por e bëjnë që të na degradojnë fare. Po të na falet jeta, ata do të na e nxijnë jetën, duke na kërkue bashkëpunim. Po s'pranuam do të na kërcënojnë me nënshkimin. Po morëm përsëri pjesë në politikë do të na diskretitojnë duke na ekspozuar si bashkëpunëtor të tyre. Po na pushkatuan edhe në botën tjetër, do të jemi të damkosur. Nëqoftë se ndonjëri do të na kujtojë për mirë pas vdekjes, këta do t'i thonë: Nuk ishte ndonjë farë burri, ja shikojeni firmën, spiuni jonë që.

Ademin e mbylën përsëri ngashërimet.

- Tani të kemi mëndjen ne të tjerët.- tha Alaudini, se do të na marrin me rradhë. Kjo tregon se ka ardhur vendimi i formës së prerë. Edhe pak ditë do të jemi bashkë. Tani, më tha shko jepu përgjigje me anë të trokiturave në mur të gjithëve siç ngjau. Thuaja

të vërtetën dhe të ruhen të gjithë nga kurthet e sigurimsave. Unë u transmetova të gjitha ato siç ndodhën.

- Këta duan ta shpërbëjnë fare karakterin e këtij kombi. E filloi përsëri bisedën Alaudini. Ato që janë komunistë kanë për detyrë të spiunojnë edhe të afërmit e tyre. Këtë e thotë hapur idhulli i tyre Lenini.

Ai thotë, se çdo komunist është çekist, pra spiun më troç. Disa i bëjnë spiunë me premtime, disa me kërcënime e dhunë. Pra këta duan ta kthejnë të gjithë popullin në spiun. Kjo është vrasje e ndërgegjes kombëtare.

Imzot Lazëri pranoi se kishte bërë inçest me motrën e tij, kur të gjithë e dijme se katolikët në Shqipëri nuk marrin për grua as fshataren e tyre. Po pse pranoi atëhere prifti këtë poshtërim.

Torturat fizike janë ofendim për shpirtin, thotë Ezopi i lashtësisë.

Hetuesat morën vezë pëllumbi i zien, e morën Imzot Lazrin e ç'veshën i hapën anusin dhe i futën vezët të ziera që përvëltonin në anus. Atëhere ai pranoi se kishte bërë inçest me motrën e tij. Pas ca ditësh ai vdiq. Mjekët e burgut lëshuan raportin se vdiq nga kanceri në zorrën e trashë. Por ai vdiq se i ishte shkatërruar zorra e trashë nga vezët e ziera të pëllumbit.

Kurse profesor A.D. i latinishtes e firmosi deklaratën, se i çuan motrën, nudo, dhe i thanë po nuk e firmose motrën tënde do ta përdhunojë në sytë e tu ky jevgu.

- Amani vëllezër u tha profesori, sa firma të doni ju do të hedh, vetëm këtë mos ma bëni, nëqoftë se kini ndopak gjak shqiptari. Dhe profesori e firmosi deklaratën, që pranonte të bëhej agjent i sigurimit shqiptar. Zemrat tona sa nuk pëllicisnin. A duhet të ketë mëshirë për këta njerëz? Pastaj neve na mori kapter Aliu me rradhë.

Unë dhe Sandri u thyem. Kur na përmëndën familjen. Ne nuk firmosëm. Por kur na zhveshën dhe tentuan të na fusnin në anus vezët e ziera të pëllumbit, ne u thamë mosni aman se do të hedhim njëqind firma. Alaudini që nuk pranoi i futën në anus vezët e ziera. Ai disa ditë ishte në kllapi. Kishte temperaturë të lartë dhe dhimbje të padurueshme. Unë të gjitha këto ua transmetova shokëve të qelive të tjera. Ata filluan t' u bien mureve e dyerve duke bërtitur.

- Kriminelë! Të poshtër!

Nuk pranuan ushqimin për disa ditë të gjitha qelitë u hodhën në grevë urije. Por diktatura nuk do t'ja dijë për asgjë. Pas një jave Alaudini i çeli sytë. Ai ishte me kurajo të madhe. Kur na pa neve që kishim rënë fare moralisht, filloi të na tregojë për spiritizmin. - Shpirti rron edhe pas vdekjes - na tha Alaudini.

- Si rron? Ku vete? - e pyesnim ne.

- Feja thotë se ngjitet në qiell. Disa thonë se bëhet lule, fije bari, erë, pemë, zog, yll në qiell.

Po e vërteta është se shpirti futet tek një i porsalindur. Ai udhëton ditë e natë. Ne mund të rilindim përsëri. Në Gjermani, Austri, Amerikë a në Kañada. Pastaj na tregoi me shembuj konkrete se si kishin rilindur shpirtrat e një burri e një gruaje. Gruaja kishte jetuar e vdekur në Paris dhe pas 50 vjetësh kishte rilindur në Londër. Atë e morën në intervistë dhe tregonte me hollësi jetën e saj në Paris pa qenë asnjëherë në atë vend. Kështu edhe burri që kishte lindur në Poloni e kishte rilindur përsëri në Xhakarta. Të gjitha këto sikur na ngrohën shpirtrat tanë që ishin bërë akull nga fryma e ftohtë e vdekjes që kishte 40 ditë që frynte në qelinë tonë. Shpresa është dhurata më e bukur qiellore. Ajo nuk vdes kurrë. Po vdiq shpresa, ti edhe në qoftë se rron je vetëm një kufomë e

pakallur. Atë natë s'po na zinte gjumi, kur papritur u dëgjuan të trokiturat në mur. Ata lajmëronin se po vinte skuadra e pushkatimit. Që larg nga fundi i koridorit u dëgjuan hapat e skuadrës së pushkatimit. Grup, grup, grup!

Ne po rrinim në përgjim se te cila qeli do të ndalonin.

- Sonte ata vijnë tek ne, tha Alaudini - prandaj vëllezër t'ja bëjmë hallall njëri tjetrit. Hapat u ndalën tek dera e qelisë sonë. U dëgjua trokëllima e llozit. Dera u hap dhe brenda hynë dy tre veta me maska në qokë, zemra më rrihte si e një zogu. Ata kapën nga krahët Alaudinin e çuan në këmbë, ai ishte ende i sëmurë, na pa të tërëve me rradhë dhe me buzë në gaz na tha: - Vëllezër, kurajo, si të jetë shkruar. Ata e nxorrën jashtë, dera u mbyll. Grup, grup, grup, u dëgjuan hapat e skuadrës së pushkatimit u dëgjua edhe zhurma e zinxhirëve nëpër këmbët e Alaudinit.

- Vëllezër të të gjitha qelive mirë u pfishim dhe kurajo! - u dëgjua zëri i Alaudinit. Sandri ja plasi të qarit. Unë dhe Ademi kishim ngrirë. U dëgjuan të trokiturat nëpër muret e qelive. Të poshtë! Kriminelë! s'paskeni të ngopur me gjak! Tradhëtarë! Vrisni vëllezërit tuaj! Askush nuk e bën këtë që bëni ju. Ishte vajza e çmëndur.

Pas pak u dëgjuan pësëri hapat e skuadrës pushkatimit. Ata pësëri u ndalën përpara derës së birucës sonë. Neve gati sa nuk na pushonte zemra. U hap dera. Hynë pësëri tre veta brenda. Këtë radhë ata morën Ademin. Ai nuk na foli fare, na shikonte me ata sytë e mëdhenj, sikur na kërkonte ndihmë, ne vetëm e vështronim. Jeta është e dhimsur. Gënjen ai që thotë se nuk pyet, këtë e kuptojnë vetëm ata që e kanë parë vdekjen me sytë e tyre. Unë e kam parë disa herë me këta dy sy. Jeta është sorkadhe delikate e vdekja hiena

ë zezë me frymën e akullnajave të Groenlandës. Kur u fashitën hapat e skuadrës së pushkatimit tutje nga fundi i koridorit, filluan të trokiturat në mur. Ata pyesnin se cilin nga ne morën herën e dytë, se Ademi nuk foli fare, nuk i tha askujt lamtumirë. Ai kishte vdekur. Ishte jo vdekje klinike, por një vdekje që ende mjekët s'i kanë vënë emër, por unë do ta quaja vdekje sonambule, vdekje me sy hapur. Në këto raste vetëm zemra rreh, se i gjithë organizmi ka pushuar së ekzistuari, unë u transmetova se kishin marrë Ademin.

Atë natë, mua dhe Sandrin nuk na zuri më gjumi. Organizmi jonë kishte pushuar. Nuk ishim më në këtë botë. Muret e qelisë nuk pushonin asnjë çast së trokituri, por ne nuk u kthyem më asnjë përgjigje.

Harabelat filluan të cicërinin mbi hekurat e frëngjishtes së qelisë. U gdhi. Bota u zgjua. Alaudini dhe Ademi nuk e thithin më ajrin e planetit tonë. Bota u zgjua. Ata janë në gjumin e amëshuar. Unë dhe Sandri jemi dy kufoma të pakallura. Vjen kapterri për të ndezur cigaren. Ne nuk e ndezim. Vjen ushqimi, ne nuk fusim asgjë në gojë. Dalim në banjë. Ecim pa vetëdije, si sonabël. Na trokasin në mure, ne nuk u përgjigjemi. Mua më bëjnë shoqëri ata që dalin nga dyshemeja. Sandri më fliste: Saimir! Saimir! Çfarë bën! - Unë e dëgjoja si nëpër gjumë, por nuk e pushoja muhabetin me ta.

- Mua më sollën në këtë birucë nga kampi i Maliqit. Ja, në moshën tënde isha atëhere - dhe pastaj fillonte më tregonte për kampin e Maliqit.

- ishim gjithmonë të uritur. Kur ktheheshim nga puna, futnim në gji panxharsheqeri që ti hanim në kamp për të shuar urinë. Por tek porta na bënin kontroll. Na i merrnin panxharin dhe na i hidhnin në gropën e nevojtores. Kur iknin kapterret, ne futeshim në gropë,

i merrnim panxharët, i fshinim me mëngët e xhaketave dhe i hanim. Komandant i kampit ishte Tasi. Ai nuk kishte shpirt. Një ditë kalon aty ku punonte grupi jonë. Ndalet, na sheh të gjithëve me rradhë dhe na thotë: - Pse nuk punoni, mor armiq?

- Duke punu jena komandant, - i tha Kurti nga malësia.

Tasi rrëmbeu një bel dhe i ra me sa fuqi që kishte. Tehu i belit e goditi Kurtin në qafë. Gjaku i shpërtheu si curril. Kurti ra përtokë duke u përpëlitur.

- Mbulojeni - na urdhëroi.

- Është ende i gjallë.

- Mbulojeni ju them!

- Ne nuk e mbuluam. Atë e mbuluan të tjerët, të gjallë. Dy tre ditë ne kemi dëgjuar rënkimet e Kurtit. Ai s'kishte dhënë shpirt. Por s'na lejonin ta nxirrnim nga gropa.

- Oh, sa janë mbuluar të gjallë në atë llucë të asaj kënete të mallkuar!

- E di si ma kanë nxjerrë shpirtin mua?! Me pompë! Më zhveshën dhe më frynë nga anusi me pompë. Më frynë si kacak, pastaj më gjuanin me shkelma barkut.

- Mjaft! Mjaft! Mos më trego më-i thashë unë dhe bërtita me sa zë që kisha. Mjaft, se po luaj mendsh.

Më përmendi Sandri. Ai brenda dy-tre ditëve ishte bërë skelet. Nuk njihej fare. Kur vritej në luftë ose dënohej e pushkatohej menjëherë, je më trim. Por kur pret vdekjen me natë e ditë, me muaj me rradhë, e humb. Dobësohen nervat. Streset bëjnë të vetën. Mijëra qeliza vdesin në çdo sekondë. Pra, ti s'je më ai që ishe. Je vetëm një kufomë dhe aq. E ç'pret nga kufoma? Atë natë Sandri po më tregonte jetën e tij. Ai më tregonte për pëllumbat. Qyteti i tij

kishte shumë pëllumba. «Kisha një femër që i gënjente gjithë pëllumbat meshkuj të qytetit e mi sillte mua. Pastaj më tregonte emrat e pëllumbave dhe racat. Babai im ishte gjeneral. Por e pushkatuan si komplotist. Mua më akuzuan sikur kam dashur të hedh kombinatin e qytetit në erë. Dhe më dënuan me vdekje.»

- Po ti e pranove akuzën - i thashë.

- Më thanë, pranoje, se nuk të pushkatojmë. Dhe unë e pranova. S'më hiqet nga mendja nëna. Mbas dënimit, e lanë të më takonte. Ajo më puthte duart dhe më merre erë në gushë. Oh, shpirti i nënës-më thonte. Pastaj ajo...

Dhe ai papritur heshti. Unë i fola: Sandri! Sandri! - Ai s'më përgjigjej. Unë vazhdoja ti flisja: Sandri! Sandri! - Çfarë - më tha.

- Ti le bisedën përgjysëm. Ç'pate?

- Dremita - më tha - dhe pashë në ëndërr sikur erdhi skuadra e pushkatimit dhe më mori.

Në mure u dëgjuan të trokitura. Ata transmetonin: Po vjen skuadra e pushkatimit! Po vjen skuadra e pushkatimit! - Vumë veshin.

- Grrrrup, grrrrup - u dëgjuan hapat që larg koridorit. Ata u ndalën para birucës sonë. U hap dera. Brenda hynë tre veta me maska në kokë. Ata e kapën Sandrin nga krahët.

- Ku më çoni - pyeti ai.

Ata e tërhoqën dhe e nxorrën në koridor. U mbyll dera.

- Pse, do më pushkatoni?! Mua më tha hetuesi, prano se ashtu është puna, se - ty, nuk të pushkaton njeri se s'i ke mbushur të tetëmbëdhjetat. Unë s'kam bërë gjë. S'më ka shkuar ndërmend asnjëherë për të hedhur në erë kombinatin! Ku po më çoni! Do më pushkatoni?! - bërtiste Sandri koridoreve të birucave.

Të izoluarit filluan tu bien dyerve e mureve.

- Këtu është kasaphanë! Çfarë bëni kështu?! - bërtiste vajza e çmendur.

Muret e birucave janë shurdhemece. Xhelatët s'kanë zemra.

Këtu është bota e heshtjes dhe e vdekjes. Në qelinë numër 47, mbeta përsëri unë. Gjithë ditën dhe gjithë natën, humbisja në biseda të pafund me ata që dilnin nga dyshemeja. Trokisnin muret e birucave, por unë më të shumtën e rasteve nuk u ktheja përgjigje, se nuk i dëgjoja.

Një natë pashë në ëndërr sikur më fliste një zë. Ai zë vinte nga hapësirat e pafund të universit: - «Preparati për kurimin e kancerit gjendet në moçale. Është një fletë si fleta e luleakullit. Luledelli, i thotë populli. Rritet në moçale, se dhe jeta ka lindur për herë të parë në moçale, nga mikroorganizmat». Ëndrrat më rigjeneronin gjakun. Atë natë u takova me Vjollcën. Kishin kaluar kaq muaj dhe megjithëse kisha dëshirë ta shikoja çdo natë në ëndërr, nuk e kisha parë asnjëherë. Mu shfaq tek rruga ku bënim dashuri, atë natë qershori. Kishte lulëzuar bliri. Kishte veshur një fustan të bardhë dhe mbi flokët e zeza kishte vënë një fjongo si flutur. Mu hodh në qafë.

- Ku ishte?! Pse s'ke dalë më nga kjo rrugë, apo më harrove?! Sa më ka marrë malli!

Por atje larg në fund të rrugicës qëndronte një vajzë tjetër me flokë të lëshuar supeve. Ajo po na shikonte kokëvarur. Ajo ka vdekur. Atë e përdhunuan dhe e mbytën. Ç'kërkon sonte këtu?! U shkëputa nga krahët e Vjollcës. U nisa drejt asaj.

- Ku vete! Kthehu, kthehu - më thoshte Vjollca. Unë shkoja drejt asaj. Ajo ma bënte me dorë: Hajde! Hajde!

Vjollca mu fsheh pas tyllit të mjegullave. Mezi i dëgjohej zëri, sikur vinte thellë humnarave.

- Mos ik, mos më lerë, mos shko pas saj, ajo është hije dhe të mashtron. Po trokisinin në mur. U zgjova. Po transmetonin: Po vjen skuadra e pushkatimit! Po vjen skuadra e pushkatimit!

Grrrup, grrrup, grrrup - u dëgjuan që larg hapat e skuadrës së pushkatimit. Ndenja në përgjim. Ata po i kalonin birucat një nga një. U ndalën para birucës sime. Kërciti llozi dhe dera u hap. Brenda hynë tre veta me maska në kokë. Ata më zunë nga krahët dhe më nxorrën në koridor.

- Vëllezër, mos u dëshpëroni! Ne nuk do vdesim. Lamtumirë!

- Oh, zemrat tona! Na vrisni të gjithëve brenda një nate. Mos na e merrni shpirtin kështu, çikë e nga një çikë. Mallkuar qoftë raca komuniste. Juve s'jeni njerëz! Ju, jeni të dërguarit e satanasë - bërtiste vajza e çmendur. Më nxorrën jashtë dhe më hypën në një autobus. Skuadra e pushkatimit nuk hypi me ne. Në dy krahët e mi u ulën dy policë. Një kapterr u ul përballë.

Ku po më çojnë - thashë me vete. Nuk orientohesha dot. Ishte natë. Por dhe ditë sikur të ishte, nuk do të merrja vesh gjë se autoburgu ishte i mbyllur.

- Do ta ndezësh njëherë - më tha kapterri që ishte ulur përballë.

- Nuk e pi - i thashë.

Makina ecte me shpejtësi të madhe, por unë nuk e kuptoja dot, shkonim për Jug apo në Veri. Do të kishin kaluar më se dy orë, kur makina u ndal. Më zbritën dhe më futën në një birucë ku ishin dy veta, me helmata në kokë, me pranga në këmbë e duar dhe të lidhur me litarë. Mbasi u larguan gardianët ata më pyetën se nga vija. Nga burgu i Tiranës - u thashë. - Nga burgu i ri. Pastaj u tregova odisenë

e jetës sime. Ata më treguan se isha në burgun e famshëm të Burrelit. Se të dy ishin dënuar me vdekje.

- Pse - i pyeta.

- Se u arratisëm.

- U arratisët?!

- Po, u arratisëm.

- Po si e realizuat dot.

Ne e bëmë me fjalë përpara, qëkur të vinte oficeri operativ dhe kapterri, për të bërë apelin, tu hidheshim, tu merrnim çelësat dhe ti lidhnim. Dhe ashtu vepruam. U morëm çelësat, u vumë nga një peshqir në gojë dhe i lidhëm. Ishim tre veta. Hapëm dyert dhe dolëm në tarracë. Që andej u hodhëm drejt mbi roje. Ata na qëlluan me breshëri automatiku. Tomorri u vra, kurse ne të dy mundëm të kalonim. Na ndoqën pas: me ushtarë, policë, qen kufiri, autobllinda, tanke e helikopterë, por nuk na kapën dot.

- Po si ndodheni këtu?

- Kaluam kufirin dhe dolëm në Jugosllavi. U dërëzuan në autoritetet e vendit. Ata na izoluan. Tre muaj na zhvilluan hetuesi. E njëjta metodë si tek ne. Mbas mbarimit hetuesisë, na hipën në një gaz dhe na sollën në kufirin shqiptar. Na dorëzuan. UDB-ja jugosllave dhe Sigurimi i Shtetit, kanë lidhje të vjetra. Edhe kosovarët kur vijnë tek ne. Sigurimi shqiptar ia dorëzon përsëri UDB-së. Na bënë një gjyq formal këtu në burg dhe na dënuan me pushkatim. Kemi disa muaj që presim vdekjen, por po vonon, nuk po vjen.

Ndenjëm deri vonë duke biseduar. Unë isha i hutuar fare. Pse më sollën në Burrel? Po ata të tjerët? shokët e dhomës sime, a do ti kenë pushkatuar? Dhe nëqoftëse jo, ku do ti kenë çuar? Isha i

lodhur dhe më kaplloi gjumi menjëherë. Natën kisha një siklet të madh. Bëja të bërtisja por nuk më delte zëri fare. Mu bë se po më zihej fryma. U kolla. Dëgjova se po kolleshin dhe të tjerët.

- Çohu, çohu, se po na mbysin me gaz.

Biruca ishte mjegulluar fare. I ramë derës po su përgjigjën.

- O zot, po na vrasin, po na mbysin me gaz si minjtë.

Vinim vërdallë nëpër qeli dhe s' dinim çfarë të bënim. Na mbyti kolla. Biruca ishte mbushur e tëra me gaz. Lulit i ra të fikët. I dhamë ndihmën e parë duke i dhënë frymë fme anë të gojës. Ata hapën derën. Menduan se kishim vdekur. Gazi iku dhe dhoma u ajros. Mjeku i burgut priste tek dera për të lëshuar raportin e vdekjes. Në mëngjes ushtuan muret e birucave nga të trokiturat. Atë natë në burgun e Burrelit kishin varur vehten dhjetë të dënuar. Kështu e kishin përhapur lajmin ata të drejtorisë së burgut.

- Kanë varur veten.

- S'ka mundësi - tha Luli - dhjetë veta nuk e varin veten menjëherë. Ata i kanë mbytyr me gaz, siç deshën të na mbysin dhe neve.

O zot, si kemi shpëtuar.

U çova natën si i llahtaritur. Ç'ishin ato rënkime që më zgjuan nga gjumi? Vura veshin tek muri: - «Ëëëëë...ëëëhh! Ooooo...ooohhh!» - Më vinin rënkimet tek veshi. E vura veshin tek dyshemeja. E njëjta gjë.

- Kush rënkon?! Çfarë kini?! Mu përgjigjuni.

Fola, pa ditur se kujt i flisja. Asnjë përgjigje.

Mirë thoshte Sandri. Unë jam i sëmurë. Jam me haluçinacione.

Prite, kur të më shfaqet ndonjë natë, murgu i zi.

Mos kam shkarë - pyeta veten. Vetëdija ime qeshi. Ajo nuk e

pranonte kurrsesi një gjë të tillë. Sa lloj çmendurie ka? Me mijëra, me mijëra. Po unë ku futem? Në cilin grup? Në ç'gradë jam?

- Mblidhe veten e bjer e fli - më tha një zë i brendshëm. Buzëqesha dhe u shtriva përsëri. Por, kur po kaloja nga bota reale, në gjumë. Kur isha në kufirin midis gjumit dhe botës. Koshiencës dhe inkoshiencës. Rënkimet u bënë më të theksuara dhe më të shpeshta. I hapa sytë dhe u çova. Të dy shokët e dhomës po flinin. Çudi - thashë me vete. Po këta, nuk i dëgjojnë rënkimet?! U fola shokëve: Çohuni, çohuni! Ata hapën sytë. Çfarë ke?! Çfarë ka ndodhur?! - më pyetën.

- Vini veshin dhe dëgjoni - u thashë - A dëgjoni gjë.

- Po dëgjojmë të rënkua.

- Ç'janë këto rënkime?

- Këtu mbas birucës sonë është qershiza. Atje i mbulojnë të gjithë ata që vdesin nëpër biruca, nga torturat - më thanë.

- Po të vdekurit nuk rënkojnë!

- Ashtu është. Po këtu i mbulojnë të gjallë, pa dhënë shpirt. Dhe ata rënkojnë derisa tu soset fryma. Do të mësohesh edhe ti, se kështu e pësuam edhe ne, në fillim kur erdhëm në burgun e Burrelit.

Ata ishin si sonabël, dhe i zuri gjumi menjëherë. Unë nuk vura gjumë në sy. Rënkimet po më çmendin fare. Çdo natë në burgun e Burrelit, kishte të papriturat e saj. Unë u mësova me rënkimet dhe nuk më bëri më përshtypje. Por një natë u çova i llahtaritur. Mu bë sikur miliarda ultratinguj më shponin si gjilpëra timpanin e veshit. Ishte një bezdi e padukshme. Çdo të jetë kjo? Çfarë fenomeni po ndodh? Apo më bëjnë veshët mua?

Oh, unë jam i sëmurë psiqik - i fola vetes sime. Pashë dhe ata

te dy që po përpëliteshin në gjumë.

- Çohu - u thashë.

U çuan.

- A dëgjoni gjë - i pyeta.

- Po. Na bëhet se miliarda gjilpëra pona shponin timpanin e veshit.

- Çfarë do të jetë.

- Nuk e dimë. Hera e parë që e dëgjojmë. Ndënjëm disa çaste pa folur. Ultratingujt po bëheshin të pa durueshëm. Na bëhej se gjilpërat, e kalonin timpanin e veshit dhe futeshin thellë kafkës deri tek truri i vogël. Truri ishte bërë miza, miza.

Nuk mund t'i jepnim dum se çfarë ishte. Kjo u përsërit disa netë rresht pa ndërprerë.

- E gjeta! - u thashë shokëve. Këto janë rreze lazër. Po na bombardonin me rreze lazër për të na eliminuar gradualisht. Rrezet lazër kanë fuqi të mbinatyrshme. Ato çajnë jo vetëm muret prej tulle e llaçi. Muret betonarme, por edhe prej çeliku sikur të jenë muret, rrezet lazër i depërtojnë. Unë rrija zgjuar tërë natën kur fillonin të na bombardonin me rreze lazër. - Bërtisja me sa zë që kisha. Çohuni se na dogjën me rreze lazër!

Çoheshim dhe zvariteshim deri tek dera e birucës. Kalonim nga një qoshe e birucës tek tjetra. Gjith natën nuk vinim gjumë në sy. Gardianët kishin raportuar për veprimin tonë dhe na sollën në birucë komision me mjek psikiatër. Na bënë kontroll dhe mua më nxorën të sëmurë dhe më nisën në çmëndinën e Elbasanit. Sonte më lajmëruan të bëj plaçkat gati; se do të nisin. Për ku? S'më treguan gjë. Të burgosurve dhe të çmëndurve nuk u tregohet asgjë. Këtu

përfundonin shënimet e tij. Pas ca kohësh mbasi e kishin marrë Sajmirin. Atë natë me priftin katolik, në pavjonin tim sollën nga Elbasani një vajzë të sëmurë. Ajo çohëj natën dhe bërtiste:

- Na dogjën me rreze lazer! Çohuni, çohuni!

- Çudi thashë me vete, si është e mundur që dy të sëmurë të kenë të njëjtën simptomë sëmundjeje? E vizitova dhe e pyeta:

- Kush t'i bëri rrezet lazer?

- Ajo më pa në sy dhe më tha: - Ata që janë bënë edhe Saimir Dervenit.

- Ashtu? Po ku e njeh ti Saimir Dervenin?

- Kam qënë e shtruar me të në çmëndinën e Elbasanit.

- Po Sajmiri, kush ja bënte rrezet lazer?

- Sigurimi i shtetit më tha. Unë heshta.

- Ti nuk e ke njohur Saimirin.

- Jo e gënjeva.

- A ç'djalë që qe. Për kokën e djalit. Por ç'e do ra viktimë e Elmas, asaj turkeshës së djallit.

- Pse si ishte puna? e pyeta.

- Elmaja ishte infermiere në spitalin tonë. Ishte një esmere simpatike. Ato të igurimit e vunë të përgjonte Saimirin. Ajo i shkante në dhomë gjysmë lakuriq. Një ditë unë e pashë kur puthte gjinj të turkeshës. Ai kishte rënë në dashuri me të? Apo shuante epshet nuk e di. Vetëm di një gjë, që Elmaja lëshoi deklarata që

Saimiri nuk është i shkalluar dhe prandaj një ditë papritur e pa pandehur e zhdukën. Se ku e çuan nuk e di. Vetë më çudit fakti, se si ra viktimë e Elmasë Saimiri. Ai ishte tip inteligjent. Pastaj asgjë më për Saimirin. Kur vinin vjeshtërat e frynin erërat e jugut, mua më bëhej se dëgjoja zërin e tij:

- Çohu se na dogjën me rreze lazer! Poshtë krevatit! dhe më pas më bëhej se erërat më sillnin zërin tërë ankth të ish oficerit të sigurimit që bërtiste: - jo nuk e vrava unë! Jo se kam vrarë unë!

Më përfytyrohej prifti katolik me dy pëllëmbët e puqura me kokën lart dhe më pas më vinin mërmërimat e zërit të tij:

- Mëshirona Zot ne mëkatarëve! Mëshirona Zot ne mëkatarëve!
Po Saimiri çu bë? Prifti katolik kishte vdekur në burgun e Burrelit. Kam pyetur shumë bashkëvuajtës të Saimirit. Disa më thonë se është zhdukur, kurse disa të tjerë, më thonin se e kanë parë gjatë revoltave tek qyteti i Studentit, kur u rrëzua busti i diktatorit tek shkolla e Bashkuar. Pastaj se kishin parë më. Por këto ditë një refugjat që është kthyer nga Gjermania më tregoi se Saimir Dervenin e kishte takuar në kampin e refugjatëve të Oldenburgut të Gjermanisë. Ai kishte qëndruar me Saimirin në kamp, deri sa kishin dhënë intervjut. Saimiri rrinte gjithë ditën me një vajzë të re. Vajza ishte Ballkanase, por nuk e morëm vesh tamam origjinën e saj. Refugjatët shqiptar kur e shikonin Saimirin buzë liqenit duke soditur natyrën dhe të mbështetur në krahë vajzës së bukur

ballkanase thoshin: «Ja tek është Etmond Dantesi me Hajden». Pás tre javësh Saimiri iku nga kampi i Oldenburgut dhe ne nuk e morëm vesh ku e caktuan. Kaq më tregoi refugjati nga Gjermania. Në qoftë se Saimiri rron e në qoftë se do të më jepet mundësia për ta takuar ose për të rënë në kontakt me të, i premtoj lexuesit, se do të bëj çmos të botoj ditarin e tij që atë ditë që iku nga spitali ynë.

Mjeku psikiatër i psikiatrisë së Tiranës.

